Një tjetër karakteristikë e veçantë e organizmit njerëzor kur dominohet nga një nevojë e caktuar është se filozofia e tërë e së ardhmes ka tendencë të ndryshojë gjithashtu. Për njeriun tonë kronik dhe jashtëzakonisht të uritur, kuzhina mund të përkufizohet thjesht si një vend ku ka shumë ushqime. Ai tenton të mendojë se, nëse vetëm atij i garantohet ushqimi për pjesën tjetër të jetës së tij, ai do të jetë krejtësisht i lumtur dhe nuk do të dëshirojë kurrë më shumë. Jeta në vetëvete tenton të përkufizohet në kuptimin e të ngrënit. Çdo gjë tjetër do të përshkruhet si e parëndësishme. Liria, dashuria, ndjenja e komunitetit, respekti, filozofia, të gjitha mund të tunden mënjane si preferenca të cilat janë të padobishme pasi nuk arrijnë të mbushin stomakun. Kjo është ajo që nënkuptojmë duke thënë se nevojat themelore njerëzore janë të organizuara në një hierarki të përparësisë relative. Nevojat fiziologjike, së bashku me qëllimet e tyre të pjesshme, kur krejtësisht janë kënaqur, pushojnë së ekzistuari si përcaktues aktivë ose organizatorë të sjelljes. Por një dëshirë që është arritur dhe është kënaqur nuk është më një dëshirë. Nëse uria është kënaqur, bëhet e parëndësishme në dinamikën aktuale të individit.

Nëse nevojat fiziologjike janë relativisht të kënaqshme, atëherë shfaqet një grup i ri nevojash, të cilat mund të kategorizohen si nevoja për siguri. Ato mund të shërbejnë si organizatorë pothuajse ekskluzivë të sjelljes, duke rekrutuar të gjitha kapacitetet e organizmit në shërbimin e tyre dhe ne mund ta përshkruajmë në mënyrë të drejtë tërë organizmin si një mekanizëm për kërkimin e sigurisë. Përsëri, si në njeriun e uritur, gjejmë

se qëllimi mbizotërues është një përcaktues i fortë jo vetëm për botëkuptimin dhe filozofinë e tij aktuale, por edhe për filozofinë e tij për të ardhmen. Praktikisht gjithçka duket më pak e rëndësishme sesa siguria madje ndonjëherë edhe nevojat fiziologjike të cilat janë të plotësuar tani nënvlerësohen.

Megjithëse edhe pse ne jemi të interesuar për ti njohur dhe sqaruar kryesisht nevojat e të rriturve, ne mund t'i qasemi një kuptimi të nevojave të sigurisë ndoshta në mënyrë më efikase duke vëzhguar foshnjat dhe fëmijët, në të cilët këto nevoja janë shumë më të thjeshta dhe më të qarta. Një arsye për shfaqjen më të qartë të reagimit dhe të kërcënimit ose rrezikut tek foshnjat është se ata nuk e pengojnë fare këtë reagim, ndërsa të rriturit në shoqërinë tonë janë mësuar të pengojnë atë me çdo kusht. Kështu që edhe kur të rriturit ndjejnë se kërcënim i tyre është i sigurt, ne nuk mund ta shohim këtë gjë në sipërfaqe (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018). Ndoshta dikush mund ta shprehë këtë më saktë duke thënë se fëmija ka nevojë për një botë të organizuar dhe jo për një botë të paorganizuar ose të pastrukturuar. Roli qendror i prindërve dhe krijimi normal i familjes janë të padiskutueshme. Rrëmbimi, sulmet fizike, ndarja, divorci ose vdekja brenda familjes mund të jenë veçanërisht të tmerrshme (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018). Gjithashtu shpërthimet prindërore të zemërimit ose kërcënimet e ndëshkimit drejtuar fëmijës, duke i quajtur me emra të ndryshëm, duke folur me ashpërsi, duke e tronditur, duke e trajtuar atë përafërsisht me diqka jonjerzore, ose në të vërtetë ndëshkimi fizik nganjëherë nxjerr një panik dhe terror të plotë në fëmijën që ne duhet të supozojmë se është më i përfshirë nga aspekti psikologjik sesa vetëm dhimbja fizike. Nga këto dhe vëzhgime të ngjashme mund të përgjithësojmë dhe të themi se mesatarja e fëmijëve në shoqërinë tonë përgjithësisht

preferon një botë të sigurt, të rregullt, të parashikueshme dhe të organizuar, në çdo rast, ai ka gjithçka, kur ka prindër që e mbrojnë atë nga rreziku duke i ofruar siguri të plotë.

Fëmijët që rriten në një familje pa dashuri, zakonisht nuk reagojnë siç e kemi përshkruar më lart. Reagimet ndaj rrezikut janë të pritura për të ardhur kryesisht në objekte apo situata që të rriturit gjithashtu do ta konsideronin të rrezikshëm (Heckhausen. J, H. H, 2018). Nevojat shoqërore - Nëse të dy nevojat fiziologjike dhe të sigurisë janë mjaft të kënaqshme pra janë plotësuar, atëherë do të shfaqet dëshira për arritjen e nevojës së radhës atë shoqërore ku përfshin nevojen për dashuri, përkatësi, familje etj. Tani personi do të ndjehet i fortë, si kurrë më parë për të arritur këtë nevojë pikërisht nga mungesa e miqve, apo një të dashure, gruaje apo fëmijë. Ai do të ndjejë uri për marrëdhënie të dashur me njerëzit në përgjithësi, domethënë për një vend në grupin e tij shoqëror dhe ai do të përpiqet me intensitet të madh për të arritur këtë qëllim. Ai do të dëshirojë të arrijë një vend të tillë më shumë se çdo gjë tjetër në botë dhe madje mund të harrojë se një herë, kur ishte i uritur, ai u tall me dashurinë.

Në shoqërinë tonë prishja e këtyre nevojave është thelbi më i shpeshtë në rastet e keq përshtatjes dhe psikopatologjisë më të rëndë (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018). Me vetbesim të shfaqur në mënyrë të vendosur, nënkuptojmë atë që mbështetet në mënyrë të shëndoshë mbi kapacitetin, arritjen dhe respektin e vërtetë nga të tjerët.

Nevoja e vetvlerësimit çon në ndjenjat e vetbesimit, vlerës, fuqisë, aftësisë dhe përshtatshmërisë së të qenurit i dobishëm dhe i nevojshëm për shoqërinë. Por prishja e këtyre nevojave prodhon ndjenja të inferioritetit të dobësisë dhe të pafuqisë. Këto nevoja

janë relativisht të theksuara nga Alfred Alderfer dhe pasuesit e tij, dhe janë lënë pas dore nga Frojdi dhe nga psikoanalistët tejrë. Këto nevoja mund të klasifikohen në dy grupe ndihmëse. Këto së pari janë dëshira për forcë, për arritje, për përshtatshmëri, për besim në fytyrën e botës dhe për pavarësi dhe liri. Së dyti, ne kemi atë që mund ta quajmë dëshirën për reputacion ose prestigj, duke e përcaktuar atë si respekt ose nderim nga njerëzit e tjerë ku përfshin njohjen, vëmendjen, rëndësinë dhe vlerësimin.

Nëse të gjitha nevojat e lartpërmendura janë arrirë dhe janë të kënaqshme, atëherë mund të vazhdojmë në realizimin dhe arritjen e nevojës së vetaktualizimit. Një muzikant duhet të bëjë muzikë, një artist duhet të pikturojë, një poet duhet të shkruajë, nëse ai do që të jetë në fund të fundit i lumtur dhe të vetaktualizohet. Çfarë njeriu mund të jetë, ai duhet të mundohet të arrijë dhe të bëhet (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018). Kjo është arsyeja që këto nevojë duhet ta quajmë vetaktualizim. Forma specifike që këto nevoja do të marrin do të ndryshojë nga një person në personin tjetër. Në një individ mund të marrë formën e dëshirës për të qenë një baba/nënë ideale, në një tjetër mund të shprehet në atletikë dhe në një tjetër mund të shprehet në pikturë ose në shpikje.


Meqenëse, në shoqërinë tonë, njerëzit e kënaqur në thelb bëjnë përjashtim, nuk dimë shumë për vetaktualizimin, qoftë eksperimentalisht apo klinikisht, dhe kjo padyshim vazhdon të mbetet një problem sfidues për hulumtimin. (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018).

2.8. Teoritë e përmbajtjes së motivimit

Siç kemi cekur edhe më lartë teoritë e motivimit përbëhen nga teoritë e përmbajtjes dhe teoritë e procesit. Prandaj keto dy grupe të teorive do të shtjellohen me hollësisht në këtë disertacion duke trajtuar secilen teori veç e veç e po ashtu në vazhdim do të trajtohen edhe teoritë e tjera të motivimit.

Teoritë e përmbajtjes përfshijnë: Teorinë e Maslow-it, Teorinë Herzbergut, Teorinë e McClellandit dhe Teorinë e Alderferit të cilat paraqitën në figurën e mëposhtme.

Figura 5. Teoritë e përmbajtjes së motivimit



Burimi: Autori


2.8.1. Hierarkia e nevojave sipas Maslow-it

Abraham Maslow ishte me profesion psikolog, dhe këtë teori ai e paraqiti në mesin e viteve 1940 - 1950 e cila teori në fillim kryesisht ishte përdor në klinikat psikologjike. Meqenëse teoria e tij konsiston në hierarkinë e nevojave të individit, ai nevojat i ndanë në pesë grupe, siç janë (Koenig, 2012):

- 1. Nevojat fiziologjike**
- 2. Nevojat e sigurisë**
- 3. Nevojat shoqërore**
- 4. Nevoja për respektim dhe**
- 5. Nevoja e vetaktualizimit**

Sipas rregullit të paraqitur nga ky autor, nevojat e ulëta duhet të përmbushen para se të paraqiten nevojat e niveleve tjera. Njerëzit kanë profesione të ndryshme dhe këto nevoja kërkojnë që ata të arrijnë gjithçka që kanë mundësi në profesionin e tyre që kanë zgjedhur. Shumë individë, të cilët largohen nga puna nga ndërmarrjet dhe kompanitë e mëdha për të filluar një biznes të tyre, janë mënyra dhe përpjekëja e tyre për të kënaqur nevojat e tyre të rangut më të lartë. Pavarësisht nga forma specifike e shfaqjes së tyre, nevojat e vetaktualizimit dalin në plan të parë vetëm pas kënaqjes së nevojave të katër niveleve paraardhëse, Llaci, Tiranë, (2010). Më poshtë është paraqitur figura e cila paraqet hierarkinë e nevojave të Masllowit, ku dy nga nevojat e para janë të grupuara në nevoja primare ndërsa të tjerat në nevoja sekondare apo të rangut më të lartë.

Figura 6. Hierarkia e nevojave sipas Maslowit



Burimi <https://en.wikipedia.org/wiki/AbrahamMaslow>, modifikuar nga autori

Teoria e motivimit të Maslow-it në themelet e saj ka dy principe themelore. Së pari kënaqja e nevojave të njeriut realizohet sipas një radhe të përcaktuar të hierarkisë ku pasi kënaqen nevojat e nivelit më të ulët shfaqen kërkesat dhe synimet për plotësimin e nevojave të nivelit më të lartë e kështu me radhë. Dhe së dyti njeriu është një qenie, nevojat e të cilit varen dhe përmbushen nga ajo çka ai zotëron. Pra një nevojë e plotësuar nuk është më motivuese por një tjetër nevojë e radhës e luan këtë rol më tutje, Llaci, (2010).

Po ashtu në tabelën e mëposhtme janë paraqitur faktorët e përgjithshëm dhe faktorët organizativ të cilët konsistojnë dhe radhitën në një ngjashmëri pothuajse të njëjtë si tek shkalla e hierarkisë së nevojave të Maslowit.

Tabela 1. Faktorët e përgjithshëm dhe faktorët specifikë organizativë

Faktorët e përgjithshëm	Shkallët e nevojave		Faktorët specifikë organizativë
1. Rritja 2. Suksesi 3. Përparimi	Rangimet e nevojave nga poshtë në lartë ↑	Vet aktualizimi	1. Thirrja në punë 2. Kreativiteti 3. Përparimi në organizim 4. Arritja e suksesit në punë
1. Njohja 2. Statusi 3. Vetëvlerësimi 4. Vet respekti		Egoja, statuti, Respekti	1. Titulli në punë 2. Paga e merituar rritet 3. Mbikëqyrja e barabartë 3. Puna personale 4. Përgjegjësia
1. Miqësia 2. Dashuria 3. Shoqëria		Sociale	1. Kualiteti i mbikëqyrjes 2. Pajtueshmëri në grup 3. Marrëdhëniet me kolegë
1. Siguria individ/familje 2. Sigurimi 3. Kompetenca 4. Stabiliteti		Siguria	1. Siguria në punë 2. Beneficionet 3. Paga e përgjithshme rritet
1. Ajri 2. Uji 3. Ushqimi 4. Të bërit dashuri		Fiziologjike	1. Ngrohja dhe ajrosja 2. Paga bazë 3. Kafeteria
		↓ Themelore	

Burim: Sizilagy & Wallace (1980), modifikuar nga autori

Nga tabela e paraqitur shohim se sikurse të teoria e Maslow-it për hierarkinë e nevojave, edhe këtu të faktorët e përgjithshëm dhe ata specifikë organizativë radhitën në bazë të peshës dhe prioriteteve duke kaluar nga niveli më i ulët tek ai më i larti, pra nga ata themelor tek ata kompleks. Duhet kuptuar faktise në disa raste kur individë të caktuar nuk mund të arrijnë në këtë nivel pra në nivelin e dëshiruar ata shpesh angazhohen edhe në ndonjë profesion apo dobi tjetër për të fituar respekt dhe njohje dhe për të arritur atë që ata deshirojnë, (Mustafa, 1997). Aktivitetet e ndryshme pa dyshim që i japin personit një

ndjenjë kontributi ose vlerë. Megjithatë vetbesimi jo i lartë ose kompleksi i inferioritetit mund të rezultojë në mospërshtatje gjatë këtij niveli në hierarki. Shumica e individëve kanë nevojë për vetë-respekt dhe vetvlerësim të qëndrueshëm. Maslow vuri në dukje dy versione të nevojave për nderim: një version "më të ulët" dhe një version "më të lartë". Versioni "më i ulët" i vlerësimit është nevoja për respekt nga të tjerët, kjo mund të përfshijë një nevojë për statusin, njohjen, famën, prestigjin dhe vëmendjen. Versioni "më i lartë" manifestohet si nevoja për vetërespekt. Për shembull, personi mund të ketë nevojë për forcë, kompetencë, zotërim, vetëbesim, pavarësi dhe liri. Version "më i lartë" ka përparësi mbi versionin "më të ulët" sepse mbështetet në një kompetencë të brendshme të krijuar sipas përvojës. (<https://en.wikipedia.org/wiki/Maslows/hierarchyofneeds>).

Vetaktualizimi paraqet atë se: "Çfarë njeriu dëshiron dhe mund të jetë, ai duhet të jetë." Ky citim përbën bazën e nevojës së perceptuar për vetaktualizim. Maslow e përshkruan këtë nivel si dëshira e individit/ punonjësit për të arritur gjithçka që ai mundet dhe për t'u bërë ai që më së shumti mund të jetë dhe të bëhet. Mirëpo shkalla e pestë e nevojave varet edhe nga rritja e prodhimit, gjerësisht shërbimeve, e bruto produktit të gjithëmbarshtëm apo të ardhurave kombëtare, posaçërisht nga rritja e të ardhurave personale pastaj ngritja e tij personale dhe profesionale, e që të gjitha këto ndikojnë në arritjen dhe realizimin e këtyre nevojave. Kështu që, individët e motivuar për plotësimin e këtyre nevojave si qëllim kryesor përcaktojnë shtimin e prodhimit, realizimin e suksesshëm të aktiviteteve, përparimin profesional pastaj atë teknik/teknologjik në ndërmarrje, ngritjen e marrëdhënieve ndër njerëzore, zgjidhjen e shumë problemeve të tjera në lëmin e menaxhimit etj. (Uriarte Jr, 2008).


2.8.2. Teoria e motivimit - higjienës sipas Herzbergut

Frederick Herzberg (1923-2000), psikolog amerikan dhe profesor i menaxhimit në Universitetin e Utah-it, propozoi teorinë e motivimit të higjienës e njohur edhe si teoria e dy faktorve të kënaqësisë dhe pakënaqësisë në punë. Sipas teorisë së Herzberg, faktorët e brendshëm janë të lidhura me kënaqësinë e punës dhe motivimin, ndërsa faktorët e jashtëm janë shkaktuar nga pakënaqësia e punës. Duke besuar se qëndrimet e individëve ndaj punës përcaktojnë suksesin ose dështimin, Herzberg hetoi pyetjen "Çfarë duan njerëzit nga punët e tyre?" Ai kërkoi nga njerëzit për përshkrime të detajuara të situatave në të cilat ata mendojnë se janë të mira apo të këqija për punën e tyre. Herzberg konkludoi nga analiza e tij se përgjigjet që i dhanë njerëzit kur ndjeheshin mirë në punën e tyre ishin shumë të ndryshme nga ato që u dhanë kur ata ndiheshin keq. Karakteristikat e caktuara ishin vazhdimisht të lidhura me kënaqësinë e punës, dhe të tjerët për pakënaqësinë e punës ku faktorët në anën e djathtë paraqesin pakënaqësitë ndërsa ata në anën e majtë kënaqësitë e punonjësve (Armstrong, 2010). Faktorë e lidhur me kënaqësinë e punës përfshinin gjëra të tilla si mundësitë e arritjes së rezultateve, njohja, interesit në punë, përgjegjësia dhe përparimi. Pra kur njerëzit ndjeheshin mirë në punën e tyre, ata u përpoqën t'u jepnin atyre këto karakteristika të cilat i bënin ata të kënaqur. Nga ana tjetër, kur ata ishin të pakënaqur me punën e tyre, ata tentonin të citonin faktorët e jashtëm dhe të pohonin se këta ishin faktorët që krijonin pakënaqësitë e të cilët ishin mbikëqyrja, politikat e kompanisë, shpërblimi në të holla, marrëdhëniet ndërpersonale, statusi, siguria, pjesëmarrja në vendimmarrje dhe kushtet e punës. Herzberg mendonte se të dhënat sugjeronin gjithashtu

se e kundërta e kënaqësisë nuk ishte pakënaqësi, siç kishte qenë tradicionalisht dhe besonin. Heqja e karakteristikave të pakënaqshme nga një punë nuk do ta bënte këtë punë më të kënaqshme (ose motivuese). Herzberg ishte i bindur që gjetjet e tij tregonin ekzistencën e një vazhdimi të dyfishtë: E kundërta e "kënaqësisë" është "pa kënaqësi" dhe e kundërta e "pakënaqësisë" nuk është "pakënaqësi". Herzberg besonte se faktorët që çuan në kënaqësinë e punës ishin të ndarë dhe të dallueshme nga kjo që çoi në pakënaqësi në punë. Prandaj, menaxherët që kërkonin të eliminonin faktorët që krijojnë pakënaqësi në punë mund të sillnin harmoni në vendin e punës, por jo domosdoshmërisht motivim. Faktorët e jashtëm që eliminojnë pakënaqësinë e punës janë quajtur faktorët higjienikë. Kur këta faktorë janë të përshtatshëm, njerëzit nuk do të jenë të pakënaqur, por nuk do të jenë as të kënaqur (ose të motivuar). Për të motivuar punonjësit në punën e tyre, Herzberg sugjeroi që të merren parasysh vecanërisht faktorët motivues e të cilët ishin faktorët e brendshëm si: arritja, njohja, përgjegjësia, përparimi dhe sfidat tjera që rrisnin kënaqësinë e punës (Robbin et al, 2014). Teoria e Herzbergut gëzonte një popullaritet të gjerë nga mesi i viteve 1960 deri në fillim të viteve 1980, por kishte edhe kritika lidhur me procedurat dhe metodologjinë e tij. Megjithatë sot ne themi se thelbi është i thjeshtë, ajo ka pasur një ndikim të fuqishëm në atë se si ne aktualisht modelohemi dhe behemi pjesë e ndërmarrjes. Noble mësoi se stafi General Y kishte një vijë të paqartë mes punës dhe jetës personale. Ata ishin të angazhuar në punën e tyre, dhe ata ishin plotësisht të gatshëm të regjistronin orë të gjata në telefonatat e klientëve deri në orën 11:00, me kusht që ata të mund të përditësojnë statusin e tyre në Facebook dhe thirrjet personale në çdo orë të ditës së punës. General Y punonte në hapësira të hapura, kështu që kompania së shpejti ka lëvizur në një zyrë të ajrosur në një ndërtesë të shekullit të nëntëmbëdhjetë në distriktin historik të Torontos dhe e

cila kishte kushte, ndricim dhe ambient të mirë, ku punonjësit ndiheshin shumë mirë. Në tabelën në vijim, është paraqitur klasifikimi i modelit dy faktorësh sipas Herzbergut.

Tabela 2. Faktorët e mirëmbajtjes dhe të motivimit dhe klasifikimi i tyre sipas Herzbergut.



Burimi: Mustafa (1997) modifikuar nga autori

Siç vihet re edhe në tabelën e paraqitur më lartë, dhe siç është cekur edhe më lartë, në njërën anë paraqiten ndjenjat e larta negative dhe faktorët e mirëmbajtës dhe në anën tjetër ndjenjat e larta pozitive dhe faktorët e motivimit të cilat më pas janë të ndarë në faktoret e pakënaqësisë dhe ata të kënaqësisë.


2.8.2.1 Krahasoni në mes të modelit të Herzbergut dhe të Maslowit

Frederick Herzberg bëri hetime për atë që shkaktonte kënaqësi dhe pakënaqësi në punë. Herzberg sipas teorisë së tij tregonte se egzistonin dy grupe faktorësh të cilët sjellnin kënaqësinë apo pakënaqësinë në punë. Ai po ashtu kishte analizuar mjaft mirë teorinë e Maslowit, ku kishte arritur që sipas tij ta perfeksiononte teorinë e vetë dhe të tregonte qartë për rolin dhe rëndësinë e teorisë së dy faktorëve në sjelljen e kënaqësisë dhe motivimit të punëtorëve. Puna dhe hulumtimet e tij u kryen në fund të viteve 1960, dhe nga hulumtimet e tij, rezultonte kërkesa në ristrukturimin e vendeve të punës, dhe vlerësimin e faktorëve që sillnin kënaqësi tek punëtorët, prandaj ai ishte i interesuar ti zbatonte gjetjet e tij në mënyrë që të mund të ndodhin përmirësime në hartimin dhe planifikimin e vendeve të punës dhe faktorëve që çonin në kënaqësinë e punonjësve dhe motivimin të tyre. Ai këmbëngulte së nëse do të zbatoheshin këto përmirësime do të çonin në rritjen e cilësisë së produkteve e po ashtu edhe në rritjen e motivimit dhe prodhimit.

Të gjithë njerëzit të të gjitha moshave, pozitive të tyre në ndërmarrje, kanë nevoja për dije dhe njohuri nga më të ndryshmet. Por nevojat bazë apo themelore konsiderohen ngrohtësia, ushqimi, veshëmbathja dhe strehimi. Kërkesa për arritjen e këtyre nevojave themelore është atëherë kur njerëzve u duhet të mbijetonin, dhe për mijëra vjet ishte gjithçka që shumica e njerëzve mund të shpresonin që të merrnin apo arrinin. Abraham Maslow, një psikolog amerikan i cili ka punuar në pjesën e mesme të shekullit të njëzetë, argumentoi se ne të gjithë kemi një hierarki nevojash. Ai theksoi se ne të gjithë dëshirojmë të arrijmë nivelin më të lartë të kësaj hierarkie. Megjithatë, para se të arrijmë në këtë nivel

më të lartë të nevojave, nivelet e ulëta të nevojave duhet të jenë të sigurta dhe plotësuar (Armstrong dhe Murlis, 2017). Në vijim është paraqitur figura, e cila krahason hierarkinë e nevojave të Maslow dhe modelin e faktorëve të motivimit sipas Herzbergut.

Figura 7. Krahase me Hirakatis së nevojave të Maslow-it dhe Modelit të faktorëve të motivimit sipas Harzbergut



Burimi: Mustafa (1997) modifikuar nga autori

Siç vihet re në modelin krahasues të Maslowit dhe Herzbergut është e qartë se egziston një ngjashmëri e madhe në mes tyre, mirëpo derisa Maslow ka bërë ndarjen e tyre në pesë kategori dhe dy nivele të nevojave primare dhe atyre sekondare, Herzbergu e ka bërë këtë ndarje në dy kategori, dhe për këtë arsye e ka quajtur teoria e dy faktorëve.

2.8.3. Teoria e motivimit të nevojave e McClelland-it

David McClelland-i na ka ndihmuar të kuptojmë motivimin brenda ndërmarrjes duke u përqendruar në aspektet e karakteristikave të personalitetit. McClelland-i dhe të tjerë kanë propozuar **teorinë e tri nevojave** e cila thotë se në situatat e punës gjenden tri nevoja ose motive madhore të rëndësishme dhe të cilat janë: a) Nevojat për pushtet-forcë, b) Nevojat për bashkim-lidhshmëri dhe c) Nevojat për arritje. Të tri këto shtytje (instikte): forca, lidhshmëria dhe arritjet, kanë rëndësi të veçantë për udhëheqjen dhe organizimin e mirë të ndërmarrjes, (Xhafa, 2011).

Në bazë të kërkimeve të thelluara, mundë të bëhen disa parashikime të mbështetura relativisht mirë rreth marrëdhënies mes nevojës për arritje dhe performancës në punë. Megjithëse në krahasim me nevojën për arritje, nevojën për pushtet dhe atë për bashkim janë bërë me pak kërkime, edhe në këto fusha janë zbuluar rezultate konsistente. Së pari individët me nevojë të lartë për arritje preferojnë ato situata në punë që karakterizohen nga përgjegjësia personale, feedback-u dhe një shkallë e ndërmjetme risku. Kur mbizotërojnë këto karakteristika, atëherë personat me nevojë të lartë për arritje janë shumë të motivuar. Së dyti, një nevojë e lartë për arritje nuk tregon domosdoshmërisht se dikush është menaxher i mirë - sidomos në ndërmarrjet e mëdha. Së treti, nevojat për bashkim dhe për fuqi janë të lidhura ngushtë me suksesin menaxherial. Menaxherët më të mirë kanë nevojë të lartë për pushtet dhe pak nevojë për bashkim. Nëse një vend pune kërkon një person me nevojë të lartë për arritje, menaxherët mund të zgjedhin një person që e zotëron këtëkarakteristikë ose e zhvillon këtë nevojë të kandidati i vet përmes trajnimeve për arritje

DeCenzo, (2001). Në tabelën e paraqitur më poshtë paraqitet krahasimi i modeleve të Maslow, McClellandit dhe Herzbergut dhe në të cilat shfaqen ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes tyre.

Tabela 3. Krahasim i modeleve të Maslowit, McClelland dhe Herzberg

Maslow • Klasifikimi i nevojave në primare dhe sekondare rregullohet në hierarkinë prepotente. • Zvogëlimi i nevojave te paplotësueshme (që mungojnë) ne hierarkinë e sjelljeve motivuese. • Kur njëherë nevoja plotësohet (kënaqet) nuk zgjat motivimi.
McClelland • Kryesore ne shkallet e larta të hierarkisë janë nevojat për sukses, fuqi dhe lidhshmëri. Kjo sot konsiderohet si mjaft e rëndësishme sepse nevojat e ulëta janë pothuajse plotësisht plotësuar.
Herzberg • Klasifikimi i nevojave ne faktorët higjienike dhe ato motivuesë • Qëndrimi se faktorët higjienike vetëm parandalojnë pa kënaqësitë. • Motivuesit të cilet veshtirë i përgjigjen shkallës së lartë të nevojave të Masloëit dhe nevojave sipas McGregorit në menyrë aktive ndikojnë në sjellje. • Për të motivuar, menaxheri duhet në radhë të parë të interesohet për natyrën e punës se tij.

Burimi: McClellandi cituar nga: Çelik (2001), modifikuar nga autori.

Nga ajo që shihet dhe është sqaruar mundë të konkludojmë se në thelb të tri teoritë kanë ngjashmeri mjaft të madhe në mes tyre. Ajo që vlen të theksohet është se derisa Masllowi dhe Herzbergu theksojnë rëndesinë e veçantë të të gjitha nevojave nga më e ulta deri tek ajo më e larta, McClellandi i trajton vetëm nevojat e larta pasi që sipas tij dy nevojat e para në hierarkinë e Masllovit pothuajse janë të plotësuar plotësisht.

2.8.4. Modeli ERG i Alderferit

Duke u bazuar në punën e Herzbergut dhe veçanërisht të Maslowit si dhe në kritikën që ju bënë teorive të tyre, Clayton P. Alderfer propozoi një alternativë tjetër të quajtur teoria ERG, e cila hierarkinë e nevojave të Maslow e kategorizon në tre nivele.

Në trajtimin e teorisë së nevojave gjegjësisht kënaqësive Teoria e Clayton P. Alderferit paraqitet me tri kategori të nevojave të cilat janë (Xhafa, 2011):

- a) *Nevoja e ekzistencës,***
- b) *Nevojat e lidhjes me të tjerët dhe***
- c) *Nevojat e rritjes.***


Kjo teori ndryshon shumë pak nga ajo e Maslow-it megjithatë kjo është më fleksibile dhe nuk e ruan radhën e kënaqjes së nevojave. Ajo pranon, që në raste të caktuara, individë të ndryshëm mund të thyjnë rregullin e ngurtë të hierarkisë së nevojave. Si sqarim të kësaj teorie mund të paraqesim rastin si përshtembull punonjësit apo individët e ndryshëm mund të kalojnë nga nevoja e ekzistencës si nevoja themelore në atë të rritjes, pra nevojën më të lartë superiore dhe anasjelltas pa kaluar fare në nevojën e lidhjes më të tjerët e cila radhitet si nevojë në mes të këtyre dy nevojave. Megjithatë edhe ky autor nuk ka bërë gjë tjetër përveçse e ka inkorporuar dhe thjeshtuar modelin nga teoria e Maslow-it nga pesë nivele në modelin e vet të quajtur teoria ERG, duke i përmbledhur ato në tri kategori apo nivele.

2.9. Teoritë procesorë të motivimit

Më lartë ne trajtuam grupin e parë të teorive të motivimit ato të përmbajtës, ndërsa tani do të trajtojmë grupin e dytë të teorive të motivimit të cilat janë teoritë e procesit. Ky grup i teorive sikur edhe ato të përmbajtjes kanë rendësinë dhe rolin e pazëvendësuar në lidhje me temën e shtjelluar të këtij disertacioni në motivimin e punonjesve.

Teoritë e procesit përfshijnë: Teorinë e pritjes së Vroomit, Teorinë e barazisë së Adamit, Teorinë e vendosjes së Locke-it dhe Teorinë e përforcimit të Skinnerit të cilat janë paraqitur në figurën e mëposhtme.

Figura 8. Teoritë e procesit të motivimit



Burimi: Autori


2.9.1. Teoria e pritjes së Vroomit

Teoria e pritjes së rezultateve, shpjegimi më i plotë dhe gjerësisht më i pranuar i motivimit deri në ditët e sotme është teoria e pritjeve e Victor H.Vroom-it. Teoria tregon se motivimi i njerëzve përcaktohet me vlerën që është rezultat i përpjekjeve dhe të cilat janë të shumëzuara më besimin. Megjithëse as kësaj teorie nuk i mungojnë kritikët, prapë se prapë ajo mbështetet nga shumë fakte që vijnë nga kërkimet. Teoria e pritjeve përfshin tre variabla ose lidhje (Xhafa, 2011):

- 1) **Lidhja përpjekje / performancë** - Probabiliteti i perceptuar nga individi se ushtrimi i një sasive të caktuar përpjekjesh do të sjellë performancë.
- 2) **Lidhja performancë / shpërblim** -Shkalla në të cilën individi beson se performanca e caktuar do të dërgon drejt arritjes së rezultateve dhe shpërblimit.
- 3) **Shkalla e tërheqjes** - Rëndësia që individi i jep rezultatit ose shpërblimit të mundshëm që mund të arrihet nëpërmjet punës.

Teoria e Vroomit mund të shprehet në modelin e paraqitur si më poshtë:

Figura 9. Modeli i motivimit sipas Vroomit



Burimi: Mustafa (1997), modifikuar nga autori


Sipas teorisë së V. H. Vroom-it individi apo punonjësi është ai i cili i kontrollon proceset, pra është ai i cili me veprimet e tij ndikon në rezultate në kënaqësi dhe motivim.

2.9.2. Teoria e barazisë (ekuitetit) sipas Adams J. Stacy

Studimet kanë treguar se perceptimi që kanë individët mbi shpërblimin dhe sidomos mbi drejtësinë në shpërndarjen e tij, është një faktor i rëndësishëm motivues. Këtë teori e karakterizon ndjenja e individëve për të qënë të barabartë në ndarjen e drejtë të shpërblimit. Ata janë më shumë të intërsuar në ndarjen e drejtë dhe të barabartë të pagave se sa në lartësinë e tyre, e gjith kjo është mjaft e qartë dhe lehtësisht e kuptuar kur individët apo punonjesit duan që të vlerësohen njëjtë dhe shpërblehen apo paguhën njëjtë për punën e njëjtë të bërë dhe rezultatin e njëjtë të arritur. Teoria e barazisë përmban rezultatet dhe shpërblimet ku hyjnë: avansimi, pranimi, vlera dhe statusi etj. Këto rezultate realizohen me angazhimin e inuteve materiale dhe punës njerëzore. Angazhimi i punës njerëzore është shprehur përmes pëpjekjeve dhe egzekutimit të detyrave të caktuara me qëllim të transformimit të inuteve në rezultate (Mustafa, 1997). Duke trajtuar këtë teori, parimisht themi se ndarja e shpërblimeve duhet të jetë e barabartë për të gjithë punonjësit dhe individët, kur ata kryejnë punën e njëjtë në sektore të ndryshme brenda një ndërmarrje duke pasur parasysh gjithnjë sasinë dhe cilësinë e njëjtë të prodhuar nga ata gjatë punës. Mirpo kur shpërblimi nuk është i barabartë dhe i drejtë, atëherë është e kuptueshme se personi A merr më shumë se personi B për punën e njëjtë dhe sasinë e njëjtë të prodhuar, apo anasjelltas kur personi A merr më pak se personi B si dhe kur personi A dhe B marrin të njëtin shpërblim për punën e njëjtë dhe sasinë e njëjtë. Këto tri lloj të relacioneve apo raportesh mund të shprehën në kënaqësinë dhe në ndryshimet e sjelljes së individëve, si pasojë e ndarjes së të ardhurave për shpërblim, që individit apo personi A dhe B të jenë të

kënaqur më shumë, të kënaqur apo aspak të kënaqur (Mustafa, 1997). Esencën e kësaj teorie mund ta prezantojmë dhe ta paraqesim në vijim me anë të kësaj figure.

Figura 10. Teoria e barabarësisë



Burimi: Mustafa (1997) modifikuar nga autori

Duhet theksuar fakti se nese individët apo punonjësit mendojnë dhe shohin se shpërblimet nuk janë të ndara drejtë ata do të jenë të pakënaqur dhe kjo pakënaqësi mund të rezultojë me zvogëlim të sasisë së prodhimit apo në të kundërtësim të saj.

2.9.3. Teoria e vendosjes së Locke-it

Teoria e vendosjes së qëllimeve u zhvillua nga psikologu dhe profesori i lëndës sëmotivimit Edwin A. Lock në vitin (1968) për të shpjeguar sjelljen njëzore në situata të veçanta të punës. Teoria e vendosjes së qëllimeve e Locke-it i referohet efekteve të cilat e kanë si qellim ngritjen e performancës në periudhën e mëvonshme. Ky autor nga studimet dhe hulumtimet e bëra erdhi në përfundimin se punonjësit të cilët vendosin qëllime specifike dhe të vështira arrinin të kishin një performancë më të lartë se sa ata të cilët i kishin qëllimet e lehta dhe të mira. Për më tepër përcaktimi i qëllimit është shpjegimi themelor i pothuajse të gjitha teorive kryesore të motivimit. Teoria e vendosjes së qëllimeve është njëra ndër teoritë me të respektuara në psikologjinë industrial - organizative, (https://en.wikipedia.org/wiki/Edwin_Locke).

Kjo teroi përmban disa parime themelore të cilat janë:

- 1) Qartësia.
- 2) Sfida.
- 3) Angazhimi.
- 4) Feedback-u, dhe
- 5) Kompleksiteti i punës.

Të gjitha keto parime të prekura më lartë si qartësia e qëllimit, sfida për punë komplekse, angazhimi dhe bashkëveprimi më të tjerët, feedback nga ajo që është arritur dhe realizuar si dhe kompleksiteti i punës ngrenë në nivel më të lartë performancën dhe motivimin e punonjësit.

2.9.4. Teoria e përforcimit, modifikimi i sjelljes sipas B.F. Skinner-it


Teoria e përforcimit, siç është propozuar nga psikologu i Harvardit, B. F. Skinner (1904-1990), i cili sugjeron që sjellja është e ndikuar nga pasojat. Ai argumenton se pasojat e jashtme ose përforcuesit nëse jepen menjëherë pas një sjelljeje, rrisin probabilitetin që sjellja do të përsëritet. Teoria e përforcimit fokusohet vetëm në atë që ndodh me një person kur ai ose ajo vepron. Sipas Skinner egzistojnë dy lloje të përforcimeve dhe ato janë: përforcimi pozitiv dhe përforcimi negativ. Kjo teori mund të shpjegohet si më poshtë: Njerëzit me shumë gjasa do të angazhohen në sjelljet e dëshiruara nëse shpërblehen për ta bërë këtë apo atë punë të caktuar dhe këto shpërblime janë më efektive nëse ata menjëherë ndjekin një sjellje të dëshiruar, dhe sjellja që nuk shpërblehet ose dënohet ka më pak të ngjarë të përsëritet.

Në përputhje me teorinë e përforcimit, menaxherët mund të ndikojnë në sjelljen e punonjësve duke forcuar veprimet që ata i konsiderojnë si të dëshirueshme. Megjithatë ndëshkimi eliminon sjelljen e padëshiruar më shpejt sesa mos-përforcimi, efekti i tij shpesh është vetëm i përkohshëm dhe mund të rezultojë në konflikte në vendin e punës. Hulumtimet kanë treguar se përforcimi është një ndikim i rëndësishëm në sjelljen e punonjësve, por nuk është shpjegimi i vetëm për dallimet në motivimin e të papunësuarve.

Në psikologjinë e sjelljes përforcimi është një pasojë e aplikuar që do të forcojë sjelljen e ardhshme të një individi sa herë që kjo sjellje paraprihet nga një stimul i veçantë paraprak, (<https://en.wikipedia.org/wiki/Reinforcement>).

Karakteristikat e kësaj teorie mund të shprehen nëpërmjet këtij modeli:

Figura 11. Modeli i përforcimit të ndërprerë



Burimi: Mustafa, (1997), modifikuar nga autori

2.10. Motivimi në teorinë e menaxhimit shkencor të Taylor-it

Frederick Winslow Taylor, i cili shkroi në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit njëzetë, zhvilloi idenë e studimit të punës ose studimin e kohës dhe lëvizjes. Hetimet e Taylor-it mbi mënyrën se si u kryen punët janë lejuar që të thyejnë detyrat poshtë në përbërësit e tyre bazë. Ai më pas ishte në gjendje që të krijonte mënyrën më të thjeshtë dhe efikase që të përfundonte detyrat dhe punët, dhe në të njëjtën kohë të ngriste rendimentin sa më shumë që ishte e mundur. Sipas Taylorit, punëtorët mund të prodhojnë më shumë rezultate nëse heqin përgjegjësinë për vendimmarrje dhe planifikim. Punëtorët nuk duhet të mendojnë, ata thjesht duhet ta bëjnë punën. Vëzhgimet e tij gjithashtu treguan se një qasje e qëndrueshme për punën nga punëtorët ishte mënyra më e mirë për ta arritur këtë, dhe kjo njeherësh krijonte efikasitet, qëndrueshmëri dhe motivim.

Ai argumentoi se në çdo vend pune metodat e përdorura nga punëtorët më efikas duhet të shfrytëzohen nga të gjithë punëtorët e tjerë. Prandaj, punëtorët duhet të trajnohen për të punuar në modelin e përdorur nga ata që prodhojnë më shumë prodhime. Kjo ide e menaxhimit shkencor merr atë që quhet një qasje "e orientuar nga detyra" për menaxhimin e punëtorëve. Kjo do të thotë se punëtorët thjesht mendohen si 'makina' për kryerjen e detyrave, megjithatë pavarësisht kesaj ata duhen vlerësuar nga menaxherët e tyre për punën dhe përkushtimin e tyre. Ai po ashtu argumentoi se ndarja e punës me copë (njësi) rriste angazhimin e punonjësve për arritjen e normës dhe tejkalimin e saj, duke ndikuar kështu drejtëpërsëdrejti në rritjen e motivimit dhe profitabilitetit të ndërmarrjes dhe kjo duhet të mbështetej dhe menaxhohej nga menaxherët e tyre.

2.11. Marrëdhëniet në lëvizjet humane shoqërore të bazuara në studimet e Elton Mayo-s

Elton Mayo dhe ekipi i tij punuan në fund të viteve 1920 dhe fillim të viteve 1930 në punimet Hawthorne të General Electric Company. Në një hulumtim studimor të bërë në vendin e punës ata po përpiqeshin të zhvillonin parimet shkencore të Taylor-it. Megjithatë, përmes punës së tyre ata zbuluan se dinamika e grupit mund të jetë më e rëndësishme se çdo formë financiare në motivimin dhe përcaktimin e modelit të punës dhe praktikave të punës. Ky hulumtim gjithashtu tregoi se mënyra se si trajtohen grupet e njerëzve dhe mënyra se si ata presin të trajtohen ndikuan në mënyrën se si ata punonin. Qëllimi i studimit

ishte të përcaktojë ndikimin e kushteve të ndryshme të punës në produktivitetin e punonjësve.

Fillimisht, Mayo shqyrtoi efektin e ndryshimeve në mjedisin e fabrikës, si ndriçimi dhe lagështia. Më pas ai vazhdoi të studioje efektin e ndryshimeve në marrëveshjet e punësimit si pushimet, orët e punës dhe udhëheqja menaxheriale. Përfundimi i tij kryesor ishte se pikëpamja mbizotëruese e kohës, ishte se njerëzit shkonin të punonin thjesht për para, dhe kjo pikëpamje nga të tjerët vlerësohet se ishte me të meta. Puna do të thotë shumë më tepër për individët se sa thjesht të fitosh para. Kjo para së gjithash ishte një aktivitet i grupit në të cilin individët e tjerë dhe sjellja e tyre ndikuan sa mirë punonin punonjësit. Morali dhe produktiviteti nuk u prekën aq shumë nga kushtet në të cilat individët punonin, por nga njohja që ata morën për punën që ata bënë. Ngritjet në produktivitet janë arritur nën syrin e interesuar të vëzhguesve, jo sepse kushtet i bënë punëtorët të ndiheshin mirë, por për shkak se punëtorët ndiheshin të vlefshëm dhe produktiv për ndërmarrjen.

2.12. Teoria X dhe Y e McGregor-it

Douglas McGregor (1906-1964), si një profesor i menaxhimit në Institutin e Teknologjisë në Masaçusets (MIT) Sloan School of Management, u përpoq të zbulojë përgjigjen e kësaj pyetjeje duke diskutuar për Teorinë X dhe Teorinë Y. Motivimi thelbësor (Extrinsic) i vjen nga jashtë personit dhe përfshin gjëra të tilla si paga, shpërblime, dhe tjera. Ndërsa motivimi i brendshëm reflekton dëshirën e brendshme të një personi për të bërë diçka dhe motivimi vjen nga interesi, sfida dhe kënaqësia personale. Individët tregojnë

motivim të brendshëm kur merren shumë me punën e tyre, kërkojnë mënyra për të përmirësuar punën e tyre dhe janë përmbushur objektivat duke e bërë atë mirë.

Teoria X e McGregor ofron një pamje thellësisht negative të njerëzve. Teoria pohon se punonjësit kanë ambicie të vogël, nuk e pëlqejnë punën, duan të shmangin përgjegjësinë dhe duhet të kontrollohen nga afër për të punuar në mënyrë efektive. Ajo sugjeron se njerëzit janë ekskluzivisht të nxitur nga motivatorë të jashtëm. Ndërsa Teoria Y e McGregor ofron një pamje krejtë tjetër pra një pamje pozitive për punonjësit. Kjo teori supozon se punonjësit mund të ushtrojnë vetëdrejtimin e punës, pranojnë dhe në të vërtetë kërkojnë përgjegjësi, ata e konsiderojnë punën si një aktivitet natyror po ashtu ata janë kërkuar dhe inovator.

McGregor besonte se hipotezat në Teorinë Y kapën më mirë motivimin e punonjësve dhe duhet të udhëzojnë praktikën e menaxhimit pra që menaxhimi ta vlerësonte dhe zbatonte këtë teori në ndërmarrjet e tyre. Ai propozoi që pjesëmarrja në vendimmarrje, punë të përgjegjshme dhe sfiduese si dhe marrëdhëniet e mira në grup janë ato që do të rrisnin motivimin e punonjësve. Njohuritë tona të motivimit na tregojnë se as teoria Y nuk është plotësisht në llogari të sjelljes së të punësuarve. Ajo që dimë është se motivimi është rezultat i bashkëveprimit të individit dhe situatës. Individët ndryshojnë në lëvizjen e tyre themelore motivuese kundrejt situatës së krijuar. Po ashtu punonjësit mund të motivohen apo të entuziazmohen, derisa bën kompletimin e një detyre më atraktive se sa ndajdonjë detyre tjetër të mërzitshme apo rutinore. Këto pika nënvizojnë idenë se niveli i motivimit ndryshon midis individëve dhe brenda individëve në kohë të ndryshme.

Në tabelën në vijim paraqitën karakteristikat e McGregorit për teorinë x dhe teorinë y.

Tabela 4. Karakteristikat e McGregorit për Teorinë X dhe Teorinë Y

TEORIA - X	TEORIA - Y
1. Individëve nuk u pëlqen puna dhe nuk dëshirojnë të punojnë, do t'i shmangen asaj nëse është e mundur. 2. Pasi që individëve nuk u pëlqen puna, duhet t'i detyrojmë, kontrollojmë, orientojmë dhe ti frikësojmë me dënime, për të dhënë mundin përkatës për arritjen e qëllimeve të ndërmarrjes / organizatës. 3. Personi i zakonshëm dëshiron siguri, ka pakë ambicie dhe do t'i shmanget përgjegjësisë. 4. Punëtorët duhet të udhëhiqen dhe t'u tregohet çfarë të bëjnë. 5. Pak njerëz janë vërtete kreative. 6. Kapacitetet intelektuale të kufizuara të punëtorëve të zakonshëm janë sfide e punës moderne.	1. Njeriut puna i është e natyrshme si loja dhe e bënë atë me dëshirë. 2. Nëse ka qëllime të kënaqshme, me kënaqësi do të ndërmarrë çfarëdo mundimi, njeriu kërkon përgjegjësi dhe e pranon atë. 3. Individët/ punonjësit do të zbatojnë vetëorientimin dhe vetëkontrollin në arritjen e qëllimeve të organizimit aq sa janë të lidhur me ato qëllime. 4. Personi i zakonshëm mësohet jo vetëm të pranojë por edhe të kërkojë përgjegjësi etj. 5. Shumica e njerëzve janë të aftë të jenë kreative, duke ushtruar mendjehollësinë dhe të jenë imagjinatave. 6. Kapacitetet individuale të punëtorit të zakonshëm nuk shfrytëzohen plotësisht në rrethin industrial modern.

Burimi: Mustafa (1997), Çelik (2001), modifikuar nga autori.

Autorë të ndryshëm sugjerojnë që menaxherët duhet të përpiqen dhe të sigurohen se situatat janë motivuese për të punësuarit në ndërmarrjet e tyre. Teoria x dhe y e McGregorit bënë një diferencim të qartë të dy llojeve të punonjësve, prandaj pikërisht për këtë arsye kjo teori ka një rëndësi të veçantë në dallimin e punonjësve inovator dhe kreativ dhe të atyre pertac dhe të zakonshëm.

2.13. Personaliteti në modelin organizativ të Argyris-it

Chrys Argyris (1923 – 2013), Teoria e Argyrisit gjithashtu pohon se komunikimi i hapur brenda një ndërmarrje, që normalisht konsiderohet si një gjë e mirë, megjithatë mund të bllokojë të mësuarit dhe të pengojë progresin nëse udhëheqësi kthehet si mbrojtës i vendimeve të veta dhe bënë mohimin e problemeve reale. Po ashtu një veprim i tillë mund të shfaqë paaftësinë për t'u përballur me çështje të vështira dhe problematike si dhe refuzimin për të shqyrtuar qëndrimet dhe kontributet e veta ndaj problemeve në ndërmarrje.

Ky autor i kushton kujdes të veçantë metodave që udhëheqësi mund t'i përdorë për zvogëlimin e shkallës së jo harmonizimit të këtyre raporteve mes individëve dhe organizimit formal (Koenig, 2012).

Për ta përmbledhur më në hollësi dhe sqaruar teorinë e maturimit nga aspekti organizativ më poshtë do ta paraqesim edhe modelin organizativ të sistemit të vlerave sipas Chris Argyrisit. Modeli i paraqitur është i ndarë në dy grupe në atë pasive dhe aktive si dhe në shtatë faza apo gjëndje në të cilat kalon individi, punonjësit dhe menaxherët.

Karakteristikat e modelit të organizimit të sistemit të vlerave mund të shihen nga figura e paraqitur më poshtë:

Figura 12. Modeli i organizimit të sistemit të vlerave sipas Chris Argyris-it



Burimi: <https://mercureaace2013.wordpress.com/> modifikuar nga autori


Në modelin e paraqitur tregohet sistemi i vlerave organizative të maturitetit nga aspekti i dy gjendjeve, nga ai i para maturitetit apo pjekurisë dhe ai pas maturitetit apo pjekurisë, njëkohësisht në model tregohën qartë veprimet e menaxherëve dhe punonjësve që duhen të jenë për të krijuar kënaqësi për punonjësit dhe fitim për ndërmarrjen.

2.13.1. Modeli i Porter-it dhe Lawler-it

Ishte studimi i ndërmarrë nga dy autorët L.W.E Porter dhe E.E. Lawler të cilët e ridimensionuan modelin e Vroom-it, duke e trajtuar shpërblimin si një variabël intervenues, duke e studiuar motivimin, kënaqësinë dhe performancën si variabla të veçanta, prandaj pikërisht për këtë këta dy autorë janë përpjekur të shpjegojnë natyrën komplekse të marrëdhënieve që ekzistojnë midis tyre në mënyrë të ndryshme nga pikëpamja tradicionale (Girardone et al, 2006).

Porter dhe Lawler, e kanë përshkruar kështu modelin e dhënë prej tyre: “Njerëzit rrallë ulen dhe dëgjojnë rezultatet e pritshme për një sjellje të zgjedhur prej tyre, apo të vlerësojnë valencat dhe parashikimet dhe të bëjnë llogaritjet totale, vetëm në qoftë se një gjë e tillë u kërkohet nga studiuesit. Keta autor veqonin dhe theksonin në menyr të veçantë se motivimi i individëve dhe punonjësve varet dhe shkaktohet nga tre elementët kryesorë e që janë përpjekjet, performanca dhe kënaqësia. Gjithashtu ata treguan në njëren nga pikat kryesore të modelit të tyre se jo domosdoshmërisht përpjekja dhe motivimi çojnë në performancë edhe pse në fund të fundit kënaqësia po që çonë në performancë. Megjithatë ata i shqyrtojnë dhe vlerësojnë rezultatet dhe më pas në bazë të këtyre rezultateve ata i zgjedhin alternativat dhe i përdorin këto vlerësime kur duhet të marrin një vendim mbi atë që duhet të bëjnë, Llaci (2011). Duke veçuar që modeli i motivimit i punuar dhe modeluar nga autorët Porter dhe Lawer ka një rëndësi të veçantë në motivimin e punonjësve dhe individëve, në vijim do të paraqitet edhe në mënyrë figurative modeli i motivimit të këtyre autorëve.

Figura 13. Modeli i motivimit nga Porteri dhe Laweri



Burimi: <https://www.google.com.motivations.models> from Porter and Lawler.

Sikurse është cekur edhe më lartë modeli është i thjeshtë por ai paraqet mjaft qartë elementet dhe faktorët të cilet në menyrë të drejtëpërdrejtë impaktojnë motivimin duke arritur në kënaqësinë e punonjësve dhe performancën e tyre më të mirë. Padyshim që ketu nuk mund të anashkalohet elementi i barazisë së shpërblimeve si dhe ndikimet e shpërblimeve të jashtme dhe të brëndeshme të cilat po ashtu ndikojnë në menyrë të drejtëpërdrejtë në kënaqësi dhe më pas edhe në performancë gjithashtu.

2.14. Teoria e motivimit nëpërmjet vendosjes se objektivave – (SDT)

Teoria e vetëvendosjes (SDT), është një teori makro e motivimit dhe personalitetit njerëzor e cila ka të bëjë me tendencat natyrore të rritjes njerëzore dhe nevojat psikologjike. Kjo teori ka të bëjë me motivimin e individëve pas zgjedhjeve që ata bëjnë pa ndikim dhe ndërhyrje të jashtme. Teoria shqyrton se si kushtet biologjike, shoqërore dhe kulturore ose rrisin ose minojnë kapacitetet e qenësishme njerëzore për rritjen psikologjike, angazhimin dhe mirëqenien, si në përgjithësi po ashtu edhe në fusha specifike të saj. Në këtë kuptim SDT-ja si teori e vetëvendosjes, nuk është një kornizë relativiste, ajo ndikon më konceptin e vetë universal në lëndët ushqyese shoqërore dhe kulturore që kërkohen për të mbështetur funksionimin psikologjik dhe të sjelljes së individit. SDT në mënyrë specifike supozon se njerëzit kanë evoluar të jenë qenie thelbësore, aktive fizike, dhe thellësisht qenie shoqërore. Hulumtimi i SDT-së fokusohet në mënyrë të veçantë tek faktorët e brendshëm në zhvillimin individual dhe brenda kontekstit shoqëror që lehtësojnë vitalitetin, motivimin, integrimin social dhe mirëqenien e punonjësve. Është e qartë se është në "natyrën" tonë për të rritur dhe evoluar kapacitetet tona për të arritur shkallë më të mëdha të funksionimit të shëndoshë psikologjik, shoqëror dhe të sjelljes, si dhe për të kuptuar më shumë kapacitetet tona njerëzore dhe talentet tona individuale. SDT-ja përdor në këtë mënyrë të dy studimet, eksperimentale dhe vëzhgime në terren.

Që nga fillimet e para, njerëzit shfaqin tendenca të brendshme për t'u interesuar, për të studiuar thellësisht dhe për të fituar zotërim në lidhje me botën e tyre të brendshme dhe të jashtme. Këto përfshirje përfshijnë prirjet e qenësishme për të eksploruar, manipuluar

dhe kuptuar motivimin e brendshëm dhe prirjen për të përcaktuar normat dhe rregullat shoqërore përmes internalizimit dhe integritit aktiv (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018).

E rëndësishme brenda SDT-së është ideja se këto prirje aktive për motivimin e brendshëm, internalizimin dhe integritin shoqëror janë të shoqëruara me kënaqësi specifike dhe të bazuara në të vërtetën. Këto kënaqësi të brendshme reflektojnë, në kuptimin më të thellë, thelbin e njeriut që lulëzon dhe ata parashikojnë çdo numër treguesish të mirëqenies dhe vitalitetit. Për më tepër, dokumentet kërkimore të SDT-së sqarojnë se në kontekstin shoqëror në të cilin ekziston mbështetje psikologjike për këto kënaqësi, kureshtja e njerëzve, kreativiteti, produktiviteti dhe dhembshuria janë shprehur mjaftë fuqishëm. SDT sjell këtë pikëpamje funksionale në studimin e rritjes dhe zhvillimit psikologjik dhe duke bërë kështu që kjo teori të heton disa nga karakteristikat themelore dhe mekanizmat themelorë të sjelljes shoqërore pastaj zhvillimin e saj dhe patologjinë, (Ryan dhe Deci, 2017).

Duke identifikuar dhe matur llojet e ndryshme të rregullimit motivues dhe kushtet që i nxisin ato, SDT-ja mund të përdoret mjaft mirë dhe në mënyrë sistematike dhe në mënyrë të menduar në kuadër të konteksteve të ndryshme sociale, duke përfshirë familjet, klasat, ekipet sportive, klinikat shëndetësore, mediat interaktive dhe vendet e ndryshme të punës. (Cicchetti. 2006),(Ryan, Kuhl & Deci, 1997), (Vansteenkiste & Ryan. 2013).

2.15. Përcaktuesit e sistemit motivues në ndërmarrje

Motivimi përfaqëson fazën e procesit të menaxhimit, që është edhe funksioni bazë i menaxhimit, i cili në të njëjtën kohë përcakton suksesin e menaxhimit. Me fjalë të tjera, motivimi është vullneti i brendshëm i individit që shtyn atë të sillet në një mënyrë që u mundëson pjesëmarrësvetjerë në jetën e biznesit të një ndërmarrje që të identifikojnë vetën e tyre me objektivat e ndërmarrjes, dhe të marrin vendime të cilat janë në përputhje me objektivat e vendosura (Cheng, 2009). Suksesi i menaxhimit është i përcaktuar përveç faktorëve të tjerë edhe nga aftësia e menaxherëve për të ndikuar në sjelljen e vartësve të tyre, në mënyrë që ata ta bëjnë atë që ai e dëshiron dhe që është në përputhje me arritjen e objektivave të ndërmarrjes, si dhe të asistojë dhe ndihmojë në aspiratat tyre individuale dhe në objektivat e dhëna. Në këtë kuptim, është e nevojshme që vazhdimisht punonjësit të përkushtohen me aftësitë e tyre për arritjen e qëllimeve të përbashkëta, të cilat do të jenë të arritshme nëse punonjësit do të mund të njohin përfitimet e tyre që do të rezultojnë me arritjen e këtyre qëllimeve. Kjo supozon faktin se objektivat e ndërmarrjes duhet të përcaktohen qartë, nga ajo që është, dhe ajo që duhet të jetë. Po ashtu duhet të jetë i qartë qëllimi dhe objektivat në të dy drejtimet në ato vertikale, (në drejtim të objektivave superiore) dhe horizontal (në drejtim të objektivave të barabarta), si dhe marrëdhëniet e njohura dhe efektive mes realizimit dhe shpërblimit, (Stevanović, 2000). Menaxhimi i suksesshëm i sjelljes së punonjësit kërkon njohuri të disa teorive përkatëse të motivimit si njohuri të sjelljes së punonjësit etj. Këto teori i kemi cekur edhe më lartë dhe kategorizohen në dy lloje: në teoritë e përmbajtjes dhe teoritë e procesit të motivimit, (Malinić, 2000).

2.16. Koncepti i angazhimit organizacional

Koncepti i angazhimit organizativ i referohet reagimeve emocionale të punonjësve ndaj ndërmarrjes. Ai është i lidhur me ndjenjat e lidhjes ndaj objektivave dhe vlerave të ndërmarrjes/ organizatës, (Cook, 1980). Angazhimi i punonjësve është studiuar në sektorin publik dhe atë privat nga aspekti ndërkombëtar. Kërkimet e mëparshme fokusoheshin në përcaktimin e konceptit, ndërsa kërkimet e tanishme vazhdojnë të ekzaminojnë angazhimin organizativ nëpërmjet dy qëndrimeve, angazhimin e lidhur me qëndrimet dhe angazhimine lidhur me sjelljet. Në literaturën ekzistuese gjenden shumë përkufizime rreth konceptit të angazhimit të punonjësve. Hunt dhe Morgan (1994) venë në dukje që angazhimi organizativ është përcaktuar si shumë dimensional në natyrë, duke përfshirë besnikërinë e punonjësve ndaj ndërmarrjes, pastaj gatishmërinë që të përpiqen për të mirën e ndërmarrjes, dhe dëshirën për të qëndruar si pjesë e saj. Allen & Meyer (1990) e përkufizojnë angazhimin e punonjësve si një gjendje psikologjike që karakterizon marrëdhëniet e punonjësve me ndërmarrjen/ organizatën dhe e cila ka implikime për vendimin e tyre për të vazhduar qëndrimin e tyre në ndërmarrje si pjesë e saj. Kryerja e punëve rregullisht dhe me përkushtim ndihmon në mbrojtjen e aseteve dhe në besimin për arritjen e objektivave dhe qellimeve të caktuara të ndërmarrjes. Punonjësi ndikon pozitivisht në ndërmarrje për shkak të angazhimit dhe përkushtimit të tij ndaj saj.

Angazhimi organizativ është i lidhur me rritjen e kënaqësisë, performancës dhe përshtatjes ndaj ndërmarrjes, kurse ulet me rritjen e qarkullimit të punonjësve, (Meyer & Becker, 2004).

2.17. Strategjitë menaxheriale për rritjen e motivimit

Nga aspekti i mundësive për të përcaktuar sasinë dhe shprehinë e faktorëve të motivimit, egzistojnë dy grupe të faktorëve (Malinić, 2000):

- a) Faktorët që mund të kuantifikohen si të vlefshme dhe që janë të përfshirë në programet e ndërmarrjes dhe në kontabilitet. Duke u bërë kështu komponentë cilësorë të sistemit të motivimit të ndërmarrjes, dhe
- b) Faktorët që nuk mund të kuantifikohen si të vlefshme, apo të drejtpërdrejtë të cilët në përgjithësi janë të kyçur në procedurën e kontabilitetit, kështu që ata më shumë janë komponentë sasiorë të sistemit të motivimit të ndërmarrjes.

Faktor kyç i sistemit të motivimit të ndërmarrjes është kompensimi financiar për punën e investuar. Paratë janë të dobishëm në të gjitha situatat dhe si një mjet këmbimi ato i mundësojnë punonjësit të zgjedhin një mënyrë më të mirë për të kënaqur të dy nevojat e tyre ekzistenciale e po ashtu edhe nevojat e nivelit më të lartë, me fuqinë e tyre universale blerëse (Cheng, 2009). Rëndësia relative motivues e saj zvogëlohet kur standardi i jetës bëhet më i lartë, kështu që krijimi i një sistemi të përshtatshëm i motivimit të ndërmarrjes nënkupton disa motivues të tjera të mundshme, të tilla si - shpërblime dhe material ose stimulimet etike, si kënaqësi për suksesin në performancë etj, Malinić (2000). Megjithatë është e nevojshme që për ngritjen e motivimit të përcaktohen strategji të qarta dhe të kapshme si nga ana e punonjësve po ashtu edhe nga ana e ndërmarrjes dhe menaxhimit të saj me qëllim të rritjes së motivimit.

Disa nga strategjitë të cilat duhen ndjekur për ngritjen e motivimit janë:

- a) Përgjegjësia për detyrat e pranuar dhe përpjekjet e kërkuara për realizim,
- b) Mundësitë për kërkime dhe krijimtari në fushën e dëshiruar,
- c) Mundësia për avancim në hierarkinë e strukturës së menaxhimit të ndërmarrjes ose pjesëve të ngushta organizative dhe njësive të saj,
- d) Ndjenja e kënaqësisë me rezultatet e arritura dhe objektivat e përcaktuara,
- e) Atmosfera kolegjiale dhe marrëdhëniet personale në vendin e punës,
- f) Kushtet e punës, mjedis i sigurt dhe i pastër me kushte të mira dhe të favorshme për punë,
- g) Mënyra e kryerjes së aktiviteteve menaxheriale dhe mënyra e sjelljes ndaj të punësuarve,
- h) Zhvillimi personal, profesional dhe pasurimi i punës,
- i) Pjesëmarrja në vendimmarrje dhe negociata kolektive, si dhe
- j) Prestigji, statusi dhe reputacioni, etj.

2.18. Komunikimi dhe sjellja menaxheriale

Kuptimi për menaxhimin e performancës dhe mënyra se si ta zbatojmë atë në mënyrë efektive ka ndryshuar rrënjësisht në vitet e fundit. Kohët e fundit, sidomos në fillim të viteve të 90-ta, menaxhimi i performancës shpesh ishte përshkruar në një mënyrë tjetër dhe atë si një sistem më i sofistikuar për vlerësimin e performancës. Kjo shpesh u zbatua

më shumë për të siguruar një vlerësim të mirë se sa për të nxitur një rezultat pagese më të lartë, duke zbatuar një sërë procesesh që mundësuan ndërmarrjet dhe individët të përqëndrohen në mënyrë efektive dhe në thellësi në krijimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të një kulture të performancës së lartë. Idetë dhe konceptet e vjetra kërkojnë kohë për të vdekur dhe vlerësimi nuk mund ti beshë përjashtim. Ajo është ende pjesë e foljes së zakonshme në shumë ndërmarrje dhe dallimet e saj "lart-poshtë" si "prind-fëmijë" vazhdojnë të hyjnë në rrugën e qasjeve shumë më thellë që po zhvillohen dhe përdoren në ndërmarrjet udhëheqëse në mbarë botën. Menaxhimi mori një përkufizim të ri në fillim të viteve të 90-ta, si një proces për krijimin e një mirëkuptimi të përbashkët rreth asaj se çfarë duhet të arrihet dhe se si duhet të arrihet. Kjo i dha një qasje të re menaxhimit të njerëzve që rritë probabilitetin e ngritjes së performancës dhe suksesit. Ndryshimet në këtë përkufizim vijnë nga një varg burimesh, si nga puna e Hay Group në fillim të viteve të 90-ta, po ashtu edhe nga konsulentët dhe praktikuesit e tjerë, e sidomos nga Armstrong dhe Baron, pastaj Weiss dhe Hartle, si dhe Satterfield e më së fundmi edhe nga Houldsworth dhe Jirasinghe. Të gjithë ata janë pajtuar që janë të vërtetat e qëndrueshme ato që i nënshtrohen menaxhimit efektiv të performancës. Këto të vërteta përqendrohen në rëndësinë e proceseve mbi sistemet, rëndësinë kritike të planifikimit të frontit e jo shqyrtimit të prapavijës dhe të cilat krijojnë zhvillim të mirëkuptimit të përbashkët. Rëndësia e menaxhimit dhe zhvillimit të njerëzve me ndjeshmëri dhe imagjinatë si individë të duhur në një mënyrë rritë kontributin e tyre dhe të menduarit holistik rreth asaj që është e nevojshme për të prodhuar rezultat dhe sukses. Ajo njih rëndësinë e rritjes së përdorimit të përpjekjeve diskrecionare dhe zbatimit praktik të sjelljeve që lidhen me inteligjencën

emocionale. Ai njih rëndësinë e matjes së rezultateve së bashku me sjelljet e përdorura për arritjen e tyre.

Ekziston një vazhdimësi e të mësuarit në fushën e menaxhimit të performancës. Shumica e ndërmarrjeve fillojnë me vlerësimin e performancës në afate të ndryshëm kohore duke filluar nga ato tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, por ka nga ato që vlerësimet i bëjnë edhe më shpesh sidomos në fazën fillestare të punësimit të individit. Nga vlerësimi menaxhimi dhe ndërmarrja mbledh informacione për performancën e punonjësit pastaj ngecjet dhe arritjet që shfaqen tek ai dhe po ashtu ata mësojnë nga ajo se çka shkon mirë apo keq dhe ku duhet të ndërhyhet dhe përmirsohen gjërat në të ardhmen. Një grup i formave të modeluara mirë dhe një paketë trajnimi për aftësitë e vlerësimit do të ishin dy faktorë të rëndësishëm për një vlerësim të saktë dhe profesional. Mirëpo nëse këta faktorë nuk merren parasysh, dy çështje themelore vihen në rrezik. E para nga këto mund të jetë ndikimi negativ në ndërmarrje dhe e dyta do të ishte po ashtu ndikimi negativ në grupin apo në tërë kolektivin e ndërmarrjes. Vlerësimi vjetor i hartuar nga specialistët e personelit dhe i lëshuar me një sërë formash dhe një manual është, puna e projektimit, që zakonisht nuk shihet nga udhëheqësit apo punonjësit sado e shkëlqyeshme është ajo për arritjen e qëllimeve dhe planeve organizative (Robbin et al, 2014). Ajo shihet si një barrë shtesë në një jetë gjithnjë e më të zënë të punës nga shumica e njerëzve në një ndërmarrje dhe shpesh përpiqen ta shmangin atë. Shtojani kësaj çështje tjetër themelore, shkallën në të cilën vlerësimi themelor i trajnimit të aftësive në të vërtetë rritë aftësinë e menaxhimit për të hyrë në shkaqet themelore të përmirësimit të performancës, dhe ju prapë mund të keni një sistem të destinuar për tu nënçmuar. Dhe pikërisht kjo ka ndodhur. Të dy autorët e këtij libri

kanë bërë kërkime të gjera dhe vlerësime se sa mirë ka punuar vlerësimi i performancës. Që nga fillimi i viteve të nëntëdhjeta, shumë ndërmarrje kanë gjetur një qasje krejtësisht sasiore për menaxhimin e performancës dhe matjen e dëshiruar. Kuptimi që ata filluan të zhvillojnë në vlerën e kompetencave si dhe në përcaktimin e standardeve të performancës së pragut dhe përcaktimin e sjelljeve të shoqëruara me përsosmërinë çuan në përfshirjen e kompetencave në proces, zakonisht me lidhje të forta dhe me planifikimin e zhvillimit personal. Pas kësaj u shfaqën të ashtuquajturat 'modele të përziera' që i lejonin menaxherët dhe stafin e tyre të shihnin si dhe me çfarë sistemi të performancës dhe mënyrës së vlerësimit këto ishin të lidhura. Korniza e kompetencës u bashkua me objektivat e fokusuar ndajë rezultateve në kërkim për përmirësimin e performancës. Lidhja me zhvillimin u forcua dhe fokusi në komponentët e performancës individuale u përforcua. Matja, siç konfirmon hulumtimi i Houldsworth dhe Jirasinghe, vazhdon të mbetet e rëndësishme dhe me të vërtetë vlerësohet nga të gjithë të përfshirët për qartësinë që ofron. Por, thjesht duke kapërcyer objektivat strategjike është provuar në copa të vogla nëpër shtresa të ndryshme të çdo ndërmarrje, por që ka pasur një paraqitje problematike në realizim dhe egzekutim. Ekziston një fazë, kur nuk është gjithmonë e lehtë të zbërthehet përgjegjësia individuale, sepse objektivat duhet të ndahen dhe të shpërndahen në baza kolektive. Ata kanë nevojë, në informacionin dhe ndërfaqen e konsumatorëve, që të përcaktohen në aspektin e sjelljeve të kërkuara dhe jo në rezultatet e vështira. Për shembull, në rolet e shërbimit të klientit, kompetencat mund të jenë elementi më i rëndësishëm i performancës, ndërsa në nivelin më të lartë të menaxhimit do të dominojë shpërndarja e rezultateve nga drejtuesit e lartë që të arrijnë rezultatet e tyre ku është një interes në rritje në ndërmarrjet udhëheqëse. Arritja e rezultateve të shkëlqyera, duke lënë rrënojat ose duke u

larguar nga aftësia e të tjerëve vetëm për të arritur objektivat, është gjithnjë e më pak e toleruar dhe ka rezultuar në mosmarrëveshje të larta ekzekutive në sektorin publik dhe privat. Në nivele shumë të vogla, të pakualifikuara, në role të përqendruara vetëm në përmbushjen e detyrës, kompetencat mund të jenë më pak të rëndësishme dhe sasia e roleve të ardhura nga burimet e jashtme në ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar po zvogëlohet shpejt (Armstrong, 2010). Performanca gjithnjë e më shumë po shqyrtohet në aspektet profesionale, inovative dhe cilësore duke mos hedhur poshtë edhe ato sasiore. Interes të larte në rishikimin e grupit të bashkëmoshatarëve, në proceset e menaxhimit të performancës së ekipit dhe proceset me 360° shkallë, po udhëheqin në shumë vende më një qasje më të drejtëpërdrejtë dhe më të thellë. Kjo nënkupton një integrim shumë më të madh me axhendën e zhvillimit dhe të menaxhimit të talenteve në të gjithë ndërmarrjen dhe me arsye, ajo bën lidhje të forta dhe të drejtëpërdrejta me pagën si një faktor i ndjeshëm.

Së fundi, ky është një zhvillim relativisht i ri i lindur nga peripecitë e iniciativave të menaxhimit të ndryshimeve, ku menaxhimi i performancës tani po përdoret nga ndërmarrjet kryesore që i nënshtrohen ndryshimit si një proces kyç në rrugëtimin e tij. Kjo është një mënyrë për të siguruar dhe ngushtuar hendekun në mes të asaj se ku është ndërmarrja tani dhe ku ajo deshiron dhe synon të jetë në të ardhmen. Në mënyrë sistematike ajo duhet ti shtyjë proceset e tjera të nevojshme përpara për ta bërë këtë të ndodhë dhe zbatohet sipas një plani që e lidhë atë me synimet e saja për të ardhmen, me një ndikim shumë të madhku do të kenë edhe ekipet përgjegjëse për ofrimin e njohurive të tyre në këtë drejtim. Në këtë fazë menaxhimi i performancës është se si gjërat bëhen dhe si ato duhen bërë, dhe është bërë vërtet një proces thelbësor i menaxhimit nga menaxherët dhe drejtuesit e saj.

Dhe si përfundim sikurse theksojnë disa autorë nga ta edhe Satterfield, 'në vend se të humbasësh shumë kohë për proceset dhe procedurat për të menaxhuar performancën, ajo padyshim se do të ndodhë si rezultat i natyrshëm i një sistemi të karakterizuar nga lidhshipi efektiv, po ashtu edhe i nevojave të ndërmarrjes dhe personelit të saj.

2.19. Menaxhimi i performancës si indikator motivimi dhe suksesi në ndërmarrje

Për menaxherët është e rëndësishme që t'i bëjnë punonjësit e tyre të arrijnë ato nivele të performancës që ndërmarrja i konsideron të dëshirueshme dhe pa dyshim të pranushme. Metoda zyrtare e ndërmarrjeve dhe institucioneve për të vlerësuar performancën e punonjësve në punë është procesi i vlerësimit sistematik i performancës. Menaxhimi i performancës gjithnjë fokusohet në një planifikim sa më të mirë të performancës për të ardhmen, por njekohësisht ata punojnë edhe në përmirësimin e saj në të tashmen duke bërë që vlerësimi i performancës të jetë sa më real dhe efikas. Ajo funksionon si një proces i vazhdueshëm dhe evolutiv, ku performanca përmirësohet me kalimin e kohës dhe siguron bazën për dialogë të rregullt dhe të shpeshtë ndërmjet menaxherëve dhe individëve në lidhje me nevojat e performancës dhe zhvillimit të saj. Kjo ka të bëjë kryesisht me performancën individuale, por ajo gjithashtu mund të aplikohet edhe për performancën ekipore. Sistemi i menaxhimit të performancës është proces i përcaktimit të standardeve të performancës dhe i vlerësimit të saj në mënyrë që të merren vendime objektive në lidhje me burimet njerëzore, të tilla si rritjet e pagave ose nevojat për trajnime

si dhe të mblidhet dokumentacioni i nevojshëm në mbështetje të çdo veprimi që ndërmerret ndaj personelit në ndërmarrje (DeCenzo, 2012).

Qëllimi i përgjithshëm i menaxhimit të performancës është të kontribuojë në arritjen e një organizimi të lartë në performancë. Arritja e efikasitetit të lartë do të thotë arritja e qëllimeve dhe tejkalimi i pritjeve të përcaktuara në lidhje me produktivitetin, cilësinë, shërbimin e konsumatorëve, për të rritur fitimet dhe vlerën e ndërmarrjes.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi i menaxhimit të performancës është që të bëjë një organizim të mirë, që i referohet proporcionit dhe të kuptuarit e asaj që ne duam të arrijmë nëkuadrin e saj. Po ashtu menaxhimi i performancës ka për qëllim që të zhvillojë aftësinë e njerëzve pastaj të mbështesë dhe udhëzoj individët drejt arritjes së rezultateve më të larta në mënyrë që të përdorin potencialin e tyre të plotë për të arritur një mirëqenie më të mirë për vetën e tyre dhe rrjedhimisht edhe për ndërmarrjen.

Gjithashtu është e qartë dhe relative se roli i menaxhimit të performancës ka të bëjë me përafrimin e objektivave individuale dhe objektivave organizative, në mënyrë që të sigurojë që individët të përkrahin vlerat thelbësore të ndërmarrjes apo institucionit ku ata janë duke punuar dhe vepruar. Ai siguron që të përcaktohen pritjet për të rënë dakord në aspektin e përgjegjësisë të rolit duke u bazuar në aftësitë dhe në sjelljet e individit. Qëllimi është që të zhvillojë kapacitetin e njerëzve për të përmbushur dhe për të tejkaluar pritjet, për të arritur potencialin e tyre të plotë për të mirën e tyre dhe të ndërmarrjes. Këto janë qëllimet e menaxhimit të performancës, të shprehura nga një shumëllojshmëri e ndërmarrjeve apo kompanive (Burimi: IRS Tendencat e punësimit, 2003).

Njëkohësisht fokusimi në detyrat e punonjësve, në gjërat e duhura që ata duhet të bëjnë dhe duke i bërë ato në mënyrë të drejtë, si dhe përafrimi i qëllimeve individuale i të gjithëve me qëllimet e ndërmarrjes janë synimet dhe objektiva për të gjithë në ndërmarrje (Eli Lilly & Co, 2014).

Për vlerësimin e performancës ekzistojnë disa metoda por të cilat edhe këto metoda i kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre dhe të cilat janë: ese e shkruar, incidentet kritike, shkalla e renditjes grafike, BARS, krahasimi mes individëve, MNO dhe vlerësimi 360°. Maksimizimi i potencialit të individëve dhe të ekipeve për të përfituar për veten dhe ndërmarrjen, duke u fokusuar në arritjen e objektivave të tyre janë qëllimi dhe objektivat e drejtuesve të ndërmarrjes dhe menaxhervë të saj. (West Bromwich, 2012).

KAPITULLIII: MOTIVIMI DHE NDIKIMI NË PERFORMANCËN E NVM-ve

3.1. Motivimi dhe menaxhimi i performancës

Ndërmarrjet krijojnë sisteme të menaxhimit të performancës për të përmbushur tri qëllime të rëndesishme apo bazike të cilat janë: Qëllimet strategjike, administrative dhe ato zhvillimore. Qëllimi strategjik do të thotë menaxhim efektiv i performancës, i cili i ndihmon ndërmarrjen të arrijë objektivat e saj të biznesit në aspektin strategjik afatgjatë.

Qëllimet strategjike e arrijnë këtë duke ndikuar dhe ndihmuar që sjelljet e punonjësve të ndërlidhen me qëllimet e ndërmarrjes. Menaxhimi i performancës fillon me definimin e asaj që ndërmarrja pret nga çdo punonjës. Ai matë performancën e çdo punonjësi për të identifikuar se ku janë këto pritshmëri dhe pse nuk po përmbushen ato. Kjo i mundëson ndërmarrjes të ndërmarrë veprime korrigjuese, të tilla si trajnimi, stimujt ose disiplina. Menaxhimi i performancës mund të arrijë qëllimin e vet strategjik vetëm kur matjet janë të lidhura me qëllimet e ndërmarrjes dhe kur komunikohen me punonjësit qëllimet dhe reagimet në lidhje me performancën. Në njëren nga kompanitë telefonike pa tela “Sprint” punonjësit vlerësohen nga tre deri në pesë terma kriteresh, secila e lidhur me një nga objektivat strategjike të kompanisë për përmirësimin e përvojës së klientit, forcimin e markës dhe rritjen e profitit. Punonjësit në qendrat e thirrjeve të shpejta dhe dyqanet e shitjes me pakicë mund të shkojnë në internet për të shqyrtuar objektivat e tyre individuale dhe për të kontrolluar përparimin e tyre drejt arritjes së tyre (Heckhausen. J, H.H, 2018).

Qëllimi administrativ i një sistemi të menaxhimit të performancës i referohet mënyrave në të cilat ndërmarrjet e përdorin sistemin për të siguruar informacion për vendimet e përditshme në lidhje me pagën, përfitimet dhe programet e njohjes. Menaxhimi i performancës gjithashtu mund të mbështesë vendimmarrjen në lidhje me mbajtjen e punonjësve, ndërprerjen e sjelljes së dobët, punësimin dhe përparimin e tyre pastaj degradimin e tyre dhe në rastin më të keq pushimin nga puna. Për shkak se menaxhimi i performancës mbështet këto vendime administrative, informacioni në një vlerësim të performancës mund të ketë një ndikim të madh në të ardhmen e punonjësve individualë. Menaxherët e njohin mirë këtë çështje, dhe kjo është arsyeja pse ata mund të ndjehen të pakëndshëm në kryerjen e vlerësimeve të performancës kur informacioni i vlerësimit është negativ dhe nga vlerësimi i tyre ka gjasa të çojë në një pushim, apo zhgënjim për rritje të pagave ose marrja e veprimeve të tjera negative nga menaxhimi i ndërmarrjes.

Së fundi, qëllimet zhvillimore, menaxhimi i performancës ka një qëllim zhvillimi, që do të thotë se shërben si bazë për zhvillimin e njohurive dhe aftësive të punonjësve. Duhet veçuar faktin se edhe punonjësit që janë duke përmbushur pritjet mund të bëhen më të vlefshme kur dëgjojnë dhe diskutojnë reagimet e performancës. Reagimi efektiv i performancës i bënë punonjësit më të vetëdijshëm për pikat e forta dhe fushat në të cilat ata qëndrojnë mirë, por po ashtu ata i dëgjojnë dhe shohin edhe pikat e dobëta të tyre dhe të cilat duhet tu kushtojnë rëndësi dhe ti përmirësojnë ato. Për reagimet e performancës për t'i shërbyer një qëllimi zhvillimor, menaxherët duhet të përshtatin qasjen e tyre në nivelin e performancës. Për një punonjës me performancë të lartë, menaxheri duhet të hapë një bisedë rreth ambicjeve të punonjësit dhe mundësive zhvillimore të ndërmarrjes, kështu që

punonjësi sheh një rrugë të këndshme karriere. Punonjësit që janë duke u pakësuar në disa zona do të kërkojnë një përpjekje për të zbuluar burimin e performancës së dobët. Edhe midis punonjësve dhe standardeve të takimit, menaxherët duhet të identifikojnë fushat për rritjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen. Prandaj pikërisht për këtë mund të themi së një punonjës mund të ketë nevojë për kurse të ndryshme dhe trajnim shtesë ndërsa një tjetër ka nevojë për inkurajim apo ndërmarrjen e veprimeve tjera me qëllime më sfiduese (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018). Dhe kjo është një prej sfidave të shumta të ndërmarrjes që menaxherët duhet ta marrin më përkushtim.

3.2. Kriteret për menaxhimin efektiv të performancës së NVM-ve

Menaxhimi i performancës, për të arritur qëllimet e veta, duhet që metodat e saj për matjen e performancës duhet të jenë efikase dhe të mirëmenduara. Përzgjedhja e këtyre masave është një pjesë kritike e planifikimit të një sistemi të menaxhimit të performancës. Disa kriteret që përcaktojnë efektivitetin e masave të performancës janë (Armstrong, 2010):

- **Fitimi me strategji** - Një sistem i menaxhimit të performancës duhet të synojë rritjen e sjelljes dhe qëndrimeve të punonjësve që mbështesin strategjinë, qëllimet dhe kulturën e ndërmarrjes. Nëse një kompani thekson shërbimin ndaj klientit, atëherë sistemi i menaxhimit të performancës duhet të përcaktojë llojet e sjelljeve që kontribuojnë në shërbimin e mirë të klientëve. Vlerësimet e performancës duhet të maten nëse punonjësit angazhohen në ato sjellje të cilat kanë të bëjnë me vlerësim.

Feedback-u duhet të ndihmojë punonjësit të përmirësohen në ato fusha ku ata kanë ngecje. Kur ndryshon strategjia e një ndërmarrje, personeli i burimeve njerëzore duhet të ndihmojë menaxherët të vlerësojnë se si sistemi i menaxhimit të performancës duhet të ndryshojë për t'i shërbyer strategjisë së re.

- Vlefshmëria - vlefshmëria është shkalla në të cilën një mjet matës në të vërtetë matë atë që synohet të matet. Në rastin e vlerësimit të performancës, vlefshmëria i referohet nëse vlerësimi matë të gjitha aspektet relevante të performancës dhe i lë aspekte të parëndësishme të performancës. Prandaj nese caktojmë disa faktorë të cilët duam ti masim dhe ata i ndajmë në dy grupe me rrathë, duke i specifikuar për vlerësim, atëherë themi se rrethi në të majtë përfaqëson të gjithë informacionin në një vlerësim të performancës, kurse rrethi në të djathtë përfaqëson të gjitha masat përkatëse të performancës së punës. Mbivendosja e qarqeve përmban informacionin e vlefshëm. Informacioni që mblidhet, duhet të jetë i rëndësishëm dhe i mbrojtur nga ndërhyrjet. Krahasimi i shitësve në bazë të numrit të thirrjeve që ata bëjnë për konsumatorët në një periudhë të caktuar mund të mos jetë vlerësim real. Marrja e shumë thirrjeve nuk përmirëson domosdoshmërisht shitjet ose kënaqësinë e klientit, përveç nëse çdo shitës bënë vetëm thirrje të planifikuara mirë. Informacioni që nuk mblidhet por është i rëndësishëm paraqet deficiencën e masës së performancës. Për shembull, supozoni që një kompani të matë nëse të punësuarit kanë evidenca të mira të frekuentimit, por jo nëse ata punojnë në mënyrë efikase. Ky vlerësim i kufizuar i performancës nuk ka gjasa të japë një pasqyrë të plotë të kontributit të punonjësve në ndërmarrje/ kompani. Masat e performancës duhet të minimizojnë si kontaminimin ashtu edhe deficiencën.

- Besueshmëria - Në lidhje me një masë të performancës, besueshmëria përshkruan qëndrueshmërinë e rezultateve që do të japë masa e performancës. Besueshmëria është konsistenca e rezultateve kur më shumë se një person matë performancën. Thjesht duke kërkuar një mbikëqyrës për të vlerësuar performancën e një punonjësi në një shkallë prej 1 deri në 5 ku kjo do të kishte të ngjarë të ketë besueshmëri të ulët të vlerësimit. Vlerësimi do të ndryshojë në varësi të asaj se kush po i vlerëson punonjësit. Besueshmëria test i referohet qëndrueshmërisë së rezultateve me kalimin e kohës. Nëse një masë e performancës nuk ka siguri në test, atëherë përcaktimi nëse performanca e një punonjësi ka ndryshuar me të vërtetë me kalimin e kohës do të jetë e pamundur (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018).
- Pranueshmëria - nëse një masë është e vlefshme dhe e besueshme, ajo duhet të përmbushë standardin praktik për të qenë i pranueshëm për punonjësit apo njerëzit që e përdorin atë. Për shembull, njerëzit që përdorin një masë të performancës duhet të besojnë se nuk merr shumë kohë. Gjithashtu, nëse punonjësit mendojnë se masa është e padrejtë, ata nuk do të përdorin reagimet si bazë për përmirësimin e performancës së tyre.
- Përcaktime të veçanta - Një masë e performancës duhet t'i tregojë punonjësit në mënyrë specifike se çfarë pritet prej tyre dhe se si mund t'i përmbushin këto pritshmëri. Sikurse kemi cekur edhe më lartë të qenit i specifikuar ndihmon në menaxhimin e performancës për të përmbushur qëllimet e mbështetjes së strategjisë dhe zhvillimin e punonjësve. Nëse një masë nuk specifikon atë se çfarë duhet të bëjë një punonjës për të ndihmuar ndërmarrjen të arrijë qëllimet e veta, ajo nuk e

mbështet strategjinë. Nëse masa nuk arrin të theksojë problemet e performancës së punonjësve, ata nuk do të dinë se si të përmirësohen (Heckhausen. J, H.H, 2018).

3.3. Menaxhimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Inovacioni konsiderohet të jetë një mjet strategjik i përdorur për të zhvilluar dhe rritur aftësitë e ndërmarrjeve/ kompanive (Farazmand, 2004, 5). Ky është një faktor kyç në zhvillimin ekonomik dhe përparimin e metutjeshëm, gjithashtu përbën një burim shpikjesh në fusha të ndryshme të jetës, shoqërisë, teknologjisë dhe administratës (Farazmand, 2004, 8). Inovacioni përshkruhet si risi në lidhje me idetë, qasjet, metodat, proceset, strukturat, sjelljet, qëndrimet, kulturat, teknologjitë dhe aftësitë. Ai lidhet gjithashtu me njohuritë e përdorura në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, në menaxhimin dhe administrimin e shoqërive, si dhe në menaxhimin e llojeve të ndryshme të ndërmarrjeve (Farazmand, 2004, 8).

Damanpour (1991) përkufizon inovacionin si një produkt, shërbim, proces ose pjesë të pajisjeve që është e re për ndërmarrjen dhe që e miraton ose e zbaton atë. Nga perspektiva organizative, Amabile et al. (1996, 1154-1155) e përshkruajnë risinë si një ide krijuese të aplikuar me sukses në një ndërmarrje/ kompani. Nga kjo pikëpamje, kreativiteti individual dhe grupor është një pikë nisjeje për inovacionin. Megjithatë kreativiteti është thelbësor, ai mbetet i pamjaftueshëm. Luecke dhe Katz (2003), ofrojnë një përkufizim të përgjithshëm të inovacionit si futjen e diçkaje të re. Inovacioni është integrimi ose sinteza

e njohurive për të formuar një produkt, proces ose shërbim të ri, të dobishëm dhe të vlefshëm.

Sipas hulumtuesve të tjerë (Amabile, 1997), (Harper dhe Becker, 2004), për inovacionin që të jetë efektiv, ai duhet së pari të sjellë ndryshime të rëndësishme. Megjithatë, ndryshimi nuk duhet domosdoshmërisht të jetë një hyrje e diçkaje krejtësisht e re por ndonjëherë mund të marrë formën e përmirësimeve domethënëse (të një produkti, procesi ose shërbimi) në krahasim me arritjet e mëparshme. Disa studime pohojnë se risia është më e zakonshme në mesin e ndërmarrjeve të mëdha, ndërsa studime të tjera sugjerojnë se ajo është më e përhapur në mesin e atyre më të vegjël (Harmancioglu et al., 2010). Nga njëra anë, inovacioni mund të përdoret nga NVM-të si një strategji kryesore për të fituar një avantazh konkurrues mbi ndërmarrjet dhe kompanitë e mëdha, sepse ato janë më fleksibile dhe të afta për t'iu përshtatur ndryshimeve në treg (Knight dhe Cavusgil, 2004). Nga ana tjetër, risitë mund të jenë më të zakonshme në ndërmarrjet e mëdha sepse ato kanë qasje më të madhe në burimet e kërkuara (Harmancioglu et al., 2010).

Studimet tregojnë se, krahasuar me kompanitë më të mëdha, NVM-të kanë tendencë të përdorin masa të ndryshme për të arritur avantazhin e inovacionit (Cao et al, 2009, In dhe Jahnsen, 2005). Pengesat më të zakonshme për inovacionin në kompani janë mungesa e fondeve për inovacionin, rreziqet penguese të përfshira në projektet e inovacionit dhe kostot penguese të teknologjisë. Të dy llojet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha përballen me këto probleme. Disponueshmëria e burimeve njerëzore është një pengesë e përbashkët për inovacionin (sepse zakonisht nuk ka staf të mjaftueshëm të kualifikuar ose kohë të lirë për të ndërmarrë aktivitete inovative) (Kaufmann dhe Tödtling, 2002).

Megjithatë, krahasuar me kompanitë më të mëdha, ndërmarrjet më të vogla kanë më pak qasje ndaj burimeve të tilla si kapitali financiar apo njerëzor (Forbes dhe Milliken, 1999).

Studiuesit vërejnë se kapitali njerëzor është një nga burimet që menaxherët e lartë punësojnë për të shfrytëzuar aftësitë esenciale për eksplorimin e mundësive të reja (Wiklund dhe Shepherd, 2003). Rrjedhimisht, dobësia e sipërpërmendur kufizon qasjen e këtyre kompanive në informacionin rreth tregut (p.sh, kërkimet shkencore profesionale apo të dhënat industriale që kërkojnë blerje) dhe aftësitë e tyre për të zhvilluar produkte të reja (Burke dhe Jarrat. 2004), (Kaufmann dhe Tödtling. 2002). Për më tepër, një rrjet i ngushtë i njohur i njohurive praktikisht nuk ekziston brenda ndërmarrjeve të vogla (Peng dhe Lou, 2000). Kështu që duket se risitë janë veçanërisht të rëndësishme për firmat e vogla sipërmarrëse që kanë burime të kufizuara financiare (Van de Vrande et al., 2009; Rhee et al., 2010).

3.4. Vlerësimi i performancës

Ndërmarrjet kanë zhvilluar një larmi metodash për matjen e performancës. Disa nga metodat e përdorura bëjnë krahasimin e punonjësve për të krahasuar më pas performancën e tyre. Metoda të tjera e përcjellin vlerësimin në vlerësimet e attributeve individuale pastaj sjelljeve dhe rezultateve. Shumë ndërmarrje përdorin një sistem matësish apo një mori normash që përfshin një sërë masash paraprake në aplikim të menaxhimit të cilësisë së përgjithshme që përfshin menaxhimin e performancës (Weisbrod et al, 1998). Figura e

mëposhtme paraqet procesin e vlerësimit të personelit bazuar në sjelljet e punonjësve për të arritur tek rezultatet

Figura 14. Procesi i vlerësimit të personelit



Burimi: (Koli & Llaci, 2005) modifikuar nga autori

Fjala performancë përshkruan diçka kualitative dhe me vlerë dhe në vete ka katër dimensione: efektivitet, barazi, humanitet dhe efikasitet. Në praktikë përcaktohen caqet kyçe që të arrihet një vlerësim i suksesshëm. Mirpo së pari duhet të bëhet një marrëveshje dhe takim informues në mes të punonjësve dhe menaxherëve ashtu që punonjësi ti kuptoj qartë qëllimet, dhe të jetë në gjendje t'i arrijë caqet e përcaktuara. Kriteret pra duhet të jenë të arritshme gjithashtu edhe lehtësisht të matshme, po ashtu kriteret duhet të parashikohen

dhe përcaktohen me shumë kujdes si dhe të inkurajohen punonjësit që ti tejkaloj sfidat dhe ti arrijnë ato kritere (Weisbrod et al, 1998).

Vlerësimi i performancës së personelit mund të shërbej për shumë qëllime dhe nga ato të përfitojnë si ndërmarrjet po ashtu edhe punonjësit, performanca e të cilëve është vlerësuar (Sherman, Bohlaner, 1997). Ka disa qëllime për të cilat vendoset apo kërkohet vlerësimi i performancës. Ato qëllime mund të përmbledhen në disa pika (Weisbrod et al, 1998):

- i. Që të identifikoi nivelin e performancës individuale të punonjësve.
- ii. Të pajisë menaxherët me njohuri apo mjet/ program, për identifikimin e anëve të forta dhe të dobëta të performancës së punonjësve.
- iii. Që të sigurohet një format që i jep mundësi menaxherëve të rekomandojnë një program specifik të projektuar për të ndihmuar punonjësit për përmirësimin e performancës.
- iv. Që të ofrojë mundësi të shpërblehen punonjësit për performancën dhe kontributin e dhënë për qëllimet e ndërmarrjes, si dhe
- v. Të mbledhin informata në lidhje me planifikimin dhe strategjinë e mëtutjeshme të ndërmarrjes (Sherman & Bohlaner, 1997).

Qëllimet e vlerësimit synojnë që së pari të shohim realizimin e punës së punonjësve dhe sukseset që kanë arritur gjatë punës së kryer në krahasim me standardet e performancës brenda një periudhë të caktuar kohore. Metodat e reja të vlerësimit të performancës vënë në plan theksin në trajnimin, zhvillimin dhe ngritjen e punonjësve. Me qëllim të eliminimit të

gabimeve në vlerësim të performancës rrjedhimisht performancës së dobët e cila dukuri ndikon në MBNJ si dhe në gjithë ndërmarrjen paraqitet nevoja për krijimin e standardeve të reja të ndërmarrjeve dhe këto standarde duhet tu komunikohen punonjësve. Menaxhimi duhet të harxhojë një sasi të duhur të kohës së tij duke analizuar nevojat e vlerësimit të performancës dhe për të zhvilluar një sistem efektiv dhe funksional në arritjen e këtyre nevojave. Një sistem i mirë i vlerësimit të performancës mund të ndihmojë që ndërmarrja të tërheqë individ dhe punonjës të ri me nivel të lartë përgatitje dhe kualifikimi, si dhe të mbajë punonjësit e vetë duke ofruar perspektivë dhe karrierë për ta në të ardhmen. Menaxherët duhet të kuptojnë arsyet e implementimit të sistemit të vlerësimit të performancës i cili ka për synim dhe qëllim që punonjësit ti shtyjë drejtë një konkurrimi mes vete për të dhënë rezultate dhe performancë sa më të mirë nga vetja e tyre. Kjo do të ndikojë në realizimin e objektivave të ndërmarrjes për zhvillimin dhe ngritjen e performancës së punonjësve në veçanti e më pas kjo do të reflektonte edhe në performancën e saj në përgjithësi.

Elementet e një sistemi të vlerësimit të performancës janë (Weisbrod et al, 1998):

- 1) Mjedisi komunikues dhe i drejtë.
- 2) Respekti ndaj punonjësit.
- 3) Fokusimi ndaj të ardhmës.
- 4) Pjesëmarrja e punonjësve.
- 5) Feedback - u i vazhdueshëm.
- 6) Dokumentimi i performancës.

Pikërisht për këtë procesi i vlerësimit të performancës duhet të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që ai të japë rezultat për qellimin që ka. Po ashtu menaxherët duhet të kenë nën mbikqyrje të drejtëpërdrejtë punonjësit dhe të komunikojnë me ta për punën, vështirësitë dhe problemet e tyre si dhe për arritjen e objektivave të caktuara, në mënyrë që sistemi i vlerësimit të performancës të sjellë rezultate të favorshme dhe të pranueshme për ndërmarrjen. Është krejtësisht e natyrshme se për të bërë vlerësimin e një performancë, së pari duhet të dihet se çka dhe cilat kritere apo elemente do të vlerësohen.

Për këtë arsye përdoren disa kritere që na sigurojnë vlerësimin më të plotë. Në të shumtën e rasteve për të bërë një vlerësim ideal të performancës vlerësimi duhet të përmbajë: objektivat e vlerësimit, kriteret apo normat e përcaktuara të vlerësimit si dhe metodat dhe formularët të cilët do të përdoren për vlerësim. Ndërsa sa i përket kritereve të vlerësimit ato mund të jenë të shumta dhe të ndryshme dhe nuk kufizohen në disa, por nga më të shumtit që merrën për vlerësim janë: kriteri i cilësisë, sasisë, inovacionit, kreativitetit, iniciativës, njohurive dhe shkathtësive personale si dhe i komunikimit (Weisbrod et al, 1998). Tabela e mëposhtme paraqet përgjegjësitë e sistemit të vlerësimit të performancës.

Tabela 5. Përgjegjësit e sistemit të vlerësimit

Përgjegjësit e një sistemi të vlerësimit të performancës	
Kompania - (Ndërmarrja)	Krijon planin strategjik Siguron mbështetje dhe burime
Menaxheri	Vlerëson dhe dokumenton performancën Siguron një feedback të vazhdueshëm Siguron mbështetje dhe burime
Menaxheri dhe punonjësit së bashku	Identifikojnë qëllimet e punës Krijojnë plan për zbatimin e kërkesave dhe qëllimeve Diskutojnë për performancë e arritur
Punonjësit	Dëgjon dhe vepron ndaj feedbackut të menaxherit Siguron feedback për menaxherin dhe për ambientin e punës


Burimi: (Koli & Llaci, 2005)

Siç tregohet edhe në tabelën e paraqitur secili subjekt ka obligimet dhe detyrat e veta të përcaktuara në mënyrë që procesi i VP-së të ketë sukses. Pra ndërmarrja krijon planin strategjik dhe siguron mbështetje dhe burime, menaxheri vlerëson dhe dokumenton performancën, siguron një feedback të vazhdueshëm si dhe siguron mbështetje dhe burime. Menaxheri dhe punonjësit së bashku identifikojnë qëllimet e punës, krijojnë plane për zbatimin e kërkesave dhe qëllimeve si dhe diskutojnë për performancën e arritur. Dhe së fundmi punonjësit dëgjojnë dhe veprojnë ndaj feedback-ut të menaxherit si dhe sigurojnë feedback për menaxherin dhe për ambientin e punës (Weisbrod et al, 1998).

Siç është cekur edhe më parë është thelbësore dhe e domosdoshme të qartësohen dhe saktësohen mënyrat dhe metodat e vlerësimit të performancës dhe nga vlerësimi të

shikohet nëse performanca e punonjësit në kryerjen e detyrave ka rezultuar me një nivel më të lartë performance. Nga rezultatet e vlerësimeve të nxjerra për performancën e arritur, krijohen mundësi që ato rezultate të performancës, të përdoren për aftësimin dhe mundësinë e ngritjes së mëtejshme të punonjësve duke i promovuar ata, apo duke i caktuar në ndonjë punë të një niveli dhe rëndësie më të lartë (Kalluci, 2008). Në figurën në vijim do ta paraqesim edhe modelin e procesit të vlerësimit të performancës.

Figura 15. Modeli i procesit të vlerësimit të përfomancës



Burimi: Amy DelpoThe Performance Appraisal Handbook, 2007, modifikuar nga autori

3.5. Dija si aset vital në performancë dhe menaxhim

Aftësia për të menaxhuar dijen (diturinë) po bëhet gjithnjë më e rëndësishme në ekonominë e sotme. Krijimi dhe përhapja e dijes çdo herë e më shumë po bëhet faktorë më i rëndësishëm në konkurrencë e ndërmarrjeve/ kompanive të mëdha (Dalkir, 2005). Dija është bërë një pronë e çmuar, dhe menaxhimi i dijes është praktikuar gjerësisht nga shumë biznese, si mënyra më premtuese për të arritur sukses në epokën e informacionit dhe zhvillimit të teknologjisë informative (IT-së). Aplikimi i menaxhimit të dijes përveç të tjerash u jep bizneseve një avantazh konkurrues në treg. Dituria konsiderohet si aset më i rëndësishëm dhe paraqet faktorin kritik për një ndërmarrje. Në një konkurrencë ndërkombëtare, ku kjo konkurrencë është e përhapur në mënyrë globale, roli i diturisë si aset strategjik po bëhet gjithnjë e më i theksuar dhe i pazëvendësueshëm. Globalizimi dhe dinamika e rrethinës së biznesit, krijojnë mundësinë e një konkurrencë të ashpër, dhe për këtë ndërmarrjet domosdoshmërisht duhet ta kapitalizojnë diversitetin e tyre edhe përtej kufijve nëse dëshirojnë ta rrisin përfitimin dhe kapacitetin e tyre (J. Ardiant, Tanner, 2008).

Për dallim nga kapitali dhe mjetet, dituria e koncentruar në fuqi punëtore shërben jo vetëm për ndërmarrjen por edhe për të mirën e shoqërisë në përgjithësi në nivele më të gjera pikërisht nga të mirat që i prodhon dhe i ofron dituria kësaj shoqërie (Kalluci, 2008). Në atë moment kur është zbuluar diçka e re, është zbuluar një dituri e re. Shfrytëzimi dhe shpërndarja e saj pasi të jetë bërë publike është shumë e lehtë dhe nuk e ka koston që e ka pasur deri sa është arritur dituria, dituria ka një kosto shumë më të ulët se investimi që është bërë, deri sa është përvetësuar ajo dituri. Përparësia e qëndrueshme konkurruese që

kandërmarrja vjen nga dija kolektive që ka ajo, pastaj mënyra se si shfrytëzohet kjo dije në mënyrë efektive, si dhe a është e gatshme për ta përdorur këtë dije. Dijs kolektive përfshin: punën në ekiye bashkëpunuese, përvetësimin dhe ndarjen e njohurive të reja, zhvillimin dhe ndarjen e praktikave më të mira, sigurimin e përgjigjeve ndaj inovacioneve përmes qarkullimit të dijes në ndërmarrje, pastaj menaxhimin e mësimin në ndërmarrje, krijimin e një ambienti i cili është i përshtatshëm dhe i hapur ndaj ideve, ndarjes së njohurive, rrezikut të dështimit si dhe mirënjohjes për sukses. Menaxhimi i dijes shpeshherë përmban në vete identifikimin apo hartën rrugore intelektuale si mjet menaxhimi dhe gjenerimi i njohurive të reja. Këto duhet të jenë të orientuara në shërbim të rritjes së aftësive konkurruese, të rritjes së bashkëpunimit si dhe qasjes në informata, shkëmbimin e praktikave dhe teknologjive më të mira (Kalluci, 2008).

Menaxhimi i njohurive është një disiplinë që promovon një qasje të integruar për identifikimin, menaxhimin dhe ndarjen e të gjitha informacioneve të aseteve të ndërmarrjes, përfshirë këtu bazën e të dhënave, dokumentet, politikat, procedurat, ekspertizën si dhe përvojën individuale të punëtorëve (Duhon, 1998). Menaxhimi i dijes është një burim i pashtershëm që ndikon në rritjen e performancës në një ndërmarrje apo institucion. Nga perspektiva e biznesit, menaxhimi i dijes është strategji e matur e optimizmit të biznesit që përzgjedh, zbulon, ruan me kujdes, organizon, mbledh dhe komunikon informata që janë esenciale për biznesin e ndërmarrjes në mënyrë që të përmirësojë performancën e punëtorëve dhe të rrisë shanset e veta konkurruese në treg (Bergeron, 2003). Menaxhimi i njohurive i referohet të gjitha aktiviteteve sistematike për krijimin dhe ndarjen e njohurive ashtu që ajo dije të përdoret për suksesin e ndërmarrjes (Amstrong, 2006).

Shumica e drejtuesve shpesh deklarojnë se asetë i tyre më i madh është njohuria e mbajtur nga punëtorët e tyre. Ata gjithashtu shtuan se nuk kanë asnjë ide se si ta menaxhojnë këtë dije. Është thelbësore për ta identifikuar atë njohuri që është e vlefshme dhe që është gjithashtu në rrezik së do të humbë nga ndërmarrja përmes daljes në pension, qarkullimit dhe përvetësimit nga konkurrenca e cila dinë të jetë shumë e ashpër në këtë drejtim. Përveç kësaj, qasja e vlerës së bazuar në menaxhimin e njohurive duhet të jetë e orientuar në tri nivele organizative dhe atë në: nivelin individuale, në nivel grupor, dhe në nivel të vetë ndërmarrjes. Në ekonominë bashkëkohore dhe në rivalët konkurrues asetë kryesor është dija. Prandaj duhet adoptuar praktikët e menaxhimit të dijes për të forcuar përparimet tona konkurruese. Menaxhimi i dijes përfshin njerëzit, teknologjinë dhe proceset të ndërlidhura mes vete. Në ekonominë moderne, njohuria që është në gjendje për tu shfrytëzuar është avantazhi konkurrues i ndërmarrjes. Ky avantazh konkurrues realizohet nëpërmjet shfrytëzimit të plotë të informacionit dhe të dhënave të shoqëruara me shfrytëzimin e kombinuar të aftësive të njerëzve dhe ideve, si dhe me angazhimin dhe motivimin e tyre. Si njohuri e tillë është një pasuri thelbësore që është bërë më e rëndësishme se toka, puna apo kapitali në ekonominë e sotme (Kalluci, 2008).

Po ashtu edhe autori Koeing shprehet se burimi themelor dhe i pazëvendësueshëm është dhe do të jetë dija (Koenig, 2012). Në përgjithësi ekzistojnë dy lloje të diturisë: njohuria e nënkuptuar e quajtur (tacite) dhe njohuria e qartë e quajtur (eksplicite). Njohuria e nënkuptuar është ajo që ruhet në trurin e një personi, kurse njohuria e qartë është e përfshirë në dokumente dhe forma të tjera të ruajtjes apo magazinimit. Prandaj njohuria e qartë mund të ruhet në objekte, shërbime apo sisteme. Të dy llojet e njohurisë mund të

prodhohen si rezultat i bashkëveprimit apo risive. Ato depërtojnë në funksionimin e përditshëm të ndërmarrjes dhe kontribuojnë në arritjen e objektivave të tyre.

Njohuria e nënkuptuar është njohuri personale. Ajo është e akumuluar nëpërmjet studimit dhe përvojës. Njohuria e nënkuptuar është zhvilluar përmes procesit të ndërveprimit me njerëzit e tjerë dhe punës praktike. Ajo rritet përmes praktikës së gjykitimit dhe përvojës së suksesit dhe dështimit. Është e vështirë për tu formalizuar, regjistruar apo artikulluar pasi që përfshin mendim subjektiv, intuitë dhe hamendje. Pasi që kjo njohuri është shumë e individualizuar shkalla dhe aftësia me të cilën ajo mund të ndahet varet nga aftësia dhe gatishmëria e personit që posedon atë, për t'ua përcjellë të tjerëve (Kalluci, 2008). Shpërndarja e njohurive të nënkuptuara është një sfidë e madhe për shumë ndërmarrje. Kjo njohuri mund të shpërndahet dhe të komunikohet përmes aktiviteteve dhe mekanizmave të ndryshëm, aktivitetet përfshijnë biseda, seminare, trajnime në vendin e punës. Mekanizma të tjera përfshijnë edhe përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit të tilla si e-mali rrjetet sociale etj.

Në çdo ndërmarrje, njohuria e nënkuptuar është parakusht thelbësor për të marrë vendime të mira. Menaxherët dhe punonjësit duhet të mësojnë dhe përvetësojnë njohuri të përshtatshme përmes përvojës dhe veprimit. Ata kanë nevojë për të gjeneruar njohuri të reja përmes ndërveprimeve personale dhe grupe brenda ndërmarrjes. Ajo është e ruajtur në dokumente, bazën e të dhënave, faqet e internetit, e-maile etj. Kjo njohuri përfshin çdo gjë që mund të kodifikohet, dokumentohet, memorizohet apo ruhet. Këto përfshijnë pasuritë e njohurive të tilla si raporte, memorandume, plane të biznesit, programe, listat e klientëve,

dhe bazat e të dhënave etj. Në shumë ndërmarrje këto njohuri ruhen me ndihmën e kompjuterëve dhe teknologjisë së informacionit (Bergeron, 2003).

Llogaritet se dija e heshtur (tacite) përbën 70 deri në 80% të dijës së përgjithshme në ndërmarrje por është më e vështirë të identifikohet, kualifikohet dhe të konvertohet në vlerë reale. Globalizimi dhe ndryshimet të cilat janë rezultat i dijes tani po e lënë prapa epokën e industrisë dhe po e vënë në plan të parë epokën e ekonomisë së dijes. Nëpërmjet ekonomisë së dijes kontribuohet në biznes, shkencë, inovacione dhe zhvillimet e mirëqenies individuale dhe të përgjithshme (Havolli, 2014). Dituria ka krijuar mundësi të reja jo vetëm brenda ekonomive nacionale, por edhe më gjerë, duke e globalizuar biznesin, shkencën, informatat dhe zhvillimet në fushën e inovacioneve, arritjeve dhe teknologjisë.

Në epokën e dijes mbretëron organizimi i dijes, i cili procedon një masë të madhe të informatave, të ndara nga rrjedhat e produkteve dhe burimeve të prekshme (Bryant, 1998). Ndërmarrjet e diturisë janë ndërmarrjet të cilat në bilancin e gjendjes kanë mjete në sasi të vogla, në raport me vlerën e shtuar të cilën e realizojnë dhe të cilat i zbatojnë plotësisht në strategji të ndryshme. Ato nuk garojnë në minimizimin e shpenzimeve gjatë transaksioneve, por në formësimin dhe riformulimin e mjeteve me qëllim të krijimit të kombinimeve të veçanta, të domosdoshme për plotësimin e kërkesave të ndryshme të konsumatorëve.

Menaxhimi efikas i diturisë dhe përdorimi i saj në ndërmarrje është i varur nga niveli i disponimit me dituri (Kalluci, 2008). Praktika ka treguar se një pjesë e diturive shpeshherë janë të paarritshme, jo komplete ose të shpërndara në segmente të ndryshme të ndërmarrjes. Është i nevojshëm angazhimi i organizuar në kuptim të menaxhimit të dijes në

tërësi. Qëllimi i MD-s është që dituria e koncentruar në individ të bartet tek kolektivi, në atë mënyrë që dituritë individuale të bëhen të disponueshme edhe për të tjerët. Ndërrimi i strategjisë afariste gjithnjë parashtron kërkesa të reja për diturinë. Këto kërkesa kryesisht kanë të bëjnë me hartimin dhe aplikimin e programeve të ndryshme të edukimit varësisht nga veprimtaria e ndërmarrjes. Prandaj, ndërmarrjet mes njëra-tjetrës dallohen për atë se çfarë kapitali intelektual kanë, dhe çfarë diturie shtesë u nevojitet, si dhe çfarë janë synimet për të ardhmen dhe çfarë janë metodat për fitimin e atyre diturive (Kalluci, 2008).

Menaxhimi i dijes nuk është një kuptim i cili definohet vetëm nga procesi i mësimi, por shfrytëzimi strategjik i diturisë me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe sigurimit të pozicionit të lakmueshëm të ndërmarrjes. Efekti afatgjatë është që secili njeri në ndërmarrje në vazhdimësi duhet të mësojë, të fitojë njohuri të reja dhe të ndjejë rezultatet e kësaj diturie si individ dhe kolektiv, duke pasur ndjenjën se është i vlefshëm për ndërmarrjen me njohuritë të cilat i ka.

Ndërmarrjet që mësojnë në shtetet në tranzicion po ashtu edhe në Kosovë, duhet t'u përshtaten ndryshimeve në rrethinë. Për ta bërë këtë është e nevojshme që të investohet në mënyrë intensive në dije (mësim) dhe në zhvillimin e individëve, përkatësisht të investohet në dituri, e cila sot është burimi kyç i përparësisë konkurruese dhe e cila krijon përparësi në krijimin e vlerave të reja (Kalluci, 2008). Për këtë ndërmarrjet në Kosovë duhet të njihen mirë me konceptin e ndërmarrjeve që mësojnë, për shkak se ky koncept për to është shumë i nevojshëm dhe strategjik. Prandaj pikërisht për këtë, për ndërmarrjet dhe ekonominë e një shteti të ri siç është Kosova, është shumë i rëndësishëm sistemi i edukimit dhe i zhvillimit të dijes si vlerë thelbësore dhe e pazëvendësueshme. Pra, siç dihet, vlerën e ndërmarrjes

nuk e përbën vetëm kapitali fizik dhe financiar, por më i rëndësishëm është kapitali intelektual, përkatësisht dituria e të punësuarve. Shumica e NVM - ve në Kosovë e shohin menaxhimin e dijes si diçka që mund të jetë e dobishme për ndërmarrjet e tyre dhe si pjesë strategjike e biznesit të tyre. Nga përgjigjet e marra nga kompanitë pjesëmarrëse në këtë pyetësor dhe hulumtim të këtij disertacioni në mund të kuptojmë dhe kemi kuptuar më mirë pozicionin e menaxhimit të dijes, performancën dhe motivimin e punonjesve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë. Statusi aktual i menaxhimit të dijes në shumicën e NVM - ve është në fazat e rritjes, në një pakicë të tyre është në fazat e fillimit dhe nuk kishte nga ato ndërmarrje që nuk kishin filluar sadopak ta njihnin apo ta përdornin dijen si aset vital në bizneset e tyre. Problemet kryesore të NVM-ve lidhur me ruajtjen e njohurive janë, shpërndarja e dobët e dijes në ndërmarrje si dhe humbja e njohurive për shkak të punëtorëve kyç që largohen nga ato ndërmarrje (Kalluci, 2008).

3.6. Përmirësimi i performancës

Përmirësimi në nivel organizativ - është joshëse për menaxherët të thonë se performanca e dobët është gjithmonë faji i dikujt tjetër, dhe asnjëherë nuk është i tyre. Proceset efektive të menaxhimit të performancës mund të sigurojnë një mjet të vlefshëm për të komunikuar këto pritje (Armstrong, 1998).

Përmirësimi në nivel menaxherial - Menaxherët, ndonjëherë përdorin një shumëllojshmëri të mekanizmave psikologjike siç përshkruhet më poshtë për të shmangur

të vërtetën e pakëndëshme në boshllëqet e performancës. Menaxherët mund të kërkojnë performancë më të mirë duke bindur veten se ata kanë bërë të gjitha ato që është dashur të bëjnë e që nga ato kanë mundur të arrihen pritjet e dëshiruara. Ata po ashtu kanë mundësinë e marrjes së rendimenteve më të mëdha nga burimet në dispozicion nëse pritjet janë arrirë. Njeherësh ata janë shumë të gatshëm për të besuar në stafin e tyre, kur ata pretendojnë se ata janë të mbingarkuar tashmë, atëherë ata mund të marrin si veprim të keq që të punojnë vetë në kohë shtesë.

Sulmet drejt objektivit - Menaxherët mund të vendosin qëllime të vështira dhe të këmbëngulin se ato duhen arrirë, por ende nuk arrijnë të prodhojnë një ndjenjë të përgjegjësisë së të punësuarve ose të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për të arritur qëllimet.

Prandaj për këtë ata duhet të zgjidhin qëllimin;

- a) Filloni urgjent me zgjidhjen e një problemi;
- b) Shpenzimet në një departament janë shumë të larta, rishikoni;
- c) Një buxhet serioz;
- d) Një specifikim i cilësive të humbura;
- e) Mungesë e një objekti.
- f) Gjenerojeni një ndjenjë se arritja e qëllimit është e domosdoshme, dhe jo vetëm e dëshirueshme.

Menaxherët duke zgjidhur qëllimet dhe qartësuar objektivat e ndërmarrjes do të kenë më të lehtë që punonjësve tu sqarojnë për problemet ekzistuese brenda ndërmarrjes,

por edhe mënyrën e tejkalimit të tyre me qëllim të arritjes së qëllimeve të përbashkëta. Por duhet kuptuar se ky proces nuk është aq i lehtë sa duket pasi që ai kërkon një impenjim të madhë jo vetëm të menaxherëve dhe drejtuesve por edhe të punonjësve gjithashtu.

3.7. Menaxhimi i performancës në nivelin organizativ

Menaxhimi i performancës në nivelin organizativ përfshin në vete disa elemente pa të cilat nuk mundë të zhvillohet dhe realizohet në dimesionet e kërkuara. Elementet të cilat i japin mbështetje dhe drejtim menaxhimit të performancës në nivelin organizativ janë:

- a) Deklarata e misionit
- b) Deklarata e vlerave
- c) Proceset e menaxhimit
- d) Stratëgjitë
- e) Objektivat
- f) Zhvillimi i produktit dhe tregu
- g) Zhvillimi operacional
- h) Masat organizative të performancës dhe
- i) Fletë notimi

Deklaratat e misionit - Fillimi i procesit të menaxhimit të performancës është formulimi i një deklarate të misionit. Ky është një përkufizim i shkurtër i qëllimit të përgjithshëm të ndërmarrjes, duke përcaktuar qartë se çfarë duhet bërë për të arritur qëllimin e saj. Deklaratat e misionit duhet të përqendrohen në qëllimin, se çfarë saktësisht

ndërmarrja duhet të bëjë (Pingaud et al, 2007). Prandaj pikërisht për këtë saktësohen edhe qëllimet e ndërmarrjes dhe të cilat mund të përmbliken si më poshtë:

- 1) Të përcjellë vizionin e menaxhimit të lartë dhe rrethit të ndërmarrjes.
- 2) Të sigurojë një bazë mbi të cilën faktorët kritik të suksesit mund të përcaktohen dhe planet strategjike mund të ndërtohen.
- 3) Të çojë në zhvillimin e deklaratave të qarta që përcaktojnë vlerat thelbësore të ndërmarrjes.
- 4) Të veprojë si leva për ndryshim, të cilat tregojnë pikat fillestare të programeve për zhvillimin, inovacion dhe përmirësimi të performancës (Armstrong, 1998).

Ajo që megjithatë, vlen të përmendet është se për një ndërmarrjedhe menaxhim të saj më e rëndësishme është që të ketë një ndjenjë të misionit sesa një deklaratë të misionit.

Deklarata e vlerave - Qëllimi i një deklarate të vlerës është që të ndihmojë zhvillimin e një ndërmarrje të vlerës e cila është e shtyrë dhe e përkushtuar që të kryejë biznesin e saj me sukses, duke iu referuar besimeve të përbashkëta për kuptimin e asaj që është më e mira për ndërmarrjen dhe biznesin e saj. Deklaratat dhe vlerat, pastaj qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në strategjitë e zhvillimit të ndërmarrjes janë thelbësore për suksesin e ndërmarrjes. Deklarata me një vlerë themelore janë të domosdoshme për ndërmarrjen siç thotë edhe (Pingaud et al, 2007) dhe të cilat mund të përmbliken në:

➤ Njerëzit tanë janë burim i forcës sonë. Ata ofrojnë risi të zbulimit dhe ata përcaktojnë reputacionin tonë dhe vitalitetin. Përfshirja dhe puna ekipore janë vlerat tona kryesore të njeriut në biznesin tonë.

➤ Produktet tona janë rezultati përfundimtar i përpjekjeve tona dhe ata duhet të jenë më të mirët për t'i shërbyer klientëve tanë. Si shikohen dhe pranohen produktet tona po ashtu edhe ne jemi parë dhe shikohemi nga klientet dhe konkurrentët.

➤ Konsumatorët dhe klientët tanë janë udhërrëfyes për ne dhe për produktet tona, në gjithnjë kemi për ti identifikuar nevojat dhe kërkesat e tyre, për ti plotësuar ato më se miri.

➤ Fitimet janë masë e fundit për ne, por që me këto fitime ne, në mënyrë efikase do ti sigurojmë klientët tanë me produkte dhe shërbime tona të kualitetit të lartë.

Megjithatë, deklarata e vlerës janë të pakuptimta nëse menaxherët dhe drejtuesit nuk e praktikojnë atë që predikojnë, dhe nuk marrin hapa, nëpërmjet zhvillimit të politikave mbështetëse, për tu siguruar që ato të zbatohen në praktikë. Është gjithashtu e nevojshme për tu siguruar që vlerat brenda saj janë kuptuar, pranuar dhe ndjekur gjatë gjithë kohës në ndërmarrje, duke përcaktuar standardet e sjelljes dhe duke këmbëngulur se ata do të respektohen dhe zbatohen në tërësi.

Proceset e menaxhimit - ato mund të japin një kontribut të madh për performancën në nivel individual dhe grupor nëse janë analizuar dhe përcaktuar siç duhet (Armstrong, 1998). Proceset e menaxhimit të performancës janë atje për të mbështetur arritjen e strategjive, duke siguruar që objektivat reale janë vendosur edhe në planet e veprimit dhe janë përgatitur që të zbatohen në praktikë (Chen et al, 2007).

Strategjitë - Strategjitë janë deklaratat e qëllimit. Ato përcaktojnë drejtimin në të cilin ndërmarrja është duke shkuar për të arritur misionin dhe qëllimin e saj. Në nivel të korporatës ato janë mjetet e shprehura për vizionin e menaxhimit të lartë se ku ata duan të jenë në një afat më të gjatë kohor, dhe në përgjithësi se si ata duan të arrijnë atje.

Objektivat - objektivat mund të jenë: objektivat për përfitim financiar, vlerë e shtuar, të ardhurat e shitjes, normat e larta të interesit, kthimi mbi kapitalin e punësuar, vlera ekonomike e shtuar, fitimet për aksion etj. Secila nga objektivat e cekura e ka peshën dhe rëndësinë e vetë për ndërmarrjen dhe për këtë duhet pasur kujdes në zgjedhjen e objektivave.

Zhvillimi i produktit dhe tregu - projektet për produkte apo shërbime të reja ose të përmirësuara si dhe hulumtimi i tregjeve të reja dhe penetrimi në to duhet të jenë në fokus dhe qëllim të ndërmarrjes. Si e para po ashtu edhe e dyta ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin dhe rritjen e ndërmarrjes nese ajo ecën në mënyrën dhe drejtimin e duhur.

Zhvillimi operacional - projektet për zhvillimin e sistemeve të reja dhe proceseve në ndërmarrje do të ndikojnë në përmirësimin e performancës duke zhvilluar dhe ngritur produktivitetin, pastaj duke reduktuar koston si dhe duke rritur aksionete ndërmarrjes. Këto janë disa nga aktivitetet dhe elementet që duhet të zhvillohen dhe ngritën nga projektet për zhvillim dhe ngritje operationale dhe të sistemeve të reja të ndërmarrjes. Po ashtu rritja e ndërmarrjes mund të behet edhe nga blerjet, shkrirjet e ndërmarrjeve të përbashkëta si dhe nga njerëzit me ide dhe strategji për të bërë ndërmarrjen një vend bindës dhe tërheqës për të punuar dhe qëndruar në të (Armstrong, M. 1998, 120).

Masat organizative të performancës - është e nevojshme për të matur arritjet dhe progresin kundrejt objektivave, prandaj ndërmarrjet duhet të vendosni se cilat masa duhet të përdoren për ta bërë këtë (Armstrong, M. 1998, 126). Një gjë duhet ditur së një masë kyçe e cila mund të vihet në pronësi të më shumë se një funksion do të jetë shumë më efektive se

sa një mori masash të ndara nëpër funksione të ndryshme, kjo për faktin se një masë e vetme shmanget problemin e ballafaqimit dhe kundërthënies mes tyre. Masat kryesore janë dhe kanë të bëjë me ndërhyrjen e masave të ndërmarrjes në performancën e saj kryesisht në sferat organizative dhe ekonomike të ndërmarrjes. Njëra nga masat kryesore është performanca financiare e cila si fokus ka shitjet, fitimet, kthimin mbi kapitalin e gjeneruar, vlerën ekonomike të shtuar, të ardhurat për aksion dhe raportin çmim/ të ardhura etj. Më pas kemi masën tjetër të performancës operative, ku këto masa do të jenë të lidhura me faktorë kritik të suksesit, për shembull, në një dyqan me pakicë këto mund të përfshijnë nivelin e shërbimit të konsumatorëve dhe kënaqësinë e tyre, kurse një kompani prodhuese mund të përdorë masat e cilësisë tek xhirot e prodhimit dhe qarkullimit pastaj kontrollin e kualitetit, kontrollin e inventarit dhe kontrollin e produktit. Po ashtu e fundit nga masat kryesore është masa e performancës tek njerëzit, për shembull fitimi nga shitjet ose fitimi ndaj vlerës së shtuar për punëtor, shpenzimet e pagave si një përqindje e rritur e shitjeve, realizimi i prodhimit për punëtor (produktivitetit), normat e mbajtjes dhe kënaqësisë së punonjësve etj, (Chen et al, 2007).

Fletë notimi - fletë notimi i balancuar është zhvilluar fillimisht nga Kaplan dhe Norton dhe i cili përdoret shpesh si bazë për matjen e performancës. Ata janë të mendimit se "ajo që ju keni për të matur është ajo që ju do të merrni", por po ashtu ata theksojnë se asnjë masë e vetme nuk mund të sigurojë një objektiv të qartë të performancës apo nuk mund të përqendrojnë vëmendjen në një fushë specifike të biznesit. Menaxherët e duan një prezantim të balancuar të dy masave financiare dhe operacionale për t'iu përgjigjur katër

pyetjeve themelore, që do të thotë se ata duhet të jenë në kërkim të biznesit nga katër këndvështrime të ndryshme (Armstrong, M. 1998, 126).

Këndveshtrimet apo pikat themelore sipas Armstrong-ut janë:

- 1) Si konsumatorët na shohin? (Perspektivë e konsumatoreve).
- 2) Çfarë duhet të bëjmë ne? (Perspektivë e brendshme).
- 3) A mund të vazhdojmë për tu përmirësuar dhe për të krijuar vlerë?
(Perspektivë inovacioni dhe të mësuarit).
- 4) Si na shikojnë aksionarët ne? (Perspektivë financiare).

Kaplan dhe Norton theksojnë se qasja e fletë notimit të balancuar, në strategji dhe vizion, nuk kontrollohet nga qendra. Menaxherët e lartë mund të dinë se çfarë duhet të jetë rezultati përfundimtar, por ata nuk mund t'ua thonë të punësuarve saktësisht se si ta arrijnë atë rezultat. Kaplan dhe Norton sugjerojnë se ndërtimi i një fletë notim i mundëson një kompanie apo ndërmarrje për të lidhur buxhetet e saj financiare me qëllimet e saj strategjike. Ata theksojnë se fletë notimi i ekuilibruar mund të ndihmojë punonjësit për të lidhur performancën individuale me strategjinë e përgjithshme të ndërmarrjes. Po ashtu ata theksojnë së përdoruesit e tij zakonisht angazhohen në tre aktivitete: komunikim, edukim dhe vendosjen e qëllimeve në lidhje me shpërblimet bazuar në performancë. Ata po ashtu theksojnë se shumë njerëz e mendojnë matjen e rezultateve dhe vlerësimin si një mjet për të kontrolluar sjelljen dhe për të vlerësuar performancën e kaluar (Chen et al, 2007). Është e kuptueshme së përdorimi i kësaj metode ndryshon në mes të ndërmarrjeve në varësi të nevojave dhe kërkesave të tyre e po ashtu edhe në bazë të faktorëve tjerë ndikues siç është

madhesia, numri i të punësuarëve pastaj kapitali etj. Nëse ne marrim si shembull njëren nga bankat sikurse është “Lloyds TSB”, fletë notim i ekuilibruar aty është një përzierje e treguesve financiarë dhe treguesve jofinanciarë, dhe nga këta tregues mund të sigurohet një masë e vetme e performancës që fokusohet në treguesit kyq bazuar në treguesit financiarë. Këta tregues mund të prezantojnë apo paraqesin një reflektim deri diku të vërtetë të performancës individuale nga aspekti organizativ bazuar në rezultatet e realizimeve financiare. Fletë notimi i mundëson ndërmarrjes që të përqendrohet në një numër të vogël të masave kritike që krijojnë vlerë për ndërmarrjen dhe njëkohësisht ndikojnë në një menaxhim më të mirë të performancës në nivel organizativ (Chen et al, 2007).

3.7.1. Menaxhimi i performancës në nivel menaxherial

Kur flasim për menaxhimin e performancës në nivel menaxherial, është e kuptueshme se roli dhe rëndësia kryesore u bie mbi supë menaxhimit të ndërmarrjes. Ata duhet që me tërë qënien dhe aftësitë e tyre të përkushtohen realizimit të detyrave të veta, pastaj duhet të mbështesin punonjësit dhe të motivojnë ata në mënyrë që të realizojnë qellimet dhe objektivat e parashikuara. Megjithatë, fakti që menaxherët përgjithësisht gjykohen jo nga performanca e tyre, por nga rezultati që arrijnë varësit e tyre, ka bërë që shumë studiues të pranojnë që *“arritja e rezultateve nëpërmjet njerëzve të tjerë është ndër përkufizimet më të përhapura të menaxhimit”* (R. Heller, 1972). Në këtë konkluzion arrijnë edhe studiuesi i mirënjohur i menaxhimit, R. Stewart, kur në përpjekjet e tij për të integruar

përkufizimet e ndryshme të menaxhimit thekson se të menaxhosh do të thotë “...të vendosësh se çfarë të bësh dhe pastaj të vesh njerëzit e tjerë në lëvizje për ti bërë...” (R. Heller, 1982). Disa studiues dhe autorë bashkëkohorë, e japin përkufizimin e pranuar gjerësisht të menaxhimit në një formë me të përshtatshme, duke mbetur në të njëjtën kohë brenda thelbit të tij: “Menaxhimi është procesi i arritjes së objektivave organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera në ndërmarrje ” (Certo & Certo, 2006). Po ashtu në librin “Bazat e menaxhimit të autorit (R. DeCenzo), termi menaxhim i referohet procesit të realizimit të punëve në mënyrë efektive dhe eficiente përmes dhe më persona të tjerë” (DeCenzo, 2011). Ky konceptim i sotëm tregon se menaxhimi ka tre karakteristika kryesore:

- a) Është një proces që përfshin në seri aktivitete të vazhdueshme dhe të ndërlidhura,
- b) Përqendrohet në arritjen e objektivave organizative, dhe
- c) Synon arritjen e këtyre objektivave duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve e burimeve të tjera të ndërmarrjes (Llaci, 2010).

Objektivat e ekipit të punës do të mund të bien dakord për çështje të tilla si, kontributin e anëtarëve të ekipit, marrjen e vendimeve duke punuar së bashku, dhe marrjen e veprimit. Është e rëndësishme për ekipet që së bashku të bien dakord për të krijuar planet për arritjen e objektivave të tyre. Planet e punës do të specifikojnë programet e vëna në skenë si të nevojshme siç janë: prioritetet, përgjegjësitë, oraret, buxhetet dhe aranzhimet për monitorimin e performancës pastaj reagimet dhe mbajtja e takimeve të progresit. Ajo

gjithashtu mund të jetë e dobishme për ekipin për të diskutuar faktorët e saj kritik të suksesit së çfarë duhet bërë dhe se si ajo duhet bërë nëse misioni dhe objektivat e saj janë si objektiv për t'u arritur (Armstrong, M. 1998, 126).

Në nivelin individual, përmirësimi në performancën mund të arrihet edhe përmes politikave dhe praktikave të dizajnuara për të rritur të mësuarit nga stërvitje, këshillimet dhe mësimet e vetë-menaxhuara.

Martyn Sloman beson se qëllimi duhet të jetë për të rritur të mësuarit e “pakufizuar”, e cila ndodh kur individët në mënyrë aktive kërkojnë të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të arritur objektivat e ndërmarrjes (Chen et al, 2007).

Menaxherët e linjës së parë luajnë një rol kryesor në këtë drejtim, duke e inkurajuar të mësuarit e pakufizuar dhe duke ju ofruar mbështetjen e tij nëpërmjet këshillave, stërvitje dhe udhëzimeve. Dhe në fund mund të themi se menaxhimi i performancës ofron një platformë të vlefshme për ta bërë këtë.

3.8. Mënyrat për motivimin e stafit punonjës

Sipas Charles P. Garcia (2009) lideri i fortë është ai që jep maksimumin nga vetja e tij dhe i nxit punonjësit të bëjnë më të mirën, më shumë se sa kur shpërblehen me para. Disa nga mënyrat e motivimit të punonjësve në ndërmarrje sipas tij janë:

- a. Dhënia e energjisë ekipit punonjës. Në vend se menaxheri të marrë energjinë nga të tjerët, ai duhet të bëjë përpjekje për çdo ditë të japë energji pozitive dhe të nxisë pasionin e punonjësve në vendin e punës.
- b. Njerëzit janë në rend të parë. Asnjë aset i ndërmarrjes nuk është më e rëndësishme se sa njerëzit që punojnë në të.
- c. Të vepruarit me integritet. Është shumë e rëndësishme që kur flitet për ndërmarrjen, punonjësit apo menaxherët të ndihen krenarë për ndërmarrjen e tyre.
- d. Të jesh i shkëlqyeshëm në komunikim. Udhëheqësit kanë influencë të ndikojnë tek të tjerët dhe kjo nuk mund të arrihet pa komunikim efektiv.
- e. Të jesh dëgjues i kujdesshëm. Është shumë e rëndësishme të keni durimin të dëgjoni me kujdes dhe prapë të merrni vendim që ju mendoni se është më i miri duke i bindur të tjerët se jeni në rregull me vendimin e miratuar (ndëmarrë).
- f. Zgjidhni problemet. Në derën e udhëheqësit duhet të figurojë një mbishkrim “Mos më sillni probleme por sillni zgjidhjen e tyre”.
- g. Udhëhiq nga eksperiencia dhe kompetenca e jo nga titulli apo pozita që ke në ndërmarrje. Udhëhiq punonjësit tuaj, inkurajoi ata dhe bëhu partner me ta, ndërmarrja do ketë të sigurtë arritjen e suksesit.

Nëse doni që ndërmarrja e juaj të mbijetojë në ekonominë e ashpër të tregut, ky është pikërisht lloji i lidershit që motivon punonjësit dhe i nevojitet ndërmarrjes suaj (Charles P. Garcia, 2009, cituar sipas Zwilling M, 2012).

3.9. Fuqizimi i punonjësve dhe suksesi i ndërmarrjes

Fuqizimi i punonjësve është dhënie e një shkalle të caktuar të autonomisë dhe përgjegjësisë punonjësve për marrjen e vendimeve lidhur me detyrat e tyre specifike dhe organizative. Fuqizimi mundëson që vendimet të merren nga nivele të ulëta të një ndërmarrje në të cilën punonjësit kanë një pikëpamje të veçantë të çështjeve dhe problemeve me të cilat përballen ndërmarrja në një nivel të caktuar. (Grimsley, Sh., 2016).

Disa studiues fuqizimin e kanë përcaktuar si një formë e decentralizimit që përfshin bartjen e vendimeve të rëndësishme për vartësit dhe nënkupton rënien e strukturës hierarkike tradicionale (Corsun & Enz, 1999), (Javanmard. H& Havasi. S, 2013).

Sfidat, e tilla si mjedisi i ndryshueshëm, teknologjia e sofistikuar, nevoja për vendimmarrje të shpejtë dhe ndryshimet e shpeshta, kanë krijuar nevojën mes ndërmarrjeve për të ndryshuar praktikën e tyre tradicionale të menaxhimit, udhëheqjes dhe kontrollit. Një gjë është e qartë nëse dëshirojmë të arrijmë rezultate më të mira, duhet që punonjësve t'u ofrohet autonomi më e madhe për të marrë vendime. Kjo padyshim që do të krijonte liri më të madhe për ta në marrjen e vendimeve dhe njëherësh do të krijonte edhe besim të ndërsjellë punonjës - menaxher në realizim të objektivave dhe qëllimeve të ndërmarrjes. Strukturat e tilla demokratike nuk do të jenë efektive nëse punonjësit nuk kanë një ndjenjë të fuqizimit. Konceptit të fuqizimit të punonjësve i është kushtuar vëmendje më e madhe që nga vitet e 80-ta të shekullit XX, për shkak të ndikimit të tij të lartë në efektivitetin organizativ dhe të inovacionit. (Spreitzer. G. M, 1995). Pikërisht për këtë duhet të

vlersojmë edhe nga ajo që u theksua më lartë, se punonjësit duhet ta kenë mundesinë e diskutimeve dhe dhënies së ideve për detyrat dhe veprimtaritë e tyre si dhe mundesinë e marrjes së vendimeve që në funksion ka punën e tyre gjithnjë kur ato vendime sjellin të mira të çfarëdollojshme për vetë punonjësit në veçanti dhe për ndërmarrjen në përgjithësi.

3.10. Pagesa lidhur me performancën

Në vitet e fundit, shumë ndërmarrje kanë lëvizur drejt shpërblimit të punonjësve për performancën si një mjet për të arritur qëllimet e ndërmarrjes (Mullins, 2005). Në thelb ata kanë lidhur kompensimin dhe shpërblimin për performancën. Debati mbi efektivitetin e shpërblimit financiar mbi performancën vazhdon ndërsa studiuesit dhe hulumtuesit përpiqen të krijojnë përshtatshmërinë organizative dhe kulturore për një praktikë të tillë. Ata argumentojnë se edhe pse mund të jetë relativisht e lehtë për të dhënë përgjigje ndaj aspekteve individuale të efektivitetit të PLP-së kur merren në konsideratë të gjitha variablat që lidhen me këtë koncept siç aplikohet në praktikë, megjithatë në aspektin e përgjithshëm lidhja e PLP-së me nivelet e performancës bëhet paksa më e vështirë.

Vlerësimet e performancës janë një aspekt kyç i menaxhimit të çdo pagese për modelin e performancës. Dy autorët Smith dhe William (2003) në hulumtimin e tyre duke eksploruar lidhjen mes vlerësimit të performancës dhe ndikimeve motivuese, vështronin rreziqet në rritje të marrjes së gabuar të meritave ku aplikohen modelet e performancës së pagave, si dhe efektet që kjo mund të ketë në motivimin e punonjësve. Në një anketë të

administruar për 5 kompani të ndryshme, duke filluar nga mbështetja administrative tek mbikëqyrësit dhe menaxherët, ata zbuluan se 58% e të anketuarëve morën një rritje të meritës që nuk korrespondonte me vlerësimin e tyre aktual të performancës. Ai konstatoi se koncepti "de-coupling" jo bashkim, apo thenë me qartë një lidhje jo e mirë midis vlerësimit të performancës dhe shpërblimit ishte një praktikë e zakonshme në mesin e kompanive të anketuara. Kjo nënvizon rëndësinë e çdo modeli të bazuar në merita për të qenë i drejtë dhe transparent në mënyrë që ajo të jetë e suksesshme në afat të gjatë në rritjen e motivimit dhe të performancës së punonjësve. Shumica e të anketuarëve nuk e ndjenin shpërblimin e tyre në rritje duke u bazuar në performancën e tyre por më tepër atë e ndjenin të ndikuar nga rënjet apo ngritjet e buxhetit të ndërmarrjes. Në mënyrë të ngjashme, St-Onge et al. (2009), theksojnë përhapjen e shtrembërimit të vlerësimit të performancës dhe efektet ndikuese të tij në performancë dhe motivim. Edhe pse ky shtrembërim është i pashmangshëm në shumicën e ndërmarrjeve, menaxherët gjithashtu duhet të shikojnë shqyrtimin e vlerësimeve dhe mënyrën se si ne e komunikojmë suksesin ose dështimin dhe si e bëjmë ndarjen e shpërblimieve.

Armstrong pretendon se më mirë është të ndajmë menaxhimin e performancës në mënyrë që të bëjmë një dallim midis potencialit zhvillimor dhe ndikimit të performancës së punonjësve në rritjen e pagave (Armstrong, 2009, fq. 254). Ai e përshkruan vështirësinë në shpërblimin e performancës, ku duhet të matet në nivele të ndryshëm, kështu që bazohet në dëshmi dhe kjo dëshmi duhet të shihet si e drejtë dhe transparente dhe nuk kryhet pas dyerve të mbyllura. Pra ndarja e meritave dhe shpërblimeve duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe jo në mënyrë sekrete apo të fshehtë.

Në një intervistë me Julieet Norton, Michael Armstrong vazhdon të argumentojë se departamentet e BNJ-së për njëfarë kohe nuk i kanë vlerësuar politikat e tyre të shpërblimit për të vërtetuar rëndësinë e tyre (J. Norton 2010, fq, 41-43). Kjo indiferencë ndaj rëndësisë aktuale të sistemeve të tyre të shpërblimit ka qenë në kontrast me vëmendjen dhe financimin që u është dhënë skemave të trajnimit për punonjësit duke konsideruar se sa shpenzohen për paga dhe shpërblime. Prandaj më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet kësaj, sesa programeve të trajnimit, duke marrë parasysh pasojat e tyre në ndikim të varfërimit të sistemeve të ndryshme të shpërblimeve që kanë ndërmarrjet.

Ndërmarrjet duke zgjedhur llojin e duhur të programit të shpërblimeve, do të ndihmojnë që punëtorët të rriten, të maturohen dhe në fund të shtojnë vlerën e ndërmarrjes. Paguani, si një 'variabël bazë', pra pagesa bazë është çelësi për të siguruar që ju të merrni më shumë vlerë nga punonjësit tuaj, kjo është theksuar veçanërisht sipas një raporti mbi anketat e pagave të bëra nga hulumtuesit e këtijë studimi (Zingheim, 2010, fq, 9). Ndërmarrjet që zgjerohen paguajnë më shumë dhe në mënyrë të barabartë inkurajojnë të njëjtin lloj të performancës mesatare në të gjithë ndërmarrjen. Ky raport argumenton se shpërblimi financiar duhet të bazohet në vlerën që shtoni në ndërmarrjen tuaj. Por sa e rëndësishme është pagimi i suksesit të një kompanie për një periudhë më të gjatë kohore? Në studimin e tyre mbi rolin e sistemeve të shpërblimit në ndërmarrjen me performancë të lartë, De Waal dhe Jansen gjetën se shpërblimet kur janë të lidhura me pagën ato mund të jenë sa efektive po aq edhe joefektive për performancën e ndërmarrjeve A. G. (Ton) De Waal& Jansen (2011, fq,9). Përderisa ka prova të mjaftueshme për të sugjeruar lloje të caktuara të rritjes së pagës që lidhet me performancën, megjithatë kjo nuk ishte përfundimi i

studimit. Nga karakteristika e dymbëdhjetë (organizimeve me performancë të lartë) të diskutuara në këtë studim, paga ishte më dominuesja. Megjithatë, ajo arriti në përfundimin se gjatë një periudhe më të gjatë, kjo nuk ka efekt pozitiv ose negativ në performancën organizative. Gilmore dhe Smith (2005) i referohen kësaj ndërmarrje me performancë të lartë si jo-hierarkike të cilat largohen nga kontrolli i menaxhimit qendror në një formë më të bazuar në ekip, duke punuar me përgjegjësitë e përhapura në mënyrë më të barabartë dhe të bazuara në nivele të larta besimi dhe komunikimi. Kjo ngre disa pika interesante se si t'i shpërblejmë këto ekipe, qoftë kolektivisht ose individualisht, dhe se si funksionojnë sistemet e shpërblimit në mjedisin e bazuar në ekip. Kjo do të diskutohet më vonë në këtë kapitull. Për të diskutuar këtë pikë, duhet të theksojmë faktin se motivimi i punonjësve mund të nxitet më shumë nga shpërblimet e brendshme (p.sh. duke bërë punën që e deshiron) sesa me shpërblime të jashtme monetare si (pagë, shpërblime). Në studimin e tyre mbi nismat e punonjësve dhe ndryshimeve, (Stumpf et al. 2013, fq, 10) u përqendrua në dy shpërblime të brendshme - kuptimplotë dhe zgjedhje. Ata argumentojnë se këto janë thelbësore për kënaqësinë e punonjësve dhe mbajtjen e punonjësve në kohë të paqartësisë dhe ndryshimit organizativ. Pra, në këtë rast, shpërblimet e brendshme ishin më efektive sesa shpërblimet monetare. Kjo është në kontekstin e ndryshimeve organizative, prandaj është interesante të vërehet se kënaqësia në punë dhe qëllimi për të qëndruar brenda rolit tuaj gjatë kohës së ndryshimeve organizative mbështeten në përzierjen korrekte të shpërblimeve jofinanciare. Kënaqësia e punës është një faktor i rëndësishëm në punën e një punonjësi dhe shpërblimet e brendshme luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Në mënyrë të ngjashme, në studimin e tyre për efektin e shpërblimeve të parave në performancën e punonjësve në kompaninë Kenia Power and Lighting Company Ltd, Njanja et al. (2013) konstatoi se megjithëse shumica e stafit të anketuar kishin një perceptim se shpërblimet e parave të gatshme motivojnë performancën, studimi arriti në përfundimin se këto shpërblime të parave të gatshme nuk kishin efekt të gjatë në performancën e punonjësve. Ata që kishin marrë një bonus dhe ata që nuk kishin marrë, e perceptonin atë të ndikonte në punën e tyre njëjtë, prandaj ajo nuk kishte një efekt të rëndësishëm në performancën e tyre. Megjithatë, anasjelltas, në studimin e tyre të strukturave të shpërblimit në industrinë e ndërtimit britanik (Drunker and White, 1996, fq.142) tregoi se për shkak të natyrës së projektit të asaj industrie dhe dallimit të qartë në forcën e punës midis manualit dhe fuqisë punëtore të jakës së bardhë, Sistemet PLP-së mund të japin rezultate në mes të menaxherëve profesionistë dhe atyre të lartë në atë industri. Ai sugjeron që ky model i PLP-së mund të zhvillohet në kontekst të përmirësimit të performancës në ekipin e projektit, dhe rreth një sistemi të pagave të kompetencës ose aftësisë.

Në mënyrë të ngjashme, Bart et al. (2008, fq. 9), në studimin e tyre të gjerë për atë se kush paguan për performancën dhe bazuar në sondazhet e themelimit norvegjez nga 1997 në 2003, zbuloi se suksesi apo dështimi i performancës që lidhet me pagesën do të varet shumë nga vendosja se në çfarë forme është futur shpërblimi dhe për këtë ata theksuan se, skemat e shpërblimeve të bazuara në prodhim, kanë më shumë gjasa të respektohen kur ka diskresion të konsiderueshëm të punonjësve mbi detyrat e punës dhe shpërblimet. Pra, ata gjetën që pagesa lidhur me performancën është më e përhapur në ndërmarrjet e mëdha dhe më pak në të zakonshmet apo ato më të vogla si dhe në ato më

pak të organizuara. Ata po ashtu gjetën një lidhje midis kualifikimit arsimor të punonjësve dhe përdorimit të pagave bazuar në performancë me bazë individuale dhe gjithashtu një lidhje të qartë midis performancës, që është prekur pozitivisht nga PLP-ja dhe niveli i autonomisë që ka puna e tyre. Në këtë kuptim sa më shumë liri të veprimit që ka një punëtor për detyra të tij / saj, PLP-ja do të jetë më e suksesshme.

Megjithëse ka shumë dëshmi për të sugjeruar se të dyja llojet e shpërblimeve ndikojnë në performancën organizative, këtu studiuesit sugjerojnë se përqendrimi në shpërblimet e brendshme tregon se vetë roli është i mjaftueshëm për të nxitur brenda për brenda punonjësit, me një ndjenjë të vlefshme të kënaqësisë dhe fuqizimit. Këto shpërblime të brendshme mund të jenë veçanërisht efektive në kohën e ndryshimit brenda një strukture organizative të ndërmarrjes. Megjithatë, shpërndarja e këtyre shpërblimeve në një mënyrë sistematike dhe të drejtë është thelbësore për suksesin e tyre. Sigurisht çështja e nevojave individuale mund të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatin pozitiv të performancës e lidhur kjo me rezultatët dhe e bazuar në PLP-në.

Në studimin e tyre mbi shpërblimet organizative, duke pasur parasysh nevojat e punonjësve në alokim të mjeteve, (Webb Day et al, 2014) diskutojnë se si përdorimi i një modeli paguaj për performancë (pay-for-performance) në një ndërmarrje perëndimore mund të ketë rezultate pozitive në performancën e punonjësve. Duke u fokusuar jo vetëm në pagën, por edhe në nevojat specifike të individit për këtë pagë, ai gjeti se jo vetëm që mund të arrini rezultate pozitive të performancës, por ndihmon ndërmarrjen që t'i përgjigjet më mirë pritjeve të punonjësve. Ai gjithashtu gjeti dhe theksoi se nëpërmjet komunikimit të

nevojës për menaxherin tuaj, punonjësit me nevoja më të larta kanë më shumë gjasa të marrin shpërblime më të mëdha.

Një punonjës i motivuar është më produktiv se sa ai që është i pamotivuar dhe në këtë mënyrë ai bëhet edhe një performues më i lartë në vendin e punës së tij. Motivimi i brendshëm është më i rëndësishëm për produktivitetin dhe performancën kur lidhet me punëtorët kreativë ose inovatorët (Markova dhe Ford, 2011).

Ky studim u përqëndrua tek punonjësit në mbi 30 kompani të mëdha dhe përmes një sistemi të shkallëzuar dhe vlerësuar nga mbikëqyrësit, i cili konstatoi se as shpërblimet monetare dhe as ato jo monetare nuk kishin ndonjë efekt të drejtpërdrejtë në performancën. Megjithatë, ato kishin një efekt në motivimin e tyre dhe sa më të motivuar që ishin të punësuarit, aq më shumë kohë kalonin në punë dhe kjo prandaj ndikonë pozitivisht në performancën e tyre në afatë të gjata kohorë. Pra në fakt, paraja nuk është ilaç dhe nuk çon në një kohë më të gjatë pune ose në përmirësimin e bashkëpunimit dhe sjelljeve midis punonjësve. Shpërblimet e brendshme mund të jenë po aq efektive, si dhe më pak të kushtueshme.

Në mjedisin modern të biznesit, performanca e ekipit po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për suksesin organizativ. Një nga pyetjet e para të pyetura në shumicën e intervistave sot është 'a mund të punoni si pjesë e një ekipi'? Sigurimi i punonjësve që punojnë në mënyrë produktive dhe bashkëpunuese si pjesë e një ekipi mund të jenë të vështira dhe sipas Torrington et al. (2011) nëse aktiviteti i menaxhimit të performancës nuk është përcaktuar saktë, qëllimet individuale të punonjësve mund të dëmtojnë punën e ekipit

dhe anasjelltas. Shpërblimet e bazuara në grup duket se janë komplimente logjike të matjes së performancës që fokusohet në ekipet dhe cilësinë / sasinë e punës që ata prodhojnë.

Dematteo ka zbuluar se aplikimi i shpërblimeve për ekipet në tërësi bazohet në supozimin se shpërblimet e ekipit do të bëjnë diçka cilësisht të ndryshme nga shpërblimet individuale (Dematteo et al., 1998, fq.144).

Gjithashtu nga pikëpamja e vlerësimit të performancës, mund të jetë më e lehtë dhe më pak e ndërlikuar për një menaxher të vlerësojë ecurinë e një ekipi në krahasim me performancën individuale pra të secilit veç e veç. Kështu mund të argumentohet se menaxhimi i performancës dhe përfitimet që janë në dispozicion për arritjen e nivelit të performancës së dëshiruar mund të jenë kompliment dhe të humbasë më pak kohë duke marrë parasysh një pikë monitorimi dhe matjeje në një strukturë të bazuar në ekip. Megjithatë, mund të duhet kohë që një anëtar i ekipit të përshtatet me pjesën tjetër të ekipit e po ashtu edhe më shpërblimin e tyre të përcaktuar nga përpjekjet e grupit edhe kur do të mungojë pjekuria e ndonjërit nga anëtarët e ekipit, ajo do të zgjidhet nga ata kur ata duhet të punojnë së bashku (Armstrong, 2012, fq. 294).

Megjithëse ideja e një ekipi me performancë të lartë që punon ngushtë dhe është bashkëpunues është tërheqës, rreziku i detyron njerëzit të bëjnë një marrëveshje të re shpërblimi, dhe të cilët tashmë mund ta përdorin për një mënyrë të re pune.

3.10.1 Përformanca ekipore dhe shpërblimi ekiporë

Në disa ndërmarrje mund të jetë më e favorshme që të mos zbatohen objektiva individuale të performancës dhe të fokusohen vetëm në planet e shpërblimit kolektiv dhe të performancës grupore. Kramar dhe Syed (2012) kanë identifikuar se shpërblimet ose stimujt e grupeve kanë më shumë gjasa të japin një qasje bashkëpunuese ndaj performancës dhe në këtë mënyrë të jenë më efektive në arritjen e qëllimeve tuaja të përbashkëta. Ata gjithashtu argumentojnë se skemat e nxitjes kolektive mund të inkurajojnë më shumë blerjet organizative nga punonjësit në krahasim me ato skema të një natyre individuale. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që shpërblimet e bazuara në ekip nuk janë në përputhje me skemat e pagesave individuale të performancës, pasi të dyja mund të kombinohen me vëmendje të kujdesshme. Siç komenton Kerrin dhe Oliver (2002) në hulumtimin e tyre mbi aktivitetet e përmirësimit kolektiv dhe individual, efektiviteti i shpërblimeve kolektive ose ekipore mund të lidhet drejtpërdrejt me kulturën e ndërmarrjes. Pasi paga bazë nga pikëpamja individualiste është parë gjithmonë si shtylla kurrizore e kompensimit, kur modeli organizativ shkon në ekipet mbështetëse për produktivitet, atëherë shpërblimet kolektive të aplikueshme duhet të përshtaten për të mbështetur atë. Ata gjetën se kompanitë ballafaqohen me sfida në lëvizjen nga një sistem tradicional shpërblimi i bazuar tek individi në një strukturë shpërblimi të bazuar në ekip, duke aluduar në të njëjtën kohë për suksesin e pritur nga ky ndryshim. Ata gjithashtu theksojnë se sfidat gjithashtu lindin dhe janë edhe më të mëdha kur proceset e prodhimit mund të ndërtohen rreth konceptit të ekipeve,

ndërsashpërblimet për aktivitetet e përmirësimit të vazhdueshëm mbeten ende të lidhura me shpërblime individuale.

Një studim i Michael D. Johnson (2009) argumenton efektivitetin e sistemit të shpërblimit të bazuar në ekip në kuptimin bazë. Dinamika e ekipit luan një rol të madh në "ndërvlerësinë e shpërblimit", pra se si shpërblimi i një individi bazohet në punën e një anëtarit tjetër të ekipit. Ky studim argumenton nevojën për të futur më shumë stimuj individualë brenda strukturës së shpërblimit të bazuar në ekip. Alokimet e barabarta bëhen të rëndësishme kur shpërblimi nuk varet vetëm nga performanca e përgjithshme e ekipit, por ato ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet të gjithë anëtarëve të ekipit (Johnson, 2009, fq. 4). Ai sugjeron se anëtarët e ekipit duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin për të arritur rezultatin e tyre përfundimtar, por ata shpërblehen ndryshe bazuar në atë që kanë kontribuar në performancën e ekipit. Ai gjithashtu gjeti se ku është e dukshme transparenca e kontributeve të anëtarit të ekipit, atëherë ai mund ta bëjë anëtarin e ekipit më të vetëdijshëm për atë kontribut, duke rritur kështu tendencën për të vepruar në favor të ekipit.

Hulumtimi në marrëdhënien ndërmjet fuqizimit dhe shpërblimeve nga Born dhe Molleman (1996) zbuloi se sistemi i saktë i shpërblimit, i orientuar në mënyrë të drejtë, mund të mbështesë fuqizimin e punonjësit. Kjo ishte në kontekstin e grupeve të punës autonome ku trajnimi kyç ishte mbizotërues. Megjithatë shpërblimet e rastësishme konsideroheshin të jenë më pak efektive, aplikimi i tyre për të shpërblyer sjelljen e grupit konsiderohej të jetë më efektiv dhe inkurajoi një ndjenjë të përgjithshme të fuqizimit.

Në mënyrë të ngjashme, në një sondazh të kryer mbi shpërblime të bazuara në ekip në grupet kompjuterike të ndërmjetësuar (Rock et al., 2011, fq.431), të gjeturat

ehulumtimit treguan një rezultat më të ulët të performancës aty ku punonjesit kishin të njëjtën përgjegjësi. Ata gjithashtu sugjerojnë që çdo shpërblim ose proces njohjeje duhet të jetë formale dhe të largohet nga shumë ndikime të drejtpërdrejta menaxheriale. Ajo duhet të shihet dhe të jetë e paanshme dhe e drejtë për të gjithë pa asnjë dallim.

Me rritjen e përdorimit të strukturave të punës në ekip, është e rëndësishme të zgjedhësh shpërblimet e duhura për të arritur performancën më të lartë. Por sjelljet konstruktive mes anëtarëve të ekipit janë gjithashtu të rëndësishme. Argumenti për shpërblimet e ekipit bazuar në barazinë ku të gjithë anëtarët e ekipit shpërblehen në mënyrë identike në krahasim me një sistem barazie ku anëtarët shpërblehen bazuar në performancën e tyre individuale edhe pse ata punojnë në ekip (Bamberger dhe Levi, 2009, fq. 301).

Ata gjetën "struktura të pagave të orientuara drejt barazisë" brenda një skuadre të caktuar që çoi në sjellje më të mira të sjelljes për ekipin, si dhe një bashkëpunim më pozitiv midis anëtarëve e po ashtu edhe shkëmbim më të mirë të kompetencave individuale. Pra, në vend që të fokusohen në qëllimet specifike të performancës së individit, ata shohin se një strukturë shpërblimi e bazuar në ekip mund të sjellë rezultate pozitive sidomos kur shokët e ekipit ju përgjigjen kërkesave për të ndihmuar dhe asistuar shokët tjerë të ekipit. Shpërblimi i sjelljeve të lidhura me skuadrën, të tilla si ndihma e shokëve të skuadrës tuaj, rritën efektivitetin dhe rezultatin e të gjithë ekipit.

Ai zbuloi gjithashtu se individët në nivelin më të lartë të zhvillimit brenda ndërmarrjes ishin më të prirur për të ndihmuar në vendosjen e ekipit në nivelin e dëshiruar

dhe ata e bënin këtë në mënyrë që të mos ishte avantazhi i tyre i dukshëm. Kuptimi i sjelljes është i rëndësishëm në këtë kontekst. Weightman (2004) përshkruan ndikimin e sjelljes së punonjësve nëpërmjet udhëzimit dhe shpërblimit si modifikim sjelljesh. Kjo është e rëndësishme për menaxhimin e njerëzve, sepse nëse personaliteti mësohet dhe mbështetet në përforsim, atëherë lloji i duhur i shpërblimeve të aplikuara për një ekip duhet të sjellë sjellje pozitive që mund të rrisin motivimin dhe performancën. Në mënyrë të ngjashme, King (2007) argumenton se nisja e punës së ekipit në një shkallë të vogël në të gjithë ndërmarrjen dhe përqendrimi në detyrat thelbësore që i ndihmojnë njerëzit të rriten përgjatë gjithë zinxhirit të karrierës, do të kontribuojnë pozitivisht në motivimin e punonjësve dhe zhvillimin e karrierës së tyre.

Vlefshmëria e sistemeve të shpërblimit në bazë të ekipeve mund të varet edhe nga industria specifike apo ndërmarrja në të cilën ato zbatohen. Ndonjëherë kombinimi i stimujve individuale dhe grupore financiare si dhe një përzierje e skemave të shpërblimeve formale dhe joformale mund të inkurajojnë punonjësit që të angazhohen në të dy rolet në rolin e brëndshëm dhe rolin e jashtëm në të njëjtën kohë, (Yap et al, 2009, fq, 280).

Ka dëshmi për të sugjeruar që stimujt individualë monetarë brenda një skuadre të caktuar, të përafruara me llojin e duhur të shpërblimeve në grup, mund të ndikojnë pozitivisht në sjelljet, dinamikën e ekipit dhe produktivitetin e ndërmarrjes. Sidoqoftë shumë ndërmarrje janë të ngadalta për të zbatuar pagat e ekipit ose shpërblime të tjera ekstra ndaj ekipit, sepse ato janë mjaft të kënaqura me skemat e tyre individuale të shpërblimit të performancës (Armstrong, 2007, fq, 352). Janë këto kompani që duhet të marrin parasysh shpërblimet e bazuara në ekip si një mjet të fuqishëm për të përmirësuar

performancën e ekipit nëse dëshirojnë të përfshijnë punën dhe ti shpërblejnë si pjesë e një sistemi të menaxhimit të performancës.

Në mënyrë të ngjashme, në studimin e tij mbi programet e shpërblimit dhe njohjes në mjedisin e bazuar në njohuri, Milne (2007) zbuloi mangësi të mëdha se si shpërblimet e bazuara në ekip ishin parë në aspektin e motivimit. Punonjësit mund të kenë vështirësi të shohin se si përpjekjet e tyre përkthehen në rezultate dhe mund të demotivohen nëse ata shohin një anëtar të ekipit të shpërblehet për mos kontribut të mjaftueshëm për rezultatin përfundimtar. Ai argumenton se një shpërblim i bazuar në barazi në një skuadër të caktuar është më produktive dhe motivuese se sa një shpërblim i bazuar në ekuilibër pa dallim kontributi, ku të gjithë marrin të njëjtin shpërblim.

Prandaj dizajni i shpërblimeve të bazuara në ekip është jetësor në qoftë se ju duhet të shmangni efektet negative mbi motivimin, që përfundimisht do të çojë në probleme më të mëdha për ndërmarrjen tuaj nëse lejohet të nxisë dallime dhe privilegjime. Pra, identifikimi i shpërblimeve të sakta për ekipin tuaj duhet të ndiqet nga dizajni i duhur i asaj strategjie. Përshtatja e qëllimeve organizative me zhvillimin e shpërblimeve të bazuara në ekip dhe duke përfshirë kulturën dhe vlerën e ndërmarrjes në këtë zhvillim, është qasja e sugjeruar. Studiuesit tregojnë se ndonëse vlerësimi i sistemeve të shpërblimit në fjalë shfaq një nivel më të lartë të angazhimit të punonjësve pas një ndryshimi në atë sistem, nuk mund të lidhej përfundimisht me performancën e përmirësuar të tyre.

3.11. Menaxhimi i shpërblimit në ndërmarrje

Politikat e shpërblimeve të ndërmarrjeve janë një tregues i mirë për punonjësit dhe të rekrutuarit e rinj potencial, megjithatë ato varen nga një numër faktorësh dhe kërkojnë nivele të larta të performancës nga punonjësit e saj. Po ashtu ato varen edhe nga shkalla në të cilën ekziston konkurrenca për individët dhe punonjësit me cilësi të lartë pastaj qëndrimi tradicional i ndërmarrjes për shpërblimin, kultura organizative e saj si dhe nëse duhet ose nuk duhet të ketë shpërblime për punonjësit e saj, dhe në fund mund ta përballojë ajo një pagesë ekstra të lartë e cila ndahet për shpërblime (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018).

Politikat mbi nivelet e pagave gjithashtu do t'i referohen diferencave që ekzistojnë në hierarkinë e pagave. Është krejtësisht e natyrshme që kjo ndikohet edhe nga struktura e ndërmarrjes. Politikat në nivelin e shpërblimeve gjithashtu mbulojnë përfitimet e punonjësve të cilët i marrin nga ndërmarrjet si pensionet, pagesat për sëmundje, kujdes shëndetësor, pushimet e ndryshme dhe makinat e ndërmarrjes që shfrytëzohen nga punonjësit e sidomos stafi i saj menaxhues. Politika e cila duhet të formulohet në ndërmarrje për shpërblimet duhet të jetë politike e drejtuar kah tregu. Kjo politikë do të ndikohet nga filozofia kulturore dhe shpërblimi i organizimit dhe presionet mbi biznesin për të marrë dhe mbajtur staf me cilësi të lartë, inovator dhe kreativ. Çdo ndërmarrje që deshiron të tërheqë dhe të mbajë stafin e saj brenda saj, ajo duhet deri në një farë mase të sakrifikojë idealet e saja të barazisë së brendshme për ti realizuar qëllimet e veta nga tregu i vendit apo edhe i huaj. Ato do të jenë të shtyrë të ofrojnë “pagë të tregut” me fjalë të tjera, ato do të jenë “të shtyrë nga tregu” (Armstrong, 2010).

Procesi i menaxhimit të pagave duhet të përballojë sa më mirë që të jetë e mundur forcat e parezistueshme të presioneve të tregut, për të plotësuar objektivin e paluajtshëm të barazisë së brendshme të ndërmarrjes. Gjithmonë do të ketë njëfarë tensioni në këto rrethana, ndonëse asnjë zgjidhje nuk do të jetë kurrë e thjeshtë apo plotësisht e kënaqshme, prapë së prapë ekziston një parim bazë që mund të rrisë gjasat e suksesit. Ky parim ka të bëjë qartë dhe plotësisht me kompromiset dhe barazinë e brendshme që janë bërë dhe duhet të bëhen në përgjigje të presioneve të tregut.

Politikat e brendshme të ndërmarrjes duhet të marrin në konsideratë tryshinën e tregut dhe të nxisin nivelizimin dhe ngritjen e pagës në ndërmarrje sidomos për punë shtesë dhe inovative. Po ashtu politikat e ndërmarrjes mund të përcaktojnë që këto pagesa shtesë duhet të rishikohen rregullisht dhe të mos ofrohen më nëse ato janë të panevojshme. Shtesat e përcaktuara në bazë të tregut të punës për ata që i kanë ato nuk mund të tërhiqen (njerëzit e interesuar nuk do të humbasin pagën), por përshtatjet mund të bëhen për të paguar progresin për të sjellë normat e tyre në linjë me ato për punë të krahasueshme. Pagat e tregut dhe shtesat e tregut mund të çojnë në pabarazi gjinore, siç ndodh shpesh ku burrat në punë të krahasueshme paguhen më shumë ose marrin më shumë shtesa në bazë të tregut të punës sesa gratë. Segmentimi i shpërblimeve përfshin ndryshimin e paketës së shpërblimeve për punë të ndryshme ose për llojet dhe nivelet e pasqyruara të kontributit që bëjnë njerëzit, ose sigurimin e shpërblimeve të përshtatura për të përmbushur nevojat individuale (Robbin et al, 2014).

Një politikë mbi segmentimin dhe shpërblimin e tyre do të njohë si pjesë e fuqisë punëtore dhe individëve në fazat e suksesshme të karrierës së tyre dhe të cilët mund të

motivohen nga kombinimet e ndryshme të shpërblimeve. Një paketë me shpërblime mund të përshtatet për të përmbushur këto nevoja. Shpërblimet mund të segmentohen për të marrë parasysh dallimet kryesore të punonjësve. Kjo mund të nënkuptojë pagë individuale të performancës për disa, shpërblim ekipor për të tjerët, dhe forma të tjera të përparimit dhe njohjes së pagave në vend të stimujve për një grup të tretë e kështu me radhë. Mbrojtja është procesi i trajtimit të situatës kur, pas futjes së një strukture të re pagash, paga ekzistuese e disa punonjësve mund të jetë mbi maksimumin për klasën e tyre të re. Në këto rrethana, rregulli i përgjithshëm është që askush nuk duhet të pësojë një reduktim në normën e tanishme të pagës. Përtej kësaj, çështjet janë ato që duhet të mbrohen saktësisht dhe nëse mbrojtja duhet të jetë për një periudhë të kufizuar dhe nëse po, për sa kohë duhet të jetë kjo mbrojtje (Heckhausen. J, Heckhausen.H, 2018).

Qasja e zakonshme e drejtuesve është të lejojë stafin që të vazhdojë të fitojë ndonjë rritje në të cilën ata kanë të drejtë sipas marrëveshjeve ekzistuese deri në një maksimumin të shkallës të cilën mund ta lejojë dhe përballojë ndërmarrja. Ata gjithashtu kanë të drejtë të marrin pagën bazë që i jepet stafit përgjithësisht për aq kohë sa ato mbeten pa punën e tyre të tashme nëse kjo ndodh për shkaqe të ndryshme të ndërmarrja nga menaxhimi i ndërmarrjes dhe kjo mund të ndodhë për një kohë të caktuar. Nëse periudha është e kufizuar, ata nuk do të kenë të drejtë për rritje të përgjithshme derisa norma e tyre e pagave të kalojë brenda shkallës së re për punën e tyre dhe aktivizimin e tyre. Ata pastaj do të kenë të drejtë për të njëjtat ngritje si çdo staf tjetër në departamentin e tyre. Kur individ i në fjalë të punës, shkalla e pagës për punën kthehet në rangun standard të përcaktuar pas vlerësimit të punës (Armstrong dhe Murlis, 2018).

Një qasje e përgjithshme e shpërblimeve lidhë të gjitha aspektet e shpërblimit së bashku dhe i trajton ato si një tërësi të integruar dhe koherente. Kjo do të thotë së gjatë zhvillimit të sistemit të shpërblimit, punëdhënësit duhet të kenë parasysh të gjitha aspektet e punës që punonjësit i vlerësojnë. Një nga personat e parë që shkruan për shpërblimet e përgjithshme ka qënë Adam Smithi (O'Neal, 1998) i cili komentoi se: "Shpërblimi total përfshin gjithçka që punonjësit e vlerësojnë në marrëdhënien e punësimit". Siç përcaktohet nga Manus dhe Graham (2003) shpërblimi përfshin të gjitha llojet e shpërblimeve qofshin ato indirekte apo të drejtpërdrejta, të brendshme dhe të jashtme. Kantor dhe Kao (2004) përcaktojnë shpërblimet totale si 'Çdo gjë që një punonjës merr si rezultat i punës se kryer për ndërmarrjen / kompaninë '.

Një përkufizim i gjerë ishte ofruar nga Worldat Work (2000), i cili deklaroi se shpërblimet totale janë 'të gjitha mjetet e disponueshme të punëdhënësit që mund të përdoren për të tërhequr, mbajtur, motivuar dhe kënaqur punonjësit. Paul Thompson (2002) sugjeron së përkufizimet e shpërblimeve të përgjithshme zakonisht përfshijnë jo vetëm elemente monetare, si paga, paga dhe përfitime të ndryshueshme, por edhe elemente jo-monetare të paprekshme, të tilla si fushëveprimi për të arritur dhe ushtruar përgjegjësi, mundësi karriere, mësim dhe zhvillim, motivimi i ofruar nga vetë puna dhe cilësia e jetës së punës të ofruara nga ndërmarrja. Por gjithashtu vlerëson rëndësinë e sigurimit të njerëzve me përvoja shpërblyese që dalin nga puna që ata bëjnë, pastaj si ato menaxhohen në mundësi për të zhvilluar aftësinë dhe karrierën e tyre.

Është një pamje gjithëpërfshirëse e shpërblimit që shikon sistemin e përgjithshëm të shpërblimit për të përcaktuar se si duhet të integrohen elementet e saj në mënyrë që të

sigurojnë përkrahje reciproke për të kontribuar në efektivitetin e përgjithshëm të sistemit. Mbështetja nuk është e vendosur në një ose dy mekanizma shpërblimi që veprojnë në izolim, por merrë parasysh çdo mënyrë në të cilën individët dhe punonjësit mund të shpërblehen dhe të marrin kënaqësi nëpërmjet punës së tyre. Qëllimi është të maksimizojë ndikimin e kombinuar të një game të gjerë iniciativash të shpërblimit për motivimin, dhe angazhimin e punonjësve për vendet e tyre të punës.

Megjithatë, IDS (2008) komentoi “se si një filozofi shpërblimi total thekson vlerën e aspekteve jofinanciare të propozimit të vlerës së punonjësve, por përsëri paga mbetet fondacioni mbi të cilin është ndërtuar gjithçka tjetër”.

Termi shpërblime totale është miratuar në këtë punim disertacioni, sepse ishte termi që përdoret kur koncepti u prezantua për herë të parë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitet 1990 dhe përcakton parimin themelor se ka një numër mënyrash për shpërblimin e njerëzve përveç pagës (Ryan dhe Deci, 2017). Filozofia e shpërblimeve totale ndikohet fuqishëm nga koncepti i motivimit të brendshëm, i cili del nga vetë puna dhe ndikimi i tij në faktorët e vetë-gjeneruar që ndikojnë në sjelljen e individëve.

Teoria e motivimit përcakton dallimin midis motivimit të jashtëm dhe motivimit të brendshëm dhe tregon se nivelet e larta të motivimit dhe performancës arrihen duke plotësuar nevojat e ndryshme, prej të cilave vetëm njëra është për para dhe pikërisht është ajo që synon të bëjë shpërblimet. Motivimi i brendshëm zhvillohet kur individët mendojnë se puna e tyre është e rëndësishme, interesante dhe sfiduese dhe u siguron atyre një shkallë të arsyeshme të autonomisë, mundësi për të arritur dhe avancuar në karrierë, si dhe në

fushëveprimin për të përdorur dhe zhvilluar aftësitë e tyre. Një argument i fuqishëm për gasjen e shpërblimeve totale u prodhua nga Pfeffer (1998): Krijimi i një mjedisi argëtues, sfidues dhe të fuqizuar të punës, në të cilin individët janë në gjendje të përdorin aftësitë e tyre për të bërë punë të rëndësishme me të cilat ata tregojnë aftësitë e tyre, mund të jenë një mënyrë më e sigurtë për të rritur motivimin dhe performancën e tyre, edhe pse krijimi i një mjedisi të tillë mund të jetë i vështirë dhe të marrë më shumë kohë se thjesht të ktheni levën e shpërblimit. Sipas CIPD-it (Arkin, 2005) nuk ka patur kurrë kohë më të mirë për t'u bërë specialist i menaxhimit të shpërblimeve. Ky këndvështrim bazohet në provat e nxjerra nga studimi vjetor i shpërblimeve të vitit 2005 të Institutit (CIPD, 2005), i cili zbuloi se kërkesa për ekspertizë të tillë po rritet, dhe ku shumë ndërmarrje tani po punësojnë praktikues dhe specialistë shpërblimesh.

Por përse janë shpërblimet kaq të rëndësishme dhe cila është menyra më e mirë që ato të menaxhohen dhe përjetohen në punë, dhe pse është kjo pjesë kaq e rëndësishme për menaxhimin e burimeve njerëzore? Një pikënisje e dobishme është të pranosh se shpërblimet janë element bazë i marrëdhënies së punësimit dhe kanë ndikim vendimtar të kënaqësia dhe përkushtimi i punonjësve. Ndërmarrjet që nuk arrijnë të kuptojnë këtë marrëdhënie themelore ka të ngjarë të jenë më pak konkurruese dhe më pak të suksesshme sesa ato që e kuptojnë këtë dhe japin politika dhe praktika shpërblimi vazhdimisht për punonjësit e tyre. Për kundër kësaj është mjaft e thjeshtë të kuptohet kur punonjësit janë të ndrydhur dhe të pakënaqur me shpërblimet që marrin, dhe këtë ata do ta shprehin me anë të mënyrës se si ata sillen dhe si performojnë në punë dhe kjo padyshim që nuk do të jetë në interes të ndërmarrjes. Ndërmarrjet që gabojnë në mënyrën se si i menaxhojnë shpërblimet

ka të ngjarë dhe me siguri do të përjetojnë pasoja dëmtuese në disa forma, ato do të kenë pasoja duke u nisur nga produktiviteti i ulët pastaj qarkullimi i madh i punonjësve sidomos të atyre kreativ dhe inovatorë si dhe mungesë e përgjithshme e angazhimit të punonjësve. Sa më i madh të jetë gabimi, aq më e lartë është kostoja që do të përjetojë dhe do të paguajndërmarrja.

Sikurse vëzhgoi Paul Bissell-i (në Arkin, 2005): ndërmarrjet po e kuptojnë çfarë leve e fuqishme është shpërblimi dhe si nevojitet ai për të plotësuar strategjitë e tjera të biznesit. Kjo do të thotë se menaxhimi i shpërblimeve nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me çështjet bazë të pagesës së njerëzve për punën që ata bëjnë dhe sa mirë ata performojnë në punë, por shtrihet edhe tek impakti i vendimeve të shpërblimit në zgjedhje, mbajtje, trajnim, fleksibilitet, performancë dhe përkushtim. Është e dukshme se pa shpërblime të kënaqshme, ndërmarrja nuk do të jetë në gjendje as të tërheqë e as të mbajë kualitetin e punonjësve që kërkon. Në fakt, nuk do të ishte e ekzagjeruar të theksonim se shpërblimet kanë një domethënie që prek pothuajse çdo aspekt të punësimit dhe punës në ndërmarrje, prandaj nuk është e çuditshme që interesi në menaxhimin e shpërblimeve po rritet dita ditës.

Por ndërkohë që çështja e pagesës dhe e shpërblimit është themelore për sjelljen dhe performancën e punonjësit, në mënyrë të theksuar ajo është një nga fushat më të diskutueshme dhe më të vështira të burimeve njerzore për t'u menaxhuar por edhe për tu zabatuar në praktikë. Specialistët e shpërblimeve jo vetëm që duhet të sigurohen se punonjësit paguhen drejt dhe në mënyrë të përshtatshme, por duhet edhe të shmangin mbi pagesat, në kontekstin e asaj që ndërmarrja mund të përballojë.

Natyra sfiduese e menaxhimit të shpërblimeve është edhe rezultat i natyrës gjithnjë e më të ndërlikuar të “paketës së shpërblimeve”. Shpërblimet nuk kanë të bëjnë vetëm me pagesën dhe paratë. Sipas Thompson-it (2002): ... epoka ku shpërblimet kishin të bënin vetëm me paratë e thata në dorë dhe me përfitimet ka ikur përgjithnjë, gjithnjë e më shumë theksi në ndërmarrjet udhëheqëse është te një qasje totale e shpërblimeve, duke përfshirë më shumë shpërblime të paprekshme si konsideratat për mjedisin e punës dhe cilësinë e jetës, mundësi për përparim në karrierë pastaj punë me orar fleksibël, shëtitje, ekskursione, pushime etj.

Nuk ka përgjigje dhe receta të thjeshta ose universale që janë të garantuara se funksionojnë. Ajo që del nga kontributet e ndryshme akademike dhe gjetjet e studimeve dhe përvojat individuale rezulton se nuk ka konsensus mbi mënyrën sesi ndërmarrjet duhet t'i shpërblejnë punonjësit, dhe as nuk ka siguri se përdorimi i shpërblimeve të caktuara do të garantojë sjelljet dhe rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga menaxherët e tyre.

Shumë menaxherë dhe punonjës sinqerisht besojnë se shpërblimet e përdorura në këtë mënyrë kanë impakt pozitiv të motivimi i punonjësit dhe të përdorura në mënyrën e duhur ato mund të rrisin nivelet e performancës individuale dhe kolektive. Nga ana tjetër, autorë të tillë si Herzberg-u (2003) dhe Kohn-i (1993) kanë mbështetur vazhdimisht këndvështrimin se shpërblimet e tilla me para shtesë nuk japin rezultatet e synuara, por në fakt shtrembërojnë sjelljen dhe kanë efekte afatgjata të dëmshme te produktiviteti. Kohn-i madje i barazon këto pagesa shtesë me “ryshfetë” dhe për këtë ai argumenton se ato nuk duhet të përdoren, pavarësisht faktit se shumë menaxherë dhe punonjës besojnë se njerëzit do të bëjnë punën më mirë nëse u është premtuar një lloj shpërblimi ose stimulimi.

Vështirësitë që hasin menaxherët në përcaktimin e strategjisë më të përshtatshme dhe më efektive të shpërblimit për ndërmarrjet jo vetëm që nënvizohet në literaturën akademike, por edhe në realitetet e jetës organizative të ndërmarrjes. Dilema që ata hasën është se derisa punonjësit vlerësojnë shpërblimet, dhe në përgjithësi do të donin më shumë, shpërblimet mund të jenë shumë të kushtueshme për ndërmarrjet dhe nëse pagesa është forma mbizotëruese e shpërblimit. Ti mbipaguash punonjësit mund të jetë gabim i kushtueshëm. Duhet mbajtur mend se është shumë më e lehtë të japësh shpërblime sesa t'i heqësh ato pasi i ke vënë. Në të njëjtën kohë, është e natyrshme të presësh që punonjësit do të duan të maksimizojnë nivelet e pagesës dhe të shpërblimit, për të pasqyruar këndvështrimet e tyre për vlerën dhe kontributin që besojnë se ata japin në ndërmarrje. Ky tension midis asaj që punonjësit ndiejnë se vlejnë dhe asaj që menaxherët konsiderojnë se është ekonomikisht e mjaftuar që të paguash është shpesh në zemër të mosmarrëveshjeve dhe konfliktit midis dy palëve, veçanërisht nëse janë të përfshira shpërblimet financiare. Nëse ndërmarrja do të kërkonte opinionin e punonjësve për këtë çështje, me shumë gjasa do të zbulonte se punonjësit e konsiderojnë veten të nënpaguar më tepër sesa të mbipaguar. Mirëpo nëse kjo pyetje do t'u bëhej për shpërblimin se a e konsideronin ata veten të nënshpërblyer më tepër sesa të mbi shpërblyer kjo është një pyetje tjetër. Por duke pasur parasysh që pagesa është shpërblimi më i dukshëm dhe në mënyrë të argumentueshme edhe më i rëndësishëm nga punësimi dhe për të punsuarit, prirja që punonjësit të besojnë se paguhen më pak sesa mendojnë se meritojnë të paguhen ndihmon për të shpjeguar përse pagesa është shpesh shkak i shumë shpërthimeve të konflikteve industriale.

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

4.1. Hyrje në metodologjinë e hulumtimit

Ky kapitull paraqet në mënyrë të përmblëdhur metodologjinë e përdorur për realizimin e këtij studimi, duke u fokusuar në procesin e ndjekur, llojin e të dhënave të mbledhura, mënyrën e përdorur për mbledhjen e të dhënave, llojin e instrumenteve të përdorur për analizën e tyre, përcaktimin e mostrës së studimit, mënyrën e analizës së vlefshmërisë dhe besueshmërisë së të dhënave, të cilat shërbejnë për të dhënë përgjigje ndaj hipotezave dhe pyetjeve kërkimore të ngritura në këtë studim.

Në këtë studim është përdorur analiza përshkrues e të dhënave, ku përmes analizës qendrore statistikore është përdorur fuzionomi i të dhënave. Hulumtimi përshkrues përfshin mbledhjen e të dhënave, përshkruan fenomenin dhe pastaj organizon, tabulon dhe përshkruan mbledhjen e të dhënave, në formën e grafikëve dhe tabelave, me qëllim që të ndihmojë lexuesit të kuptojë shpërndarjen e të dhënave. Në literaturë mund të përdoren dy mënyra logjike të zhvillimit të një strukture të një studimi, përkatësisht afrimi induktiv dhe afrimi deduktiv. Afrimi induktiv është i bazuar në supozimin se teoria është e zhvilluar nga kërkimet empirike të ngjarjeve. Kjo do të thotë se nga kërkimi individual të ndërtohet një model i përgjithshëm. Afrimi deduktiv realizohet duke identifikuar idetë e caktuara nga teoritë dhe pastaj të bëhet testimi i kësaj teorie. Kjo metodë konsiston që nga e përgjithshmja në një situatë të caktuar dhe është e kundërta e afrimit induktiv.

Në këtë punim afrimi deduktiv është më i përshtatshëm sepse nga teoritë që janë

dhënë në literaturën e rishikuar lidhur me rolin e motivimit në menaxhimin e ndërmarrjes, e që në fillim nevojitet të analizohet literatura mbi teoritë ekzistuese e cila shpjegonë fenomenin e motivimit në ndërmarrje, modelët që janë dhënë në lidhje me rolin e motivimit në menaxhimin e ndërmarrjes, dhe në fundë të analizohet motivimi në NVM-të e marra në studim. Në lidhje me zgjedhjen e metodës më të përshtatshme për marrjen e të dhënave identifikohen dy strategji kërkimi: kërkimi cilësor dhe kërkimi sasior. Metoda cilësore është e fokusuar se si e shohin individët apo grupet problemin dhe si e përceptojnë nga përvoja e tyre. Kërkimi cilësor përgjigjet i merr në formë të shkruar dhe metoda përkatëse për këtë janë intervistat dhe pyetësorët e hapur.

Kërkimi sasior përpiqet t'i shpjegojë fenomenet në bazë të numrave të fituara nga rezultatet kurse konkluzionet janë të bazuara në të dhënat që mund të kuantifikohen. Ky lloj kërkimi informacionet i merr prej pyetësorëve të strukturuar ku informacionet shprehen në shifra dhe ato analizohen me metoda statistikore për të testuar hipotezat e parashtruara. Rezultatet e nxjerra nga analiza statistikore do të ndihmojnë në marrëdhënien në mes të variablilit të pavarur dhe një variable të varur, si dhe do të tregojë sa është ndikimi i variablave të pavarura në variablin e varur.

Në hulumtim tim është përdorur teknika e kërkimit sasior, ku përmes mbledhjes së të dhënave numerike përmes pyetësorit është shpjeguar fenomeni i motivimit në menaxhimin e ndërmarrjes, përkatësisht tek NVM-të në rajonin e Dukagjinit.

Studimi është organizuar në disa hapa kryesorë, që në mënyrë të përmbledhur paraqiten më poshtë:

✓ Përcaktimi i fushës së studimit është hapi i parë prej nga ka lindur ideja erealizimit të këtij studimi. Tema e përzgjedhur është një fushë me rëndësi për t'u studiuar për vlerat

që ka si kontribuues kyç, jo vetëm në suksesin ekonomik të ndërmarrjeve, por edhe në efektin afatgjatë që këto praktika sjellin në zhvillimin ekonomik të vendit, si rrjedhojë e ndikimit të tyre ndaj zhvillimit dhe fuqizimit të kompanive prodhuese. Një trajtim më i gjerë për arsyet e përcaktimit të kësaj fushe studimi është paraqitur në kapitullin e analizës së problemit dhe objektivave të kërkimit.

✓ Rishikimi i literaturës është hapi i dytë i procesit të studimit, i quajtur ndryshe edhe si kërkimi dytësor, është bazuar në evidentimin e aspekteve teorike që janë studiuar dhe evidentuar më parë nga autorë të ndryshëm, në mbështetje të qëllimit të përgjithshëm të këtij studimi. Procesi i rishikimit të literaturës është realizuar nëpërmjet studimit të botimeve të ndryshme në këtë fushë, libra, artikuj shkencorë dhe studime të mëparshme. Kërkimi i literaturës synon të nxjerrë në pah atë çfarë është e njohur në aspektin teorik, evidentimin e teorive bazë në lidhje me qëllimin e këtij studimi, dhe konkretizimin e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore. Rishikimi i literaturës është bërë duke shfrytëzuar burime të ndryshme dhe data baza kërkimi të universiteteve perëndimore.

✓ Përcaktimi i pyetjeve kërkimore dhe hipotezave është një hap i rëndësishëm i studimit, pasi shërben për t'i dhënë formë procesit të kërkimit që do të kryhet më pas. Në këtë studim janë përcaktuar disa pyetje kërkimore dhe hipoteza që fokusohen në objektivat e studimit dhe që ndihmojnë për realizimin e objektivave të tij. Pyetjet kërkimore lidhen ngushtësisht me objektivat e kërkimit dhe shërbejnë për të formësuar kërkimin parësor, pyetësorët, si dhe analizën e të dhënave.

✓ Zhvillimi i kërkimit parësor dhe analiza e të dhënave. - Kërkimi i të dhënave bëhet mbi bazën e kërkimit parësor dhe dytësor. Kërkimi dytësor, bazohet në rishikimin e literaturës dhe është trajtuar më hollësisht më sipër. Kërkimi parësor merr formë sipas llojit

të studimit që kryhet, qoftë cilësor apo sasior. Një nga strategjitë e kërkimit të përdorura për realizimin e studimeve është ajo e mbështetur në pyetësorët si një nga teknikat e mbledhjes së të dhënave që i përkasin kësaj strategjie. Studimi bazohet kryesisht në kërkimin sasior (empirik) i cili bazohet në mbledhjen e të dhënave faktike dhe kryerjen e analizave statistikore.

Ky studim fokusohet në marrëdhëniet menaxher - vartës në ndërmarrje, me një interes specifik për komponentin e ndikimit të **Motivimit në suksesin e ndërmarrjes**.

4.2. Përcaktimi i popullacionit dhe mostrës

Përcaktimi i mostrës është bërë përmes metodës së rastësishme dhe me shkallën 5% të popullacionit. Duke u bazuar në raportin e ASK dhe ARBK (2017), rezulton se në rajonin e Dukagjinit janë 1,178 biznese të vogla dhe të mesme¹, pra një mostër reprezentative do të jetë 59 biznese të vogla dhe të mesme. Për këtë studim u plotësuan 379 pyetësor. Në kategorizimin e bizneseve në bazë të komunave është si një vijim:

Tabela 6. Kategorizimi i NVM-ve në bazë të komunave

Komunat (Regjioni i Dukagjinit)	Numri i bizneseve	Pjesëmarrje në % e bizneseve	Numri i bizneseve të anketuara	Numri i të anketuar
Pejë	616	52.29%	29	196
Deçan	179	15.20%	9	63
Klinë	180	15.28%	7	49
Istog	203	17.23%	14	71
	Totali 1178	100%	59	379

Burimi : ASK, 2017

Sipas ARBK (2017), numri i të punësuarve është 8,713 në bazë të regjistrimit fillestar të tyre në ARBK. Sipas formulës Taro Yamane kemi këtë mostrim:

$$n = \frac{N}{1 + N * (e)^2}$$

$$n = \frac{8713}{1 + 8713 * (0.05)^2} = 382$$

n – paraqet kampionin e mostres

N – popullatën e përzgjedhur

e – konstante

¹Numri i bizneseve përfshinë Pejë, Deçan, Klinë, Istog

Pyetësoni është bërë në 59 biznese nga 3 deri në 11 pyetësor, varësisht nga numri i të punësuarve, ku mesatarja llogaritet 7 pyetësor për biznes, pra $59 \cdot 6.4745 = 382$ pyetësor.

4.3. Teknika e popullacionit dhe mostrës

Teknika e përdorur e hulumtimit është mbledhja e të dhënave nga një pyetësor i strukturuar mirë nga dy autorët e ndryshëm. Përgjithësisht për plotësimin e pyetësorëve është parë e arsyeshme kontakti individualë me pronarët, menaxherët dhe punonjësit.

Teknika statistikore e përdorur për hulumtimin e tezës së doktoraturës është përmes metodës së rastësishme të përzgjedhjes nga popullacioni bazë, ku në këtë rast kemi përdorur shkallën 5%.

Përdorimi i teknikës së rastësishme të mostrës është bërë në rrafshin e Dukagjinit (në disa komuna të këtij regjioni), ku janë përzgjedhur në grupe të caktuara të anketuarve të punëtorëve, pronarëve dhe menaxherëve të nivelit të ndryshëm.

Gjatë punës me këtë teknikë të përzgjedhjes së mostrës, përmes metodës së rastit, popullacioni është përcaktuar në rregullin e artë statistikor, që bazohet në vlerat zyrtare apo burime sekondare publike, që janë një bazë e mirë për përcaktim të mostrës.

4.4. Struktura e pyetësorit

Duke pasur për bazë që hulumtimi im përdor të dhënat parësore, atëherë zhvillimi i pyetësorit ishte rruga e vetme drejtë nxjerrjes së të dhënave për analizë statistikore dhe ekonometrike.

Pyetësori është bazuar në bazë të dy punimeve të ndryshme, e para nga Jenifer Faraji (2013) dhe Waiyaki (2017). Pyetësori i shfrytëzuar nga dy punimet e ndryshme zhvillohen në dy vende të ndryshme Afrikane, të cilat kanë zhvillimin e NVM-ve në nivel me zhvillimin e NVM-ve në Kosovë. Të dy autorët përdorin këta pyetësor me qëllim të kontributit në zhvillimin e NVM-ve në vendet në zhvillim. Të dy punimet kanë zhvilluar pyetësorët në bazë të kërkesave të punimit të tyre, prandaj për nevojat e hulumtimit tonë kemi përdorur pyetësorët e të dy punimeve, në bazë të kërkesave të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave hulumtuese.

Pyetësori është i ndarë në 7 seksione:

Seksioni 1: Në këtë pjesë janë informatat e përgjithshme të anketues, që përfshin gjininë, moshën, pozitën në punë, vendbanimin.

Seksioni 2: Përfshin një grupim të disa pohimeve që kanë për qëllim përmbledhjen për motivimin në ndërmarrje.

Seksioni 3: Përfshin pjesën për përmbledhjen e pohimeve për menaxhimin në ndërmarrje.

Seksioni 4: Përfshin pjesën për përmbledhjen e pohimeve për kënaqësinë e punonjësve ndaj motivimit në ndërmarrje.

Seksioni 5: Përfshin pjesën për përmbledhjen e pohimeve për punonjësit dhe vlerësimi i performancës së tyre.

Seksioni 6: Përfshin pjesën për përmbledhjen e pohimeve për faktorët financiarë.

Seksioni 7: Përfshin pjesën për përmbledhjen e pohimeve për shpërblimin e punonjësve.

4.5. Metodologjia e analizës së të dhënave

Punimi është i bazuar në këtë model bazë të regresionit:

$$Y_{it} = \alpha_{it} + \beta X_{it} + u_{it}$$

ku i – nr përgjatë periudhës së studimit


Y_{it} = Menaxhimi i ndërmarrjes, gjatë periudhës t

X_{it} = variablat e pavarur të motivimit, gjatë kohës t që përfaqësojnë faktorët specifikë dhe ato jospesifikë të marrë në studim.

Farajii (2013) në punimin hulumtues të tij variablën e varur “Menaxhimi i Ndërmarrjes” e ndërton në bazë të fuzionimit të seksionit të pyetësorit që është përdorur në punim. Sipas shumë hulumtuesve në fushën e motivimit dhe menaxhimit të ndërmarrjes koncepti operacional i lidhjes ndërmjet motivimit dhe menaxhimit bëhet përmes shkrirjes së performancës, produktiviteti, nivelit menaxheria dhe arritjes së objektivave të ndërmarrjes, duhe u ndikuar nga motivimi në punonjësit e NVM-ve.

Waita dhe Namusonge (2013) trajtuan faktorët e motivimit që prekin NVM-të në Kenya. Sipas modelit konceptual të ndërtuar nga këta profesorë (2013), variabla e varur që në

modelin tonë konceptual është menaxhimi i ndërmarrjes, si koncept shumë dimensional, trajtohen si lidhje ndërmjet faktorëve të motivimit dhe performancës.




Waita dhe Namusonge (2013) modelin e tyre konceptual për menaxhim të ndërmarrjes dhe faktorëve të motivimit e ndërtojnë në këtë formë, duke operacionalizuar në variablën e varur performancën e NVM-ve. Në modelin tim konceptual për variablën e varur “Menaxhimi i ndërmarrjes” është vendosur si pjesë e fuzionimit të kësaj variable performanca (Shih seksionin 1: Pyetësi).

Nyangau dhe të tjerët (2014) trajtojnë në hulumtimin e tyre shkencor problemin e menaxhimit të NVM-ve në vendet e ndryshme të pazhvilluara të Afrikës. Sipas këtij hulumtimi të bërë në 526 biznese të vogla dhe të mesme, faktorët motivues të trajtuara në këtë hulumtim kanë pasur efekt pozitiv në lehtësimin e punës së stafit menaxhues të NVM-ve. Modeli i tyre konceptual për variablën “Menaxhimi i ndërmarrjes” lidhet me kënaqësinë që marrin të punësuarit drejt arritjes së objektivave të vendosura nga menaxhimi i NVM-ve, përmes motivimit.



Modeli konceptual i variablës së varur është lidhja e disa elementeve, që janë trajtuar në pyetësor, që lidhen me performancën, produktiviteti, nivelit menaxherial dhe arritjes së objektivave të ndërmarrjes.

Figura 16. Modeli Konceptual i Variablës së Varur “Menaxhimi i ndërmarrjes”



Burimi: Autori

Për të analizuar të dhënat e punimit është përdorur modeli ekonometrik me shumë variabla, në ndërtimin e këtij modeli ekonometrik janë bazuar disa modele komponentet të disa punimeve të ndryshme, Octaviannand dhe të tjerët (2017) këtë model e ndërtojmë përmes klasifikimi të motivimit në disa elemente në menaxhim të biznesit, përmes performancës, faktorëve financiarë dhe kënaqësisë së punonjësve, ku sipas testimit të tyre motivimi në 207 ndërmarrje ka rezultuar statistikisht ndikues në menaxhimin funksional të biznese të ndryshme. Nizam dhe Shah (2015) përdorimin model të regresionit që ka për qëllim të rritë motivimin e punonjësve në procesin e punës dhe rezultatet e modelit të

regresionit treguan se në 4 bizneset e mëdha në Pakistan, shpërblimi është faktori kryesor në rritjen e motivimit në ndërmarrje, e që është matur me 4 variabla shpjeguese dhe sistem të mbledhjes së të dhënave që kemi përdorur në këtë punim. Khan dhe të tjerët (2017) kanë përdorur modelin e regresionit shumë variabël me elementet ndikuese në menaxhim të NVM-ve, ku janë përdorur variablat shpjeguese (pavarura) motivimi, me nën ndarje ambienti i punës, performanca, shpërblimi dhe beneficionet jo-monetare. Maria Falk Mikkelsen, Christian Bøtcher Jacobsen dhe Lotte Bøgh Andersen (2015) konceptin bazë për rolin e motivimit në ndërmarrje e ndajnë përmes modelit regresiv shumë dimensional, pra së pari duke e vendosur rolin e faktorëve të ndryshëm të motivimit në vetë motivimin e përgjithshëm të punonjësve, pastaj rolin ndikues të kësaj variable motivuese (compound variable) në menaxhimin e efikasitetit të ndërmarrjes.

Në kuadër të ndërtimit të kuadrit konceptual të punimit të doktoratës është parashikuar që të ndërtohet modeli për testimin e hipotezave dhe pyetjeve kërkimore. Për ndërtimin e konceptit të variablave testuese hulumtimi bazohet në teorinë statistikore të bashkimit apo shkrirjes së disa pohimeve ekonomike me shkallën liker, që janë të fushës së njejtë në një variabël shpjeguese. Në ndërtimin e modelit ekonometrik janë përfshirë këto variabla:

Menaxhimi në ndërmarrje

Farayi (2013) trajton menaxhimin në organizatë si procesi unifikues i disa proceseve dhe procedurave të ndryshme që preken kryesisht nga disa faktorë financiarë dhe jo-financiar. Faktori kryesor në procesin e menaxhimit të matur në këtë hulumtim

(Farayi, 2013) janë funksionet e menaxhimit (kontrolli, udhëheqja, kontrolli dhe personeli), të cilët janë unifikuar në disa pohime ekonomike (seksioni 3 i pyetësorit: Menaxhimi i ndërmarrjes). Matja e këtyre pohimeve ekonomike (9 pohime) është unifikuar përmes mesatares aritmetike të gjitha këtyre pohimeve ekonomike, e cila ka nxjerrë një mesatare të përgjithshme, që paraqet “compound variable” e cila në rastin tonë është “Menaxhimi i ndërmarrjes”.

Koncepti i menaxhimit është proces shumë i madh dhe ka disa forma të matjes së tij, mirëpo për hulumtimin tim matja e menaxhimit është bërë në bazë të Farayi (2013), ku përmes disa funksioneve të menaxhimit e kombinuar me motivim ka ndërtuar modelin për matjen e “Menaxhimit të ndërmarrjes” përmes shkrirjes së pohimeve të ndryshme në një variabël shpejguuese. Variabla “Menaxhimi i ndërmarrjes” matet përmes 9 pohimeve të ndryshme, si: 1. “Motivimi është faktori më i rëndësishëm në punën e punonjësve”, 2. “Qartësia e qëllimit midis punonjësve ndihmon për të përmirësuar performancën e tyre”, 3. “Kushtet e punës mund të përmirësojnë ndjeshëm performancën e dikujt”, 4. “Për të arritur ndonjë qëllim, një punonjës duhet të jetë fleksibël dhe i përshtatshëm për punën”, 5. “Njohja e strukturës ndihmon një punonjës të dijë se çfarë të bëjë në situata të caktuara dhe kështu të përmirësojë performancën e tij / saj”, 6. “Feedback është çelësi në përmirësimin e performancës së një individi”, 7. “Përdorimi i teknologjisë moderne shkakton performancën e punonjësve”, 8. “Aftësia, trajnimi dhe përvoja përmirësojnë aftësinë e individit për të kryer punë”, 9. “Ndjenja e shoqërimit nga punonjësi mund të përmirësojë performancën e tij / saj”, të cilat kanë pasur shkallën liker 1 deri në 5 dhe janë kodifikuar në programin statistikor SPSS dhe është nxjerrë përmes formulës së mesatares së thjeshtë nga 9 pohimet

është krijuar mesatarja e çdo pohime dhe në fund mesatarja e të gjitha pohime nxjerr mesataren e variablës “Menaxhimi i ndërmarrjes”.

Motivimi në ndërmarrje

Shumica e teorive aktuale të motivimit u zhvilluan në Shtetet e Bashkuara nga amerikanët për amerikanët. Karakteristika më e qartë amerikane në këto teori është theksimi i fortë i individualizmit dhe karakteristikave kulturore të cilësisë. Në shumicën e rasteve kur dëgjojmë fjalën motivim lidhet me shpërblimet financiare, mirëpo në praktikë aspekti financiar mund të mbulohet edhe nga aspekti jo financiar. Në kuadër të variablës motivimi në ndërmarrje Farayi (2013), në organizatat e targetuara në punim ndërton konceptin e përgjithshëm të motivimit të ndarë nga koncepti financiar dhe jo financiar, duke unifikuar shpërblimin monetar dhe atë jo monetar me qëllim të hulumtimi më të thellë të motivimit, sepse bashkimi i shpërblimit monetar dhe jo monetar sa do të ketë ndikim në menaxhimin e organizatës, të ndara njëra nga tjetra. Variabla “Motivimi në ndërmarrje” matet nga këto 14 pohime ekonomike: 1. “Pagat dhe mëditjet që paguhen më motivojnë”, 2. “Gjithmonë paguhen me kohë”, 3. “Biznesi paguan punëtorët e saj sipas sasisë së punës së bërë”, 4. “Biznesi siguron përfitime për të gjithë punonjësit e saj”, 5. “Kur punonjësit i përmbushin objektivat e caktuar ata paguhen një bonus”, 6. “Biznesi siguron trajnime për punonjësit e saj shumicën e kohës”, 7. “Për të parandaluar mërzinë, biznesi bën rotacion te punonjësit e saj brenda organizatës”, 8. “Kam marrë pjesë në vendimmarrjen e biznesit”, 9. “Kam dhënë përgjegjësi në vendin tim të punës”, 10. “Biznesi siguron që gjatë gjithë kohës puna ime është sfiduese”, 11. “Kur një punonjës kryen mirë në mënyrë konsistente, ato promovohen”, 12. “Ka trajtim relativisht të barabartë të punonjësve në varësi të

përpjekjeve, përvojës dhe edukimit të tyre”, 13. “Kam marrëdhënie të mira ndër-personale me eprorët e mi”, 14. “Ekziston mbikëqyrje e lartë në biznes”, të cilat kanë pasur shkallën liker 1 deri në 5 dhe janë kodifikuar në programin statistikor SPSS dhe është nxjerrë përmes formulës së mesatares së thjeshtë nga 14 pohimet është krijuar mesatarja e çdo pohime dhe në fund mesatarja e të gjitha pohime nxjerr mesataren e variablës “Motivimi në ndërmarrje”.

Kënaqësia e punonjësve

Shpesh ndodh që objektivat e ndërmarrjes mos të kuptohen nga punëtorët e organizatës, prandaj punonjësit kanë ndeshje me menaxherët e tyre për arritjen e objektivave të caktuara. Një element me rëndësi në kënaqësinë e punonjësve është padyshim objektivat e sakta dhe të kuptueshme për punonjësën në mënyrë që të përmbushë objektivat e organizatës dhe të ketë performancë të kënaqshme. Variabla “Kënaqësia e punonjësve” matet nga këto 6 pohime ekonomike: 1. “Me ndihmën e menaxhimit, performanca ime është përmirësuar me kalimin e kohës”, 2. “Performanca ime zvogëlohet kur biznesi merr kohë për të bërë rotacion punonjësit”, 3. “Unë gjithmonë kryej më të mirën kur e di që jam pranuar në punë”, 4. “Me praktikën e tanishme të motivimit në biznes, performanca e punonjësve gjithmonë do të reduktohet”, 5. “Punonjësit shpesh përpiqen të përmbushin objektivat e caktuar për t'u paguar një bonus”, 6. “Ekziston një lidhje e fortë midis performancës së punonjësve dhe motivimit”, të cilat kanë pasur shkallën liker 1 deri në 5 dhe janë kodifikuar në programin statistikor SPSS dhe është nxjerrë përmes formulës së mesatares së thjeshtë nga 6 pohimet është krijuar mesatarja e çdo pohime dhe në fund mesatarja e të gjitha pohime nxjerr mesataren e variablës “Kënaqësia e punonjësve”.

Punonjësit dhe vlerësimi i performancës

Ndërmarrjet kanë zhvilluar një larmi metodash për matjen e performancës. Disa metoda e rendisin secilin punonjës për të krahasuar performancën e punonjësve. Metoda të tjera e përcjellin vlerësimin në vlerësimet e attributeve individuale, sjelljeve ose rezultateve. Shumë organizata përdorin një sistem matësish që përfshin një sërë masash paraprake, si në rastin e aplikimit të menaxhimit të cilësisë së përgjithshme në menaxhimin e performancës. Fjala performancë përshkruan diçka kualitative dhe me vlerë dhe në vete ka 4 dimensione: efektivitet, barazi, humanitet dhe efikasitet. Wayaki (2017) prezenton në punimin e tij daktoral vlerësimin e punonjësve në kuadër të procedurave të ndryshme të vlerësimit, të cilat janë modifikuar përmes kërkimit sasior. Variabla “Punonjësit dhe vlerësimi i performancës” matet nga këto 11 pohime ekonomike: 1. “Menaxheri im më lejon të marr pjesë në vendosjen e qëllimeve / synimeve të mia”, 2. “E kuptoj rëndësinë e qëllimeve / synimeve të mia në lidhje me objektivin e përgjithshëm të organizatës”, 3. “Kam qëllime dhe synime të qarta për të synuar në punën time”, 4. “Qëllimet / synimet e mia janë realiste dhe të arritshme”, 5. “Si një punonjës, jam i kënaqur me sfidat e siguruar nga puna ime”, 6. “Si një punonjës, kam qëllime të vështira dhe sfiduese për t'u takuar në punë”, 7. “Si një punonjës, unë jam i trajnuar rregullisht për të marrë dhe përmirësuar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e mia ndaj punës sime”, 8. “Unë kam një mentor të caktuar për mua brenda organizatës për të më udhëzuar në arritjen e qëllimeve / synimeve të mia”, 9. “Kam marrë reagime të ndershme dhe konstruktive që lidhen rregullisht me qëllimet / synimet e mia”, 10. “Vendosja e qëllimeve / objektivave ka përmirësuar ndjeshëm performancën time të përgjithshme brenda organizatës”, 11. “Menaxheri im më lejon të marr pjesë në vendosjen

e qëllimeve / synimeve të mia”, të cilat kanë pasur shkallën liker 1 deri në 5 dhe janë kodifikuar në programin statistikor SPSS dhe është nxjerrë përmes formulës së mesatares së thjeshtë nga 11 pohimet është krijuar mesatarja e çdo pohimi dhe në fund mesatarja e të gjitha pohimeve nxjerr mesataren e variablës “Punonjësit dhe vlersimi i performancës”.

Faktorët financiar

Shpërblimi financiar i punonjësve sot aplikohet në shumicën e organizatave ekonomike, me qëllim të motivimit të punonjësve që të arrijnë targetet e vendosura nga organizata. Wayaki (2017) faktorët financiar i kodifikon në modifikim të termave financiar, pra duke parë se çfarë ndikimi ka faktori financiar në motivimin e punonjësve dhe si ndikon në mënyrë indirekte në menaxhimin e ndërmarrjes. Variabla “Faktorët financiar” matet nga këto 11 pohime ekonomike: 1. “Unë jam i kënaqur me nivelin e pagës që marr”, 2. “Paga e ofruar nga kompania është shumë konkurruese në krahasim me kompanitë e tjera në industri”, 3. “Kompania jonë mban një paketë konkurruese dhe përfitime (p.sh. sigurimet mjekësore)”, 4. “Do të isha i kënaqur nëse mora një pagesë mujore (p.sh. karburant dhe telefon)”, 5. “Kompania jonë përdor shpërblime monetare si pagesa bazë, komision, bonus, stimuj dhe ndihma të shëndetshme për të na motivuar”, 6. “Unë besoj se paraja është një nxitje e rëndësishme për të punuar motivimin, sepse ajo është ajo që unë përdor për të blerë gjërat që unë kam nevojë dhe dëshirë”, 7. “Paga ime dhe faktorët e tjerë (p.sh. politikat e kompanisë, kushtet e punës, mbikëqyrja) kanë çuar në një mos kënaqje të punësimit tim”, 8. “Besoj se paratë që paguhen është një tregues i fortë i vlerës së organizatës që ka vendosur në shërbimet e mia”, 9. “Politika jonë e paguar e kompanisë ndihmon në tërheqjen dhe mbajtjen e punonjësve me performancë të lartë”, 10. “Nëse kompania kishte

një skemë për ndarjen e fitimeve, ajo do të më motivonte për të kryer”, 11. “Unë jam i kënaqur me nivelin e pagës që marr”, të cilat kanë pasur shkallën liker 1 deri në 5 dhe janë kodifikuar në programin statistikor SPSS dhe është nxjerrë përmes formulës së mesatares së thjeshtë nga 11 pohimet është krijuar mesatarja e çdo pohimi dhe në fund mesatarja e të gjitha pohimeve nxjerr mesataren e variablës “Faktorët financiar”.

Shpërblimi i punonjësve

Politika në nivelin e shpërblimeve tregon nëse kompania është një pagues i lartë, është i kënaqur të paguajë normat mesatare ose mesatare të pagës, madje në mënyrë të jashtëzakonshme, pranon se duhet të paguajë nën mesataren. Politika e pagave, e cila nganjëherë quhet "qëndrimi i pagës" ose "qëndrimi i paguar" i një kompanie, do të varet nga një numër faktorësh. Këto përfshijnë shkallën në të cilën kompania kërkon nivele të larta të performancës nga punonjësit e saj, shkalla në të cilën ekziston konkurrenca për njerëzit me cilësi të mirë, qëndrimi tradicional i kompanisë, kultura organizative dhe nëse mund ose nuk duhet ose duhet të përballojë të jetë një pagues i lartë. Wayaki (2017) trajton shpërblimin e punonjësve si element kryesor i motivimit të punonjësve, ku përmes shpërblimit të punonjësve direkt arrihet menaxhimi më i lehtë i organizatës të kompanisë. Variabla “Shpërblimi i punonjësve” matet nga këto 11 pohime ekonomike: 1. “Kompania jonë përdor shpërblime jo-monetare si njohje, vendim-marrje gjithëpërfshirëse dhe orare fleksibile të punës për të na motivuar”, 2. “Është e rëndësishme për mua që të njihen zyrtarisht nga menaxhimi / mbikëqyrës për një punë të bërë mirë”, 3. “Është e rëndësishme për mua që të njihen nga bashkëmoshatarët dhe kolegët e mi për një punë të bërë mirë”, 4. “Kompania jonë përdor shpërblime jo-monetare (p.sh. bonot e dhuratave, biletat e filmave,

ose Dreka / Darka për dy) për të na motivuar”, 5. “Nëse kompania jonë kishte një program përfitimi Wellness, p.sh. palestër apo anëtarësi të klubit sportiv, unë do të motivohesha”, 6. “Në organizatën tonë, shpërblimet shihen si qëllime që punonjësit në përgjithësi përpiqen dhe një instrument që ofron rezultate të vlefshme”, 7. “Organizata jonë përdor trajnime dhe zhvillime (p.sh. Seminar, sponsorizim) si një mënyrë për të na motivuar”, 8. “Kompania jonë ka një skemë shpërblimi të drejtë dhe të barabartë”, 9. “Programi ynë i njohjes dhe shpërblimit i motivon mua që të performojë më mirë”, 10. “Organizata jonë ka vërejtur një përmirësim afatgjatë të cilësisë së punës si rezultat i sistemit të shpërblimit në vend”, 11. “Kompania jonë përdor shpërblime jo-monetare si njohje, vendim-marrje gjithëpërfshirëse dhe orare fleksibile të punës për të na motivuar”, të cilat kanë pasur shkallën liker 1 deri në 5 dhe janë kodifikuar në programin statistikor SPSS dhe është nxjerrë përmes formulës së mesatares së thjeshtë nga 11 pohimet është krijuar mesatarja e çdo pohimi dhe në fund mesatarja e të gjitha pohimeve nxjerr mesataren e variablës “Shpërblimet e punonjësve”.

Në bazë të këtyre punime të ndryshme kemi ndërtuar modelin e regresionit me ndarje shumë variabile, që ka për qëllim të ju përgjigjet pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të punimit.

$$MN_i = C + \beta_1 MON_i + \beta_2 KP_i + \beta_3 PVP_i + \beta_4 FF_i + \beta_5 SHP_i + \varepsilon$$

MN- Menaxhimi në ndërmarrje

MON- Motivimi në ndërmarrje

KP- Kënaqësia e punonjësve

PVP – Punonjësit dhe vlerësimi i performances

FF – Faktorët financiar

SHP – Shpërblimi i punonjësve

C – Konstatja për variabla

E – gabimi i rastësishëm për periudhën t

Tabela pasqyron këtë klasifikim të variablave si dhe pyetjet respektive të cilat kanë shërbyer si burim për ndërtimin e variablave të varur dhe të pavarur të studimit.

Tabela 7. Ndërtimi i variablave të varur dhe pavarura

LLOJI I VARIABLIT	EMRI I VARIABLIT	PYETJET QË PËRFAQËSON VARIABLI	MËNYRA E VLERËSIMIT TË VARIABLIT
VARIABLI I VARUR	Menaxhimi në ndërmarrje	Grup-pyetjet e seksionit III	Mesatare aritmetike e III ₁ -III ₉
VARIABLAT E PAVARUR	Motivimi në ndërmarrje	Grup-pyetjet e seksionit II	Mesatare aritmetike e II ₁ -II ₁₄
	Kënaqësia e punonjësve	Grup-pyetjet e seksionit IV	Mesatare aritmetike e IV ₁ -IV ₆
	Punonjësit dhe vlerësimi i performancës	Grup-pyetjet e seksionit V	Mesatare aritmetike e V ₁ -V ₁₁
	Faktorët financiar	Grup-pyetjet e seksionit VI	Mesatare aritmetike e II ₁ -II ₁₁
	Shpërblimi i punonjësve	Grup-pyetjet e seksionit VII	Mesatare aritmetike e VII ₁ – VII ₁₁

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE

5.1. Hyrje në analizën statistikore

Në këtë kapitull do të diskutojmë pyetësin e zhvilluar me 379 të anketuar, ku për përmbajtjen e pyetësit (shih aneksin 1), kemi diskutuar edhe më lartë, ndërsa në këtë kapitull do të diskutojmë rezultatet e këtij hulumtimi.

Analiza statistikore që do të përdoret në punim do të jetë analiza përshkruese, si dhe analiza qendrore statistikore e realizuar dhe përpunuar në programin SPSS.

5.2. Analiza përshkruese e të dhënave të përgjithshme

Në këtë pjesë do të analizojmë analizën përshkruese për seksionin e parë të pyetësit.

Tabela 8. Analiza përshkruese për variablën Niveli i shkollimit

Niveli_i_shkollimit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Studime doktorate	2	.5	.5	.5
	Studime master	82	21.6	21.6	22.1
	Studime themelore	123	32.5	32.5	54.6
	Shkollim i mesem	115	30.3	30.3	84.9
	Shkollim i mesem profesional	37	9.8	9.8	94.7
	Shkollim i mesem privat	20	5.3	5.3	100.0
	Total	379	100.0	100.0	

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Rezultatet tregojnë që pjesëmarrësit në anketim me nivel të shkollimit daktoral kanë qenë 0.5%, studime master 21.6%, studime themelore 32.5%, shkollim të mesëm 30.3%, shkollim të mesëm profesional 9.8% dhe shkollim i mesëm privat 5.3%.

Tabela 9. Analiza përshkruese për variablën Gjinia

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Mashkull	290	76.5	76.5	76.5
	Femer	89	23.5	23.5	100.0
	Total	379	100.0	100.0	

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Pjesëmarrja e gjinisë mashkullore ka dominuar në hulumtimin tim, ku 76.5% të pjesëmarrësve në pyetësor kanë qenë meshkuj, ndërsa femra kanë qenë 23.5%, kjo për shkak të një dominimi të bizneseve të vogla dhe të mesme me pronarëmeshkuj.

Tabela 10. Analiza përshkruese për variablën Mosha

Mosha					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	18-25	59	15.6	15.6	15.6
	26-40	222	58.6	58.6	74.2
	41-65	85	22.42	22.42	96.62
	Mbi 65	13	3.38	3.38	100.0
	Total	379	100.0	100.0	

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Pjesëmarrja në bazë të kategorive të moshës në pyetësor nga moshë 18-25 vjet është 15.6%, nga 26-40 vjet është 58.6%, 41-65 vjet është 22.42% dhe mbi moshën 65 vjeçare është 3.38%.

Tabela 11. Analiza përshkuese për variablën Vendi i Punës

Vendi_i_punes					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Zyra qendrore te kompanisë	266	70.2	70.2	70.2
	Zyra lokale	22	5.8	5.8	76.0
	Teren	91	24.0	24.0	100.0
	Total	379	100.0	100.0	

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Shumica e bizneseve të vogla dhe të mesme zhvillojnë veprimtarinë e tyre në zyrë qendrore, ku niveli është 70.2%, në zyrë lokale apo degë 5.8% dhe në terren 24%.

Tabela 12. Analiza përshkuese për variablën Pozita e punës

Pozita_në_kompani					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Pronar	24	6.3	6.3	6.3
	Top menaxher	120	31.7	31.7	38.0
	Menaxher i nivelit te dyte	141	37.2	37.2	75.2
	Punonjës	94	24.8	24.8	100.0
	Total	379	100.0	100.0	

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Struktura e të anketuarëve në bazë të pozitës në kompani ndryshon, në pozitën pronar kanë marrë pjesë 6.3%, top menaxher 31.7%, menaxher të nivelit të dytë 37.2% dhe punonjës 24.8%.

Analiza crosstabs do të përdoret në hulumtim, për të nxjerrë më shumë të dhëna përshkruese për disa elemente demografike dhe të përgjithshme të hulumtimit.

Tabela 13. Crosstabs ndërmjet Gjinisë dhe pozitës në kompani

Gjinia * Pozita në kompani Crosstabulation						
Count						
		Pozita në kompani				Total
		Pronar	Top menaxher	Menaxher i nivelit te dyte	Punonjes	
Gjinia	Mashkull	22	107	96	54	279
	Femer	2	13	45	40	100
Total		24	120	141	94	379

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Gjinia mashkull dominon në të gjitha pozitat në kompanitë e anketuara, ngaqë pronar janë 22 meshkuj dhe 2 femra, top menaxher janë 107 meshkuj dhe 13 femra, kurse menaxher të nivelit të dytë janë 96 meshkuj dhe 45 femra, si dhe punëtor të thjeshtë janë 54 meshkuj dhe 40 femra.

Tabela 14. Crosstabs ndërmjet Nivelit të shkollimit dhe pozitës në kompani

Niveli_i_shkollimit * Pozita_në_kompani Crosstabulation						
Count						
		Pozita_në_kompani				Total
		Pronar	Top menaxher	Menaxher i nivelit të dyte	Punonjës	
Niveli_i_shkolli mit	Studime doktrate	2	0	0	0	2
	Studime master	22	60	0	0	82
	Studime themelore	0	60	63	0	123
	Shkollim i mesem	0	0	78	37	115
	Shkollim i mesem profesional	0	0	0	37	37
	Shkollim i mesem privat	0	0	0	20	20
Total		24	120	141	94	379

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Në bazë të nivelit të shkollimit dhe pozitës në kompani kemi këto rezultate, ku me studime doktrate janë 2 pronar, studime master janë 22 pronar dhe 60 top menaxher, studime themelore janë 60 top menaxher dhe 63 menaxher të nivelit të dytë, me shkollim të mesëm janë 78 menaxher të nivelit të dytë dhe 37 punonjës, me shkollim të mesëm profesional po ashtu janë 37 punonjës dhe shkollim i mesëm privat janë 20 punonjës.

5.3. Analiza përshkruese

Në këtë pjesë është bërë një analizë e thellë përshkruese e seksioneve të pyetësorit.

Tabela 15. Analiza përshkruese e seksionit të pyetësorit “Menaxhimi i ndërmarrjes”

Statistics										
		P3_1	P3_2	P3_3	P3_4	P3_5	P3_6	P3_7	P3_8	P3_9
N	Valid	379	379	379	379	379	379	379	379	379
	Missing	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mean		2.66	2.76	2.23	2.19	2.48	1.60	2.18	2.34	2.58
Std. Deviation		1.824	1.501	1.136	1.212	1.509	.758	.790	1.367	1.401
Variance		3.326	2.252	1.290	1.468	2.277	.575	.624	1.870	1.963

Burimi: Kalkulimi në SPSS

Të dhënat në këtë tabelë janë të kodifikuar në bazë të radhitjes së pyetësorit (shih aneksin 1, seksioni 3). Rezultatet tregojnë që për pohimin e parë “Motivimi është faktori më i rëndësishëm në punën e punonjësve” dhe kemi mesatare 2.66 që i afrohet vlerës 3, e që është kodifikuar si nuk jam i sigurt, pra të punësuarit nuk e dinë saktësisht se motivimi a e ka rëndësinë kryesore në punën e tyre. Devijimi standard i kësaj variable është 1.824, që tregon se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.

Pohimi i dytë “Qartësia e qëllimit midis punonjësve ndihmon për të përmirësuar performancën e tyre” kemi mesataren 2.76, pra nga rezultati shihet së edhe për këtë pohim të anketuarit janë përgjigjur se nuk janë të sigurtë. Ndërsa devijimi standard i kësaj variable

është 1.501, që tregonpo ashtu se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.

Pohimi i tretë “Kushtet e punës mund të përmirsojnëndjeshëm performancën e punonjesit” kemi mesataren 2.23, pothuajse e njëjtë me pohimin e parë, pra të anketuarit pajtohen më pohimin e tretë. Ndërsa devijimi standard i kësaj variable është 1.136, që tregonpo ashtu se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.pohimet me të cilat të anketuarit janë pajtuar më shumë janë pohimi 3, 4, 6, 7 dhe 8.

Pohimin 4. “Për të arritur ndonjë qëllim, një punonjës duhet të jetë fleksibël dhe i përshtatshëm për punën”, ku mesatarja nga rezultatet e perpunuara është 2.19 e që është afer 2 ku të anketuarit po ashtu pajtohen për këtë pohim, Ndërsa devijimi standard i kësaj variable është 1.212, që tregonpo ashtu se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.

Pohimi 5. “Njohja e strukturës ndihmon një punonjës të dijë se çfarë të bëjë në situata të caktuara dhe kështu të përmirësojë performancën e tij / saj”, ka mesatare2.48, pra rezultati i përpunuar është nën vlerën 2.50 pra shumica e të anketuarve pajtohen edhe me këtë pohim. Devijimi standard i kësaj variable është 1.509, që tregonpo ashtu se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.

Pohimi 6. “Feedback është çelësi në përmirësimin e performancës së një individi”,dhe për këtë pohim pas perpunimit të rezultateve të të anketuarve na rezulton me mesatare 1.60, pra të anketuarit pajtohen edhe me pohimin 6. Dhe devijimi standard i

kësajvariable është .758, që tregon se shpërndarja e vlerave edhe të kësaj variable është në parametra normal dhe i afrohet mesatares.

Pohimin 7. “Përdorimi i teknologjisë moderne shkakton dhe ndikon nëperformancën e punonjësve” kemi mesatarën 2.18, që i afrohet vlerës 2, e që është kodifikuar se punonjesit pajtohen po ashtu edhe me këtë pohim.Si dhe devijimi standard i kësaj variable është .790, që po ashtu tregon se shpërndarja e vlerave edhe të kësaj variable është në parametra normal dhe i afrohet mesatares.

Pohimi 8. “Aftësia, trajnimi dhe përvoja përmirësojnë aftësinëe individit për të kryer punë” nga rezultatet e pranuara kemi mesataren 2.34 qe po ashtu i afrohet vlerës 2 e që tregon se shumica e të anketuarve gjithashtu pajtohen edhe me këtë pohim.Ndërsa devijimi standard i kësaj variable është 1.367, që tregonpo ashtu se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.

Dhe në fund kemi Pohimin 9 “Ndjenja e shoqërimit nga punonjësi mund të përmirësojë performancën e tij / saj”dhe për të cilin pohim të anketuarit nga rezultatet e mbledhura dhe të perpunuara na rezulton me mesataren 2.58 që tregon se të anketuarait nuk janë të sigurt për këtë pohim. Ndërsa devijim standard i kësaj variable është 1.401 e cila tregonpo ashtu se shpërndarja e vlerave të kësaj variable i afrohet mesatares.

Tabela 16. Analiza përshkruese e seksionit të pyetësorit “Motivimi në ndërmarrje”

Statistics															
		P2_1	P2_2	P2_3	P2_4	P2_5	P2_6	P2_7	P2_8	P2_9	P2_10	P2_11	P2_12	P2_13	P2_14
